



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËSISË INDUSTRIALE



2018 RAPORTI VJETOR ANNUAL REPORT



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËSISË INDUSTRIALE

RAPORTI VJETOR ANNUAL REPORT

2018

PËRMBAJTJA

CONTENT

1. MESAZH PËRSHËNDETËS I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË DPPI	7
MESSAGE FROM DIRECTOR GENERAL OF GDIP	
2. HYRJE (PRONËSIA INDUSTRIALE)	14
INTRODUCTION (INDUSTRIAL PROPERTY)	
3. PROFILI I DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE	16
PROFILE OF GENERAL DIRECORATE OF INDUSTRIAL PROPERTY	
4. SHËRBIMET QË OFRON DPPI	20
SERVICES PROVIDED BY GDIP	
5. LEGJISLACIONI	27
LEGISLATION	
6. STRATEGJIA KOMBËTARE E PRONËSISË INTELEKTUALE 2016-2020	32
NATIONAL STRATEGY OF INTELLECTUAL PROPERTY 2016-2020	
7. PSE ËSHTË I RËNDËSISHËM ROLI I DPPI?	38
THE IMPORTANCE OF THE ROLE OF GDIP	
8. PERFORMANCA GJATË VITIT 2018 NGA DPPI	42
PERFORMACE OF GDIP DURING 2018	
9. VENDIMET E KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË DPPI	
DECISIONS OF GDIP SUPERVISORY COUNCIL	
10. REGJISTRIMI I OBJEKTEVE TË PRONËSISË INDUSTRIALE	45
INDUSTRIAL PROPERTY ENTITY REGISTRATION	
<i>PATENTAT PËR SHPIKJE DHE MODELET E PËRDORIMIT</i>	<i>47</i>
<i>PATENTS FOR INVENTIONS AND UTILITY MODELS</i>	
<i>MARKAT TREGTARE</i>	<i>58</i>
<i>TRADEMARKS</i>	
<i>DISENJOT INDUSTRIALE</i>	<i>68</i>
<i>INDUSTRIAL DESIGNS</i>	
<i>TREGUESIT GJEOGRAFIKË</i>	<i>71</i>
<i>GEOGRAPHICAL INDICATIONS</i>	
11. DREJTORIA E KOORDINIMIT, PROMOVIMIT, TRAJNIMEVE DHE ANALIZËS	
AKTIVITETI PROMOVUES DHE NDËRGJEGJËSIMI	77
PROMOTIONAL ACTIVITIES AND RAISING AWARENESS	

KONFERENCA DHE SEMINARE	79
CONFERENCES AND WORKSHOPS	
ANALIZA E PRONËSISË INTELEKTUALE	82
INTELLECTUAL PROPERTY ANALYSIS	
AKTIVITETE DHE BASHKËPUNIME NË FUSHËN E ARSIMIT	97
ACTIVITIES AND COLLABORATIONS IN THE EDUCATION FIELD	
TRAJNIME TË INSTITUCIONEVE TË PËRFSHIRA NË SISTEMIN E PI	101
TRAININGS OF THE INSTITUTIONS INCLUDED IN THE IP SYSTEM	
12. MARRËVESHJE DHE BASHKËPUNIME	122
AGREEMENTS AND COOPERATIONS	
BASHKËPUNIMET DHE MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE	123
COLLABORATIONS AND INTERNATIONAL RELATIONS	
BASHKËPUNIMET DHE MARRËDHËNIET ME INSTITUCIONET VENDASE	124
COLLABORATIONS AND RELATIONSHIPS WITH LOCAL INSTITUTIONS	
KONTRIBUTI I DPPI NË PROCESIN E INTEGRIMIT EVROPIAN	128
GPID CONTRIBUTION IN THE EUROPEAN INTEGRATION PROCESS	
13. TEKNOLOGJIA INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT	131
INFORMATION AND COMMUNICATION TECHNOLOGY	
14. SEKTORI JURIDIK	134
LEGAL SECTOR	
TRAJTIMI I KONFLIKTEVE MBI OBJEKTET E PRONËSISË INDUSTRIALE	134
ADDRESSING OF CONFLICTS RELATED TO INDUSTRIAL PROPERTY ENTITIES	
ÇËSHTJE NË GJYKATË	137
COURT CASES	
15. OBJEKTIVAT E VITIT 2019	141
OBJECTIVES 2019	
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE	141
DIRECTORATE OF FINANCE AND SUPPORT SERVICES	
16. BURIMET NJERËZORE	147
HUMAN RESOURCES	
17. PËRFAQËSUESIT E AUTORIZUAR TË PATENTAVE PËR SHPIKJE DHE MARKAVE TREGTARE	154
PATENTS FOR INVENTIONS AND TRADEMARKS AUTHORISED REPRESENTATIVES	
18. TË DHËNA STATISTIKORE NGA REGJISTRAT E DPPI	157
STATISTICAL DATA FROM THE GDIP REGISTERS	

SHKURTIME

ABBREVIATIONS

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë industriale
General Directorate of Industrial Property

DPPI
GDIP

Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale
World Intellectual Property Organisation

OBPI
WIPO

Pronësia Intelektuale
Intellectual Property

PI
IP

Zyra Evropiane e Patentave
European Patents Office

ZEP
EPO

Zyra e Bashkimit Evropian për Pronësinë Intelektuale
European Union Intellectual Property Office

ZBEPI
EUIPO

Bashkimi Evropian
European Union

BE
EU

Qendrat e Transferimit të Teknologjisë
Technology Transfer Centre

QTT
TTC

Qendrat e Kërkimit Shkencor
Scientific Research Centre

QKSH
SRC

Republika e Shqipërisë
Republic of Albania

RSH
RoA

Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin
United Nations Development Programme

PKBZH
UNPD

I nderuar lexues,

Kam kënaqësinë të prezantoj edhe për këtë vit raportin vjetor 2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale.

Dëshiroj të shprehem se viti 2018 përfundoi me rezultate pozitive dhe një rritje të konsiderueshme të numrit të aplikimeve në krahasim me vitet e mëparshme.

Këto shifra janë tregues i rritjes së nivelit të ndërgjegjësimit të biznesit vendas për përfitimet nga mbrojtja e markave tregtare, si dhe të interesit të kompanive të huaja për tregun shqiptar.

Gjithashtu, këto rezultate janë një reflektim i punës së të gjithë aktorëve të përfshirë në sistemin e pronësisë industriale që bashkëpunuan me ne, për të finalizuar me sukses detyrat dhe objektivat që burojnë nga “Strategjia Kombëtare e Pronësisë Intelektuale 2016-2020”.

Më lejoni të falenderoj të gjithë institucionet vendase të përfshira në sistemin e mbrojtjes së pronësisë intelektuale dhe anëtarët e Grupit Ndërinstitucional të Punës për monitorimin e “Strategjisë Kombëtare të Pronësinë Intelektuale 2016-2020”.

Shpreh mirënjohjen time për përfaqësuesit e Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, për drejtuesit e organizatave ndërkombëtare të fushës së pronësisë intelektuale si OBPI, ZEP, ZBEPI për bashkëpunimin dhe kontributin e dhënë, si dhe për drejtuesit e zyrave homologe, me të cilat kemi lidhur marrëveshje bashkëpunimi dypalëshe, bashkëpunim, i cili do të vijë duke u forcuar nga viti në vit.

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI) funksionon si institucion publik jobuxhetor dhe operon si agjenci autonome nën mbikëqyrjen e ministrit përgjegjës për ekonominë, me seli në Tiranë.

Dear Reader,

It is my very great pleasure to introduce the annual report of the General Directorate of Industrial Property for 2018.

I would like to point out that 2018 ended with positive results and a significant increase in the number of applications compared to previous years.

These figures indicate the increase of awareness of the local business community on the benefits of protecting trademarks, as well as the interest of foreign companies for the Albanian market.

In addition, these results reflect the work of all the stakeholders engaged in the Industrial Property system, who cooperated with us to successfully accomplish the tasks and objectives arising from “The National Intellectual Property Strategy 2016-2020”.

I would also like to thank all the local institutions engaged in the industrial property protection system and the members of the Interinstitutional Working Group on monitoring “The National Intellectual Property Strategy 2016-2020”.

I would like to express my gratitude to the representatives of the European Union Delegation in Albania, heads of the international organisations operating in the field of intellectual property such as WIPO, EPO, EUIPO for the collaboration and the contribution provided, and also to the heads of the homologous offices with which we have entered into bilateral cooperation agreements, a cooperation which will be strengthened year by year.

General Directorate of Industrial Property (GDIP) is an extra-budgetary public institution and operates as an autonomous agency under the supervision of the Minister responsible for economy, with headquarters in Tirana.

Veprimtaria e Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale përcaktohet dhe rregullohet me anë të Ligjit Nr. 9947, dt 07.07.2008, *“Për Pronësinë Industriale”*, i ndryshuar si dhe aktet nënligjore në zbatimin të tij. Ndryshimet ligjore ishin përmbushje e detyrave të lëna në raportet e Komisionit Evropian, dhe pasqyrim i angazhimeve dhe synimeve të qeverisë shqiptare, të cilat kanë të bëjnë me rritjen e cilësisë së shërbimeve, rregullime dhe saktësime të problemeve të hasura nga zbatimi i ligjit të mëparshëm në praktikë, si dhe përshtatja me eksperiencat dhe praktikatat më të mira të zyrave homologe ndërkombëtare.

DPPI është institucioni kryesor që garanton dhe promovon mbrojtjen e të drejtave të PI-së nëpërmjet regjistrimit të këtyre objekteve industriale (patenta për shpikjet, modelet e përdorimit, markat tregtare, disenjot industriale, treguesit gjeografikë, emërtimet e origjinës dhe topografinë e produkteve gjysmë-përçues,) si dhe promovon këto të drejta në Republikën e Shqipërisë.

Është fakt i njohur që sistemi i pronësisë industriale është një mekanizëm stimulues i zhvillimit ekonomik të një vendi pasi, është thelbësor në krijimin e tregut që zhvillohet në kushtet e konkurrencës së ndershme. Ky sistem, ndihmon në nxitjen e inovacionit, krijimtarisë së aplikuar në produktet industriale, si dhe garanton lëvizjen e mallrave origjinale dhe shërbimeve cilësore në treg.

Rritja e kapaciteteve administrative të DPPI-së ishte domosdoshmëri që lindi nga kërkesat ligjore dhe nga problematika e hasur në praktikë. Kjo u realizua për të krijuar kushte të përshtatshme për rritjen e cilësisë së shërbimeve të DPPI-së, dhe infrastrukturës së saj, të cilat janë të nevojshme në arritjen e objektivave.

Theksojmë se, shërbimet e DPPI-së po shkojnë drejt standardeve bashkëkohore për të garantuar një nivel mbrojtjeje të njëjtë me atë të vendeve të Bashkimit Evropian, ashtu siç është e përcaktuar qartë në Marrëveshjen e Asociim-Stabilizimit (neni 73 i saj).

Gjatë vitit 2018 u dërguan për miratim 15 akte ligjore dhe nënligjore, katër prej të cilave, janë aderime të Shqipërisë në marrëveshje ndërkombëtare në fushën e pronësisë industriale, miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

General Directorate of Industrial Property's activity is determined and regulated by Law No. 9947, dated 07.07.2008, *“On Industrial Property”*, as amended, and its applicable by-laws. Legal amendments were part of the tasks assigned under the European Commission reports, and a reflection of the commitment and goals of the Albanian Government, related to the increase of the service quality, resolution and clarification of issues encountered in practice during the implementation of the previous law, and the adoption to the best experiences and practices of the international homologous offices.

GDIP is the main institution that guarantees and promotes the protection of IP's rights through the registration of these industrial objects (invention patents, utility models, trademarks, industrial designs, geographical indications, appellations of origin and topography of semi-conductor products), and also promotes these rights in the Republic of Albania.

It is a well-known fact that the industrial property system is a stimulating mechanism for a country's economic development, as it is essential in creating a market that develops under conditions of fair competition. This system helps to foster innovation, creativity applied to industrial products, and guarantees the movement of original goods and qualitative services to the market.

Increasing the administrative capacity of GDIP was a necessity resulting from the legal requirements and the problems encountered in practice. This was carried out with the aim of creating appropriate conditions to improve the quality of the GDIP's services and its infrastructure needed to achieve the goals.

We emphasise that GDIP's services are moving towards contemporary standards to ensure a level of protection similar to that of the European Union countries, as clearly defined in the Stabilization and Association Agreement (Article 73).

In 2018, 15 legal acts and by-laws were sent for approval, four of which are Albania's accessions to international agreements in the field of industrial property, approved by the Assembly of the Republic of Albania.

Ndërkohë që ne kemi ndërmarrë sfida të reja, janë hartuar 11 akte nënligjore, dalë në zbatim të ligjit Nr. 9947, datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale”, i ndryshuar, ku aktualisht janë miratuar vetëm 8 prej tyre, simëposhtë:

- VKM nr. 460, datë 26.7.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 1707, datë 29.12.2008, të Këshillit të Ministrave, “Përmiratimin e rregullores për lëshimin e patentave për shpikjet dhe modelet e përdorimit”, të ndryshuar;
- VKM nr.315, datë 31.05.2018 “Për miratimin e rregullores për markat”;
- VKM nr. 317, datë 31.5.2018 për miratimin e rregullores “Për Përfaqësuesit e Autorizuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale”;
- VKM nr.316, datë 31.05.2018 “Për miratimin e tarifave për regjistrimin e Objekteve të Pronësisë Industriale”;
- VKM nr. 501, datë 29.8.2018 “Për miratimin e Rregullores për Ekspertët e Objekteve të Pronësisë Industriale”;
- VKM nr. 270, datë 16.5.2018 “Për miratimin e Rregullores “Për Disenjt Industrial”;
- VKM nr. 752, datë 19.12.2018 “Për-miratimin e Rregullores së Organizimit, Funksionimit dhe Përcaktimit të masës së Shpërblimit të Anëtarëve të Bordit të Apelit të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale”;
- VKM Nr. 252, datë 9.5.2018 “Për përcaktimin e masës dhe të kriterëve për shpërblimin e kryetarit, anëtarëve dhe sekretarit teknik të Këshillit Mbikqyrës të DPPI”.

Gjithashtu, gjatë këtij viti janë miratuar katër projekt-marrëveshje, me anë të të cilave Republika e Shqipërisë aderon në marrëveshjet ndërkombëtare, si:

- Ligj nr. 33/2018, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Lokarnos “Për përcaktimin e një klasifikimi ndërkombëtar për disenjt industriale”.

While we have taken on new challenges, 11 by-laws have been drafted pursuant to Law no. 9947, dated 07.07.2008 “On Industrial Property”, as amended, and only 8 of them have been adopted so far, as follows:

- DCM No. 460, dated 26.7.2018 “On some amendments and additions to Decision no. 1707, dated 29.12.2008, of the Council of Ministers, “On the adoption of a Regulation on invention patents issuance and utility models”, as amended;
- DCM no. 315, dated 31.05.2018 “On the adoption of a Regulation on trademarks”;
- DCM no. 317, dated 31.5.2018 “On the adoption of a Regulation on Authorized Representatives in the General Directorate of Industrial Property”;
- DCM no. 316, dated 31.05.2018 “On the approval of registration fees for industrial property objects”;
- DCM no. 501, dated 29.8.2018 “On the adoption of a Regulation on Industrial Property Objects Experts”;
- DCM No. 270, dated 16.5.2018 “On the adoption of a Regulation on Industrial Designs”;
- DCM No. 752, dated 19.12.2018 “On the adoption of a Regulation on Organization, Functioning and Establishing the Amount of Remuneration of Members of the Appeal Board of the General Directorate of Industrial Property”;
- DCM no. 252, dated 9.5.2018 “On establishing the amount and criteria for the remuneration of the Chairman, Members and Technical Secretary of GDIP’s Supervisory Council”.

In addition, four draft agreements have been approved this year, through which the Republic of Albania adheres to international agreements such as:

- Law no. 33/2018 “On the accession of the Republic of Albania to the Locarno Agreement” On establishing an international classification for industrial designs”.

- Ligj nr. 34/2018, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëve-shjen e Vjenës “Për klasifikimin ndërkombëtar të elementeve figurative të markave tregtare”, miratuar më 7.6.2018.
- Ligj nr. 66/2018, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktin e Gjenevës të marrëveshjes së Lisbonës për emërtimet e origjinës dhe treguesit gjeografikë”, miratuar më 24.9.2018.
- Ligj nr. 90/2018, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Lisbonës për mbrojtjen e emërtimeve të origjinës dhe regjistrimin e tyre ndërkombëtar”, miratuar më 03.12.2018.

Për herë të parë, ligji plotëson kuadrin ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar të përshtatshëm për mbrojtjen dhe **zhvillimin e Treguesve Gjeografikë dhe Emërtimeve të Origjinës në Shqipëri**. Pra, anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë në Marrëveshjen e Lisbonës dhe Aktin e Gjenevës së kësaj marrëveshjeje, kanë mundësuar regjistrimin ndërkombëtar të tyre.

Kjo marrëveshje lehtëson regjistrimin e produkteve shqiptare në vendet e huaja, si dhe hedhjen e produkteve të huaja në tregun shqiptar, të garantuara për llojin dhe cilësinë e tyre.

Gjatë vitit 2018 në DPPI është kryer reforma e thellë institucionale, e cila konsistoi në miratimin e strukturës së re me 39 punonjës, një shtesë personeli prej 15 punonjësish të rinj, që filluan të rekrutohen gjatë muajit tetor të vitit 2018 dhe në vazhdim. Plotësimi hap pas hapi i të gjithë vendeve vakante në strukturë, ka sjellë dhe do të ketë një impakt pozitiv për të kryer një shërbim cilësor, profesional dhe të njëjtë me zyrat tona homologe jashtë vendit.

Shtimi i numrit të punonjësve erdhi edhe si domosdoshmëri për përmbushjen e objektivave të ndërmara në *Strategjinë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2016-2020* nga DPPI. Numri i lartë i aplikimeve për objektet e pronësisë industriale ka sjellë rritje të të ardhurave të DPPI-së. Gjithashtu, është rritur dhe cilësia e shërbimeve në këtë fushë, kjo falë punës intesive të kryer

- Law no. 34/2018, “On the accession of the Republic of Albania to the Vienna Agreement” *On the International Classification of Figurative Elements of Trademarks*, adopted on 7.6.2018.
- Law no. 66/2018, “On the accession of the Republic of Albania to the Geneva Act of the Lisbon Agreement on appellations of origin and geographical indications”, adopted on 24.9.2018.
- Law no. 90/2018, “On the accession of the Republic of Albania to the Lisbon Agreement” *for the protection of appellations of origin and their international registration*, adopted on 03.12.2018.

For the first time, the law completes the proper national and international legal framework on the protection and **development of Geographical Indicators and Appellations of Origin in Albania**. Therefore, the membership of the Republic of Albania to the Lisbon Agreement and the Geneva Act has enabled their international registration.

This agreement facilitates the registration of Albanian products in foreign countries, as well as introduction of foreign products in the Albanian market, guaranteed for their type and quality.

In 2018, GDIP underwent a thorough institutional reform which resulted in the adoption of a structure with 39 employees, adding 15 new employees to the staff, who went through the recruitment process from October 2018 onwards. The step-by-step filling of all vacancies within the structure has brought about and will have a positive impact on providing a qualitative, professional and similar service to our homologous offices abroad.

Increasing the number of employees came as a result of the need to meet the objectives set out in the National Strategy on Intellectual Property 2016-2020 by GDIP. The high number of applications for industrial property objects has led to an increase in the revenues of GDIP. The quality of services in this area has also increased, thanks to the intensive work carried out through

nga promovimi dhe koordinimi që stafi i DPPI-së ka ndërmarrë në aktivitetet pranë bizneseve, nëpër qendrat e informimit teknik dhe shkencore, nëpërmjet seminareve dhe leksioneve në Universitetet publike dhe jo-publike si dhe për grupet e interesit.

Stafi i DPPI-së ka kryer mbi 100 takime duke shkuar në mjediset e biznesit, jo vetëm në Tiranë, por edhe në rrethe të ndryshme të Shqipërisë. Këto aktivitete promovuese sollën si rezultat rritjen e konsiderueshme të aplikimeve për regjistrim të markave duke shënuar një rekord të ri regjistrimi markash.

DPPI, në bashkëpunim edhe me Zyrën Europiane të Patentave ka përgatitur një seri modulesh trajnimi e-learning, me informacion shumë të rëndësishëm në fushën e pronësisë industriale për të gjithë të interesuarit e fushës. Modulet e-learning ndodhen në faqen zyrtare të DPPI (www.dppm.gov.al) dhe të interesuarit mund të krijojnë një llogari individuale dhe të logohen në sistem duke përfutur në këtë mënyrë nga këto kurse.

Në përmbushje të funksioneve promovuese edhe gjatë vitit 2018 ka vijuar organizimi dhe zhvillimi i aktiviteteve të tilla si: Konferenca Kombëtare, me rastin e Ditës Botërore të Pronësisë Industriale, ku të ftuar ishin përfaqësues të lartë të qeverisë, misionëve diplomatike në Shqipëri, përfaqësues të institucioneve të përfshira në sistemin e PI, universitete, biznese, shpikës, artistë/krijues etj. Në vijim, janë organizuar seminare me biznesin, leksione të hapura në universitete të ndryshme dhe në shkollat e mesme. Është zhvilluar konkurs me nxënësit e shkollave të mesme të Tiranës, ku u vu re interesi dhe pjesëmarrja mjaft aktive e brezave të rinj për të mësuar mbi fushën e PI. Konkursët që zhvillohen në shkollat e arsimit para-universitar, tashmë janë kthyer në një aktivitet të përvitshëm, duke parë pritshmëritë maksimale nga ana e nxënësve, por dhe e stafit pedagogjik, për të marrë informacion bazik, por shumë të rëndësishëm gjatë procesit të të mësuarit. Eksperienca të tilla kanë treguar të jenë shumë të suksesshme dhe në vendet e zhvilluara, duke rritur në këtë mënyrë ndërgjigjësimin e shoqërisë me parimet e të drejtave të pronësisë intelektuale.

the promotion and coordination ensured by GDIP staff with activities in various businesses, in technical and scientific information centres, through seminars and lectures in public and private universities as well as for interest groups.

GDIP staff has organised over 100 meetings by paying visits to business facilities not only in Tirana, but also in different districts of Albania. These promoting activities were translated into considerable increase in the number of applications to register trademarks, and thus setting a new record of trademark registration.

In cooperation with the European Patent Office, GDIP has prepared a series of e-learning modules for training purposes, which include important information on industrial property for all stakeholders. E-learning modules are available on the GDIP's official website (www.dppm.gov.al); the interested parties can create an individual account and log in to the system to access these courses.

For the purpose of fulfilling promotional functions, in 2018 continued the organization and development of activities such as: The National Conference, within the framework of the World Industrial Property Day, with the attendance of senior government representatives, diplomatic missions in Albania, representatives of the institutions engaged in the PI system, universities, businesses, inventors, artists/creators. In addition, seminars with businesses, open lectures at various universities and high schools were organized. A competition was held with high school students of Tirana, where we noticed a great interest and active participation of young generations to learn about the IP field. The competitions taking place in pre-university education schools have now become an annual activity, taking into account the maximum expectations of both students and pedagogical staff to obtain basic, yet very important information during the learning process. Such experiences have proven to be very successful in developed countries, thus increasing social awareness on the principles of intellectual property rights.

Në vëmendjen tonë vazhdimisht ka qenë bashkëpunimi me institucionet vendase dhe të huaja për të krijuar efektshmëri të sistemit të regjistrimit dhe mbrojtjes së PI, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Gjatë këtij viti kemi lidhur memorandum bashkëpunimi me Zyrën homologe të Maqedonisë, Kosovës dhe Hungarisë. Këto memorandume, kanë për synim nxitjen e bashkëpunimit për të forcuar dhe zhvilluar sistemet e Pronësisë Industriale ekzistuese, duke krijuar një mekanizëm për të patur shkëmbim të rregullt të informacionit dhe të praktikave më të mira.

Marrëveshjet e bashkëpunimit janë konsideruar si një mënyrë efikase për zhvillim të aktiviteteve promovuese dhe koordimin për shkëmbim informacioni edhe me institucione vendase për këtë arsye kemi lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e "New York" dhe Universitetin "Fan S. Noli" Korçë, ku në këtë të fundit krijuam qendrën e informacionit teknik dhe shkencor.

Viti 2018 ka qenë një vit rekord aplikimesh të objekteve të pronësisë industriale si dhe shumë angazhime dhe detyra të realizuara në kuadër të Strategjisë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale dhe dokumenteve të tjera strategjike të fushës.

Gjatë këtij viti janë depozituar në DPPI, **2235** aplikime të reja për regjistrimin e objekteve të PI-së krahasuar me **1993** aplikime në total që ishin në vitin e kaluar nga të cilat:

1294 aplikime për marka, **921** aplikime për patenta, **16** aplikime për diseno industriale, **2** aplikime për tregues gjeografikë dhe emërtime origjine dhe **2** aplikime për modele përdorimi.

Gjatë procesit të ekzaminimit të këtyre objekteve janë lëshuar **1629** certifikata regjistrimi për aplikimet kombëtare në lidhje me objektet e PI, janë ripërtërirë **3692** regjistrime të objekteve të PI, si dhe janë shqyrtuar dhe pasqyruar në regjistër **420** ndryshime në lidhje me to.

Ndërkohë nga Sistemi i Madridit janë depozituar **2877** aplikime për marka ndërkombëtare nga të cilat **2843** janë rregjistruar, ndërsa nga Marrë-

The cooperation with local and foreign institutions has consistently been in our focus to set an effective registration and protection system of IP, inside and outside the territory of the Republic of Albania.

This year we have signed memorandums of cooperation with our homologous offices in Macedonia, Kosovo and Hungary. These memorandums aim at encouraging collaboration to strengthen and develop existing Industrial Property systems, by creating a mechanism for regular exchange of information and best practices.

Cooperation agreements are considered as an efficient way to develop promotional activities and coordination for information exchange with local institutions. For this reason, we have signed a cooperation agreement with the University of New York and Fan S. Noli University in Korça; in the latter we set up the Technical and Scientific Information Centre.

2018 scored a new record in applications for industrial property objects, as well as various commitments and tasks carried out in the framework of The National Intellectual Property Strategy and other strategic documents in the field.

This year, GDIP received **2235** new applications for the registration of IP objects, compared to a total of **1993** applications filed in the previous year, of which:

1294 trademark applications, **921** patent applications, **16** industrial design applications, **2** applications for geographical indicators and appellations of origin, and **2** utility models applications.

During the examination process of these objects, **1629** registration certificates for national applications related to IP objects have been issued, **3692** registrations of IP objects have been renewed, and **420** changes have been reviewed and reflected in the register.

Meanwhile, from the Madrid system, **2877** applications for international trademark have been filed, of which **2843** have been registered, where-

veshja e Hagës për regjistrimin ndërkombëtar të disenjove janë depozituar 137 aplikime ndërkombëtare për diseno industriale dhe **janë rregjistruar 119 diseno industriale**.

Në përfundim të gjithë sa më lart përmendur si dhe me besimin dhe vullnetin e plotë që zhvillimi i sistemit të Pronësisë Industriale në Republikën e Shqipërisë është në drejtimin e duhur, ne do të vazhdojmë të jemi të përkushtuar në avancimin e zhvillimit të bashkëpunimeve dhe negociatave me të gjithë aktorët dhe grupet e interesit në këtë fushë për të përmbushur jo vetëm misionin tonë por edhe të ndihojmë në zhvillimin e inovacionit.

Kjo drejtori do të vijojë forcimin e bashkëpunimit me institucionet e përfshira në Strategjinë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2016-2020 për të përmbushur detyrimet në mënyrë që të sigurojë të njëjtin mbrojtjeje me atë të vendeve të Bashkimit Europian, duke përmbushur në këtë mënyrë nenin 73, të Marrëveshjes së Asociimit-Stabilitetit.

Në emër të stafit që drejtoj, besoj se këto bashkëpunime në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar do të forcohen, në përmbushje të objektivave dhe misionit tonë sa i takon fushës së pronësisë intelektuale.

Me respekt,

Elvin Lako

Drejtor i Përgjithshëm

as based on Hague Agreement on International Registration of Industrial Designs, **137** international industrial design applications have been filed and **119** industrial designs have been registered.

In conclusion of everything aforesaid, I am completely confident and willing that the progress of the industrial property system in the Republic of Albania is on the right course. We will remain committed to ensuring the progress of cooperation and negotiations with all stakeholders and interest groups in this field, not only to fulfil our mission but also to assist in the development of innovation.

This Directorate will continue to strengthen cooperation with the institutions engaged in the National Strategy on Intellectual Property 2016-2020, for the purpose of meeting obligations in order to ensure the same level of protection with that of the European Union countries, thus fulfilling the requirements set out in Article 73 of the Stabilization and Association Agreement.

On behalf of the staff I lead, I believe that these collaborations at national and international level will be further strengthened in order to fulfil our mission and objectives regarding the intellectual property field.

Sincerely,

Elvin Lako

Director General

HYRJE: PRONËSIA INDUSTRIALE

INTRODUCTION: INDUSTRIAL PROPERTY

Pronësia Industriale sot është një ndër çështjet e rëndësishme të zhvillimeve të së drejtës, të tregtisë së lirë dhe zhvillimit ekonomik në tërësi. Mbrojtja e të drejtave të pronësisë industriale nuk përbën vetëm një çështje të një shteti, por është pjesë përbërëse dhe e pandarë e zhvillimeve rajonale e ndërkombëtare.

Në katër vitet e fundit, qëllimi kryesor i DPPI ka qenë rritja e cilësisë së shërbimit dhe zhvillimi i standardeve bashkëkohore për mbrojtjen e pronësisë industriale në Republikën e Shqipërisë.

Sistemi i pronësisë industriale është mjeti juridik që siguron mbrojtjen dhe rregullon të drejtat e pronësisë mbi patentat për shpikje, markat tregtare, disenjot industriale, treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës, duke krijuar mundësinë për t'i përdorur dhe shfrytëzuar ato ekonomikisht si dhe disponuar me anë të licencimit apo transferimit të tyre.

Pronësia industriale, në aspektin juridik është një sistem që garanton mbrojtjen e pronës jo fizike, e cila për nga rëndësia, është e njëjtë me të drejtat mbi pronën fizike dhe gëzon mbrojtje të shprehur, si pjesë e të drejtave themelore të njeriut. Pronësia gjithashtu i nënshtrohet kufizimeve në ushtrimin e të drejtave mbi to, bazuar në interesa publike dhe në një shpërblyerje të drejtë.

Fusha e zbatimit të pronësisë industriale duhet kuptuar gjithashtu në një kuptim më të gjerë dhe duhet të zbatohet dhe aplikohet jo vetëm në industri dhe tregti, por gjithashtu në bujqësi dhe industrinë nxjerrëse dhe për të gjitha produktet e prodhuara ose natyrore, për shembull, verërat, drithërat, fletë duhani, fruta, bagëti, minerale, ujëra minerale, birra, lule dhe miell".

Pronësia industriale është e lidhur ngushtë me inovacionin dhe luan rol kyç në zhvillimin ekonomik dhe shkencor. Nëpërmjet sistemit të mbrojtjes së kësaj pronësie, mundësohet shpërndarja e informacionit mbi arritjet e reja

Today, industrial property is one of the most important issues of the development of law, free trade and economic development in general. The protection of industrial property rights is not just a matter of a state, but is an integral and inseparable part of regional and international developments.

In the last four years, GDIP's main goal was to increase the quality of the service and to develop contemporary standards to protect the industrial property in the Republic of Albania.

The Industrial Property System is the legal tool to ensure protection and to regulate property rights on invention patents, trademarks, industrial designs, geographical indicators and appellations of origin, by creating opportunities for their economical use and exploitation, as well as making them available through licensing or assignments.

Industrial property, seen in a legal prospective, is a system that guarantees the protection of the intangible assets, which importance is the same as that of the rights on tangible assets and is entitled to protection as part of the fundamental human rights. Property is also subject to restrictions in the exercise of its rights, based on public interests and a fair compensation.

The scope of industrial property should be also considered in a broader sense and should apply not only to industry and trade, but also to agriculture and extractive industries, as well as to all manufactured or natural products, such as wines, grains, tobacco, fruit, livestock, minerals, mineral waters, beer, flowers and flour".

Industrial property is closely related to innovation and plays a major role in the economic and scientific development. The industrial property protection system enables the exchange of information on new technological

teknologjike, kursehet puna e dyzuar për kërkimin shkencor dhe më e rëndësishmja, nxit dhe stimulon krijimtaria.

Ajo, gjithashtu përshkruan mënyrat me të cilat krijuesit mund të kërkojnë mbrojtje për pronën e tyre industriale

Për një aktivitet tregtar të suksesshëm, në aktualitetin e sotëm, nevojiten gjithnjë e më shumë prurje të risive duke investuar në dije dhe teknologji të reja. Sipërmarrja dhe përfshirja në projekte inovative mbart gjithmonë me vete edhe riskun e humbjes dhe të dështimit për biznesin, ndaj mbrojtja e pronësisë industriale përbën një lloj mbështetje dhe garancie për sipërmarrësit, sepse mundëson ndalimin e kujtqo që do të synonte të përfitonte pa merituar nga idetë, investimi, dhe reputacioni i tyre.

Kështu që, pronësia industriale duhet kuptuar edhe si mbrojtje ndaj konkurrencës së pandershme me anë të së cilës, mund të ushtrohet ndalimi i përdoruesve të paautorizuar që keq-orientojnë konsumatorët dhe dëmtojnë interesat e ligjshme të mbajtësve të së drejtave.

Imitimet apo kopjimet e markave tregtare, disenjove, apo patentave për shpikje me qëllim përfitimin nga reputacioni dhe emri i mirë që ato mund të kenë në treg, bën që të dëmtohen ekonomikisht dhe moralisht pronarët e tyre, por edhe konsumatorët, që duke u mashtruar nga shenjat e falsifikuara, blejnë mallra të një cilësie më të dobët, duke menduar që po blejnë mallrat origjinale.

Sa më të forta të jenë politikat e mbrojtjes së sistemit të pronësisë industriale të një vendi, aq më e zhvilluar do të jetë ekonomia e tij, prandaj ajo duhet njohur, vlerësuar dhe mbrojtur maksimalisht nga politikat shtetërore, sipërmarrësit, individët dhe e gjithë shoqëria në tërësi.

achievements, avoids overlapping of the work related to scientific research and most importantly, helps to encourage and foster creativity.

It also describes the ways in which creators can seek protection for their industrial property.

For a successful commercial activity, nowadays, more and more innovation flow is needed, by investing in new know-how and technology. Undertaking and engagement in innovative projects always represents the risk of loss and failure for business entities, therefore industrial property protection constitutes a kind of support and guarantee for the entrepreneurs, since it prevents anyone who would try to gain the benefits of certain ideas, investments and reputation not based on meritocracy.

Therefore, industrial property should be also considered as a protection tool from unfair competition, through which we can manage to stop unauthorised users from misdirecting the costumers and causing damage to the legal interests of the holders of such rights.

Counterfeit or fake trademarks, designs, or invention patents with the purpose of benefiting from their reputation or goodwill built in the market, may cause economic and moral damage to their owners, but also to the costumers, who are deceived by the fake signs and buy goods of lower quality, at the same time being convinced that they are buying original goods.

The stronger the industrial property system protection policies of a country, the more advanced its economy will be, therefore maximum acknowledgement, evaluation and protection should be paid by state policies, entrepreneurs, individuals and the entire society in general.

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale është institucion publik jobuxhetor që regjistron, administron dhe promovon objektet e PI-së dhe funksionon si agjenci autonome nën mbikëqyrjen e ministrit përgjegjës për ekonominë dhe ka selinë e vet në Tiranë.

Gjithashtu një rol të rëndësishëm DPPI ka në rritjen e ndërgjegjësimit tek palët e interesuara, aktorët e përfshirë në sistem si dhe në universitetet dhe institucionet arsimore në të gjithë vendin.

STATUSI

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale është institucioni i ngarkuar me ligj për regjistrimin, administrimin dhe promovimin e objekteve të PI-së, detyrim që i buron nga *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*. nga ligji organik nr. 9947, dt 07/07/2008 “Për pronësinë industriale” i ndryshuar, neni 189, si dhe nga dokumente të shumtë strategjike si: *Marrëveshja e Asociim-Stabilizimit në nenin 73 të saj*, “*Pronësia Intelektuale*”, *Plani Kombëtar Integritit Europian 2018-2020*, etj.

DPPI është institucioni i vetëm nëpërmjet të cilit shteti shqiptar jep të drejtat mbi patentat mbi shpikjet dhe modelet e përdorimit, topografinë e produkteve gjysmëpërçues, markat tregtare dhe të shërbimit, disenjot industriale dhe treguesit gjeografikë, duke iu njohur mbajtësve të së drejtave pronësinë mbi këto objekte, nëpërmjet regjistrimit të tyre.

DPPI mban dhe rolin e koordinatorit të Kapitullit VII, ‘Pronësia Intelektuale’, ku raporton gjithashtu në Komitetin e Stabilizim Asociimit dhe në Nënkomitetin e Tregut të Brendshëm dhe Konkurrencës si dhe pranë Delegacionit të Bashkimit Evropian mbi ecurinë dhe aktivitetin e kryer në përmbushje të detyrimeve që na ngarkojnë dokumentet strategjike.

General Directorate of Industrial Property is an extra-budgetary public institution, which registers, manages and promotes IP subjects and operates as an autonomous agency under the supervision of the Minister responsible for economy and has its registered headquarters in Tirana.

In addition, GDIP plays an important role in raising awareness among the interested parties, stakeholders engaged in the system, as well as in universities and educational institutions across the country.

STATUS

The General Directorate of Industrial Property is the institution entrusted by law for the registration, administration and promotion of IP objects, an obligation stemming from *the Constitution of the Republic of Albania*. by organic law no. 9947, dated 07/07/2008, “*On Industrial Property*” as amended, Article 189, as well as from various strategic documents such as: *In Article 73 of Stabilization and Association Agreement*, “*On Intellectual Property*”, *the National Plan for European Integration 2018-2020*, etc.

GDIP is the sole institution through which the Albanian state issues rights on invention patents and utility models, topography of semiconductor products, trademarks and service marks, industrial designs and geographical indications, recognising the property of the objects to the holders of such rights through their registration.

GDIP acts as a coordinator for Chapter 7 on “Intellectual Property”, where also reports on the performance and activity undertaken to fulfil the obligations that the strategic documents provide to the Stabilization and Association Committee and to the Internal Market and Subcommittee on Internal Market and Competition and to the European Union Delegation.

Pra, DPPI është institucioni koordinues në të gjitha dokumentet e rëndësishme strategjike të palës ndërkombëtare dhe jo vetëm.

MISIONI

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale ka si mision të forcojë mbrojtjen e pronësisë industriale brenda territorit shqiptar nëpërmjet njohjes, regjistrimit, dhe promovimit të këtyre të drejtave, për të garantuar një nivel mbrojtjeje të njëjtë me atë të vendeve të Bashkimit Evropian;

- *Fokusi i DPPI-së konsiston në përmirësimin e funksionimit të sistemit të pronësisë industriale me qëllim, nxitjen dhe mbështetjen e inovacionit nëpërmjet nxitjes së punës kërkimore, në veçanti nga kompanitë shqiptare, universitetet vendase dhe individët drejt zhvillimit ekonomik dhe standardeve më të larta. Në mënyrë specifike, do të shërbejë si një mjet për të inkurajuar investimet në kërkim dhe zhvillim, si dhe për të garantuar suksesin në treg.*
- ***Mbrojtja** e sistemit të pronësisë industriale në Republikën e Shqipërisë bazohet në legjislacionin kombëtar si edhe traktatet e konventat ndërkombëtare në të cilat, Republika e Shqipërisë është anëtare;*

OBJEKTIVI

- *Sigurimin e një menaxhimi dhe koordinimi të brendshëm dhe global, për të përmirësuar pronësinë intelektuale, mbrojtjen dhe zbatimin e saj në mbarë botën;*
- *Arritjen e një organizimi ekselent për forcimin e bashkëpunimit në marrëdhëniet në nivel kombëtar dhe ndrkombëtar.*
- *DPPI është e angazhuar të përmbushë sfidat për implementimin e arritjeve strategjike, objektivave dhe inicativave të ndërmarra në "Strategjinë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2016-2020".*

Therefore the GDIP represents the coordinating institution in all important strategic documents of the international stakeholders and not only.

MISSION

The General Directorate of Industrial Property's mission is to strengthen the protection of the industrial property within the Albanian territory through recognition, registration and promotion of these rights, to guarantee the same level of protection as that of the European Union countries;

- *GDIP's focus is the improvement of the work of the industrial property system in order to encourage and support innovation by providing incentives for research works, especially in the Albanian companies, local universities and individuals in their course to economic development and higher standards. Specifically, it will serve as a tool to encourage investment in research and development, and also to guarantee success in the market.*
- *The protection of the industrial property system in the Republic of Albania is based on the national legislation and the international treaties and conventions in which the Republic of Albania is a member;*

OBJECTIVE

- *Providing internal and global management and coordination to improve intellectual property, its protection and application worldwide;*
- *Achieving an excellent organization to enhance cooperation in national and international relations.*
- *GDIP is committed to meeting the challenges of implementing the strategic achievements, objectives and initiatives set out in the "National Strategy on Intellectual Property 2016-2020".*

SHËRBIMET E DPPI-SË

- ❖ Kryen Shërbime informacioni për Objektet e pronësisë industriale.
- ❖ Kryen regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale përmes procedurave të ekzaminimit.
- ❖ Organizon seminare, për ndërgjegjësimin e publikut mbi rëndësinë e sistemit të pronësisë industriale.
- ❖ Publikon informacion të specializuar në fushën e pronësisë industriale, në buletin periodik tre mujor.
- ❖ Publikon materiale, fletë palosje lidhur me sistemin e të drejtave të pronësisë industriale.
- ❖ Kryen trajnime në fushën e pronësisë industriale për grupe dhe kategori të ndryshme të interesuarish.

Në katër vitet e fundit, qëllimi kryesor i DPPI ka qenë rritja e cilësisë së shërbimit dhe zhvillimi i standardeve bashkëkohore për mbrojtjen e pronësisë industriale në Republikën e Shqipërisë.

Organet drejtuese të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale janë:

Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm.

GDIP SERVICES

- ❖ Provides Information Services for Industrial Property Objects.
- ❖ Performs the registration of industrial property objects through examination procedures.
- ❖ Organizes seminars to raise awareness on the importance of the industrial property system.
- ❖ Publishes specialized information in the field of industrial property in the quarterly periodic bulletin.
- ❖ Publishes materials and leaflets regarding the industrial property rights system.
- ❖ Provides training services in the field of industrial property for various groups and categories of stakeholders.


In the last four years, GDIP's main goal was to increase the quality of the service and to develop contemporary standards to protect the industrial property in the Republic of Albania.

The General Directorate of Industrial Property governing bodies are:

Supervisory Council and the General Director.

ORGANIGRAMA

ORGANIZATIONAL CHART



SHËRBIMET QË OFRON DPPI SERVICES PROVIDED BY GDIP

Lloji i shërbimit / Type of Service

PATENTAT PËR SHPIKJE / PATENTS FOR INVENTION

1	Kërkesë për regjistrimin kombëtar të patentës për shpikje Request on national registration of the invention patent
2	Kërkesë për regjistrimin kombëtar të patentës për shpikje sipas TBP Request on national registration of the invention patent according to PCT
3	Kërkesë për shtrirje të patentës evropiane Request on extension of the European patent
4	Kërkesë për shtrirjen e aplikimit për patentë evropiane Request on the extension of the European patent application
5	Kërkesë për vlefshmëri të patentës evropiane Request on validation of the European patent
6	Kërkesë për vlefshmëri të aplikimit për patentë evropiane Request on validation of the European patent application
7	Kërkesë për konvertimin e aplikimit për patentë evropiane në aplikim për patentë kombëtare. Request on conversion of the European patent applications into national patent application.
8	Kërkesë për kthimin e kërkesës për patentë shpikjeje në kërkesë për model përdorimi Request on conversion of the invention patent application into a utility model application
9	Kërkesë për dhënien e Certifikatës së Mbrojtjes Shtesë për Produktet Mjekësore dhe Produktet e Mbrojtjes së Bimeve Request on the issuance of Supplementary Protection Certificates for Pharmaceutical and Plant Protection Products
10	Kërkesë për apelim në bordin e apelit të refuzimit të certifikatës së mbrojtjes shtesë Request on submitting an appeal to the board of appeal on the refusal of the supplementary protection certificate
11	Kërkesë për pavlefshmëri të certifikatës së mbrojtjes shtesë Request on invalidity of the supplementary protection certificate
12	Aplikim për Patentë Evropiane European Patent Application
13	Kërkesë për aplikim ndërkombëtar për patentë Request for patent international application
14	Kërkesë për kundërshtimin e dhënies të patentës për shpikje Request on the refusal to issue an invention patent
15	Kërkesë për ripërteritjen e patentës për shpikje Request on renewal of the invention patent
16	Kërkesë për publikimin e ndryshimeve në pretendime të patentave evropiane të shtrira ose të Patentave Evropiane të validuara. Request on the publication of the amended claims of the extended European patents or validated European Patents.
17	Kërkesë për regjistrimin në regjistër të ndryshimit të emrit të aplikantit/pronarit të patentës për shpikje Request on the registration of the changed name of the applicant/owner of the invention patent
18	Kërkesë për regjistrimin në regjistër të transferimit të pronësisë, të patentës për shpikje Request on the registration of the invention patent ownership transfer
19	Kërkesë për regjistrimin në regjistër të kontratës së licenses të patentës për shpikje Request on the registration of the licence contract of the invention patent
20	Kërkesë për regjistrimin në regjistër të garancisë/pengut për patentën për shpikje Request on the registration of the guarantee/pledge of the invention patent
21	Kërkesë për regjistrimin në regjistër të veprimeve përmbarimore për patentën për shpikje Request on the registration of the enforcement actions of the invention patent
22	Kërkesë për regjistrimin e ndryshimit të adresës së aplikantit/pronarit të Patentës për Shpikje Request on the registration of the changed address of the applicant/owner of the invention patent

23	Kërkesë për apelimin e refuzimit të patentës për shpikje në Bordin e Apelimit Request on the appeal of the invention patent refusal in the Board of Appeal
24	Kërkesë për rivendosjen në afat të patentës Request on renewal of the patent
25	Kërkesë për ndarjen e aplikimit fillestar për patentë Request on the separation of the initial patent application
26	Kërkesë për dorëheqje nga aplikimi për patentë Request on waiver from the patent application
27	Kërkesë për dorëheqje nga aplikimi ose certifikata e mbrojtjes shtesë Request on waiver from the application or the supplementary protection certificate
28	Kërkesë për publikim të parakohshëm të aplikimit për patentë Request on early publication of the patent application
29	Kërkesë për shqyrtim të mëtejshëm ose zgjatje afatit të aplikimit për patentë Request on further review or extension of the term for the patent application
30	Kërkesë për korrigjimin e pasaktësive në të dhënat e patentës Request on correction of the inaccuracies in the patent data
MARKAT TREGTARE / TRADEMARKS	
31	Aplikim për regjistrim kombëtar të markës individuale Application for individual trademark national registration
32	Aplikim për regjistrim kombëtar të markës kolektive ose certifikuese Application for national registration of the collective or certification trademark
33	Kërkesë për transferimin e aplikimit për regjistrim ndërkombëtar të markës Request on transferring of the application for international trademark registration
34	Kërkesë për transferim aplikimi për shtrirje e mëvonshme territoriale të mbrojtjes së Markë Tregtare ndërkombetare Request on transferring of the application for subsequent territorial extension of the international trademark protection
35	Kërkesë për transformim të regjistrimit ndërkombëtar në aplikim kombëtar Request on transferring international registration into national application
36	Kërkesë për kufizimin e listës së mallrave Request on the limitation of the list of goods
- Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë, Tiranë, etj.

DPPI ka bërë një analizë të pronësisë industriale të projektuar për të gjitha sipërmarrjet që dëshirojnë të vlerësojnë kapacitetet e tyre të PI dhe ti kthejnë ato në asete ekonomike të vlerësueshme, në vlera monetare.

Gjithashtu asiston dhe informon të gjithë shoqëritë tregtare për rritjen e ndërgjegjësimit dhe mbrojtjen e aseteve jomateriale, për të siguruar një mbrojtje ligjore kundrejt konkurrencës së pandershme.

Tekstin e plotë të “Strategjisë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2016-2020” e gjeni në linkun bashkëlidhur:

http://www.dppm.gov.al/previewdoc.php?file_id=856

GDIP has taken a series of measures, mainly by organizing numerous meetings with businesses and has participated in fairs across the country. In this context, GDIP has signed Memorandums of Cooperation to facilitate work coordination and to assist the business by creating a healthy and safe environment, specifically:

- Union of Chambers of Commerce and Industry, Tirana
- Chamber of Commerce and Industry, Tirana, etc.

GDIP has conducted an industrial property analysis designed for all enterprises wishing to evaluate their IP capacities and turn them into assessable economic assets and monetary value.

It also assists and informs all commercial companies of increasing awareness and protection of intangible assets, in order to provide legal protection against unfair competition.

You may read the complete text of “The National Intellectual Property Strategy 2016-2020” in the link below:

http://www.dppm.gov.al/previewdoc.php?file_id=856

PSE ËSHTË I RËNDËSISHËM ROLI I DPPI?

THE IMPORTANCE OF THE ROLE OF GDIP

Në ditët e sotme kur tregu është dinamik dhe konkurenca është shumë e lartë, funksionet e një institucioni tëpronësisë industriale merr rëndësi të veçantë. Ky institucion duhet të jetë i aftë për të promovuar dhe shpërndarë informacion në lidhje me rëndësinë që mbart në vetvete sistemi i pronësisë industriale, gjithnjë në mbështetje të zhvillimit ekonomik, inovacionit dhe shoqërisë.

Në këtë situatë DPPI po punon të jetë më shumë se thjesht një zyrë për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale. Fokusi i saj është të promovojë këtë lloj pronësie, që nxit inovacionin nëpërmjet njohjesë titujve të pronësisë mbi asetet jo fizike, siç janë markat, patentat për shpikje, disenjot industriale, treguesit gjeografikë etj., të cilat kanë vlerëkonkrete ekonomike dhe monetare. Përfitimet ekonomike prej këtyre objekteve sigurohen vetëm nëpërmjet njohjes, regjistrimit dhe mbrojtjes së tyre nga shkelësit e të drejtave. Nisur nga funksioni që ka, DPPI është organi administrativ më i rëndësishëm në sistemin e pronësisë industriale në Republikën e Shqipërisë. Duke mbrojtur shpikjet dhe inovacionin, krijohet baza e duhur për ekzistencën e marrëdhënies së ndërsjellë qeveri, biznes dhe qendrat e informacionit teknik e shkencor në universitete, si aktorët kryesorë që kontribuojnë në promovimin e përfitimeve që rrjedhin nga inovacioni.

DPPI ofron plot 154 shërbime për publikun, të grupuara sipas metodologjisë së kodifikimit dhe klasifikimit të shërbimeve publike, të krijuar nga Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA). Këto shërbime janë cilësore me standarde të njëjta me ato të vendeve të BE. Me ndryshimet që u bënë me miratimin e Ligjit Nr. 17/2017, datë 16.02.2017 dhe Ligjit nr. 9947, datë 07.07.2008, “Për Pronësinë Industriale”, i ndryshuar, baza ligjore ku mbështeten funksionet e DPPI, tashmë është e përshtatshme për të realizuar

Nowadays, in a dynamic market with high competitiveness, the functions of an industrial property institution become of special importance. This institution should be capable of promoting and exchanging information regarding the importance that the industrial property system carries in itself, while supporting the economic, innovation and social development.

Under these circumstances, GDIP is working on being more than a simple office that registers industrial property objects. Its focus is to promote this type of property, which encourages innovation through recognising the ownership titles on intangible assets, such as trademarks, invention patents, industrial designs, geographical indications, etc., which have actual economic and monetary value. Economical profits from these objects are provided only through their recognition, registration and protection from the violators of the rights. Based on its function, GDIP is the most important administrative body in the industrial property system in the Republic of Albania. By protecting inventions and innovation, the adequate base for the existence of the mutual relations between the government, businesses and technical and scientific information centres in universities is established, as the main stakeholders contributing in the promotion of the benefits from innovation.

GDIP provides 154 types of services to the public, grouped according to the public services codification and classification methodology, established by the Agency for the Delivery of Integrated Public Services (ADISA). These services are of high quality and on equal standards as those of the EU countries. With the amendments following the approval of Law No. 17/2017, dated 16.02.2017 and Law no. 9947, dated 07.07.2008, “On Industrial Property”, as amended, the legal basis where the functions of the GDIP are based is now considered as

reformat në fushën e pronësisë industriale. Ky ligj parashikon transformimin e DPPI duke i shtuar asaj kompetenca që i japin mundësi të sigurojë jo vetëm lehtësimin e procedurave të aplikimit për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale, por edhe të parandalojë krijimin e konflikteve mbi to, sidomos mbi markat tregtare. Kjo modernizon tërësisht shërbimin e ofruar, duke përdorur disa mekanizma që do t'i ofrojnë mbajtësve të të drejtave, informacion në kohë reale për aplikimet që çenojnë të drejtat mbi objektet e regjistruara. Gjithashtu, janë ngritur struktura të reja brenda DPPI-së, për të shqyrtuar rastet e konflikteve mbi objektet e pronësisë industriale nëpërmjet dy shkallëve të shqyrtimit që janë: Dhoma e Shqyrtimit të Kundërshtimeve dhe Bordi i Apelit në DPPI, duke mundësuar parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve mbi objektet e pronësisë industriale. Kjo problematikë ka qenë në vëmendjen tonë, pasi dihet që shkeljet e të drejtave mbi objektet e pronësinë industriale sjellin kosto në kohë dhe në vlera monetare për palët në konflikt. Dhoma për Shfuqizim/Zhvlerësim është krijuar në bazë të të nenit 193/a, të ligjit nr. 9947, datë 07.07.2008 "Për pronësinë industriale" i ndryshuar, për shqyrtimin e kërkesave që i drejtohen DPPI-së mbështetur në nenet 126, 138, 155, 173, 174, 183 të ligjit të sipërcituar "Për pronësinë industriale".

Nevoja për krijimin e kësaj dhome ka lindur për t'u ardhur në ndihmë grupeve të interesit apo çdo subjekti të interesuar, në mënyrë që të drejtojnë kërkesat e tyre me objekt shfuqizimin/zhvlerësimin e disenjove industriale dhe markave tregtare dhe të shërbimit përpara një organi administrativ të posaçëm në fushën e PI. Trajtimi dhe shqyrtimi i këtyre objekteve nga Dhoma për Shfuqizim/Zhvlerësim ka si avantazh për palët pjesëmarrëse, se vendimarrja i është caktuar si kompetencë një organi të specializuar në fushën e PI, si dhe kryerjen e procedurave në kohë me të shkurtër sesa sikur t'i drejtoheshin gjykatës, gjë që deri më sot i ka dekurajuar subjektet e interesuara (kjo reflektohet në nr. e kufizuar të çështjeve me këtë objekt në gjykatë gjatë 10 viteve të fundit). Sa më sipër, është parashikuar pa u hequr palëve në asnjë rast të drejtën të ankimojnë këto vendime në organet më të larta, si dhe në gjykatë.

adequate to complete the reforms in the field of industrial property. This law provides the transformation of GDIP, adding competences that provide the opportunity to ensure not only simplification of application procedures for the registration of industrial property objects, but also to prevent any conflicts related to them, especially for trademarks. This makes the services provided completely modern, by using some mechanisms which will provide the holders of such rights real-time information on the applications that violate the rights on the registered objects. Moreover, new structures were established within GDIP, to review the cases of disputes on industrial property objects through two stages of examination, respectively: Refusal Review Chamber and the Board of Appeal in GDIP, enabling the prevention and conflict resolution on industrial property objects. This issue has always been on our focus, as it is obvious that the violation of the rights on industrial property objects are costly in time and money for the parties in dispute. Invalidation/Revocation Chamber was established pursuant to article 193/a, of law no. 9947, dated 07.07.2008 "On industrial property", as amended, for reviewing the claims addressed to GDIP according to the articles 126, 138, 155, 173, 174, 183 of the above-mentioned law "On industrial property".

The need to establish this chamber arose to assist stakeholders or any interested subjects in addressing their requests with the purpose of abolishing / depreciating industrial designs, as well as trade and service marks before a special administrative body in the field of IP. The procedure and review of these claims by the Invalidation/Revocation Chamber is advantageous to the parties involved, regarding the decision-making which is assigned to a specialized body in the IP, as well as the proficient timely procedures within a short term compared to the cases addressed to another court, which up to now have resulted as discouraging to interested subjects (this is reflected in the limited number of relevant cases addressed to court over the last 10 years). The above considerations are foreseen without in any case depriving parties of the right to appeal these decisions to the higher bodies or to the court.

Interesin për t'iu drejtuar kësaj dhome e vërtetojnë kërkesat e shumta që iu drejtuan Dhomës për Shfuqizim/Zhvlerësim që prej nisjes së punës së saj.

Dhoma për Shfuqizim / Zhvlerësim ka filluar të funksionojë menjëherë pas hyrjes në fuqi në datën 06.06.2018, të VKM nr. 315, datë 31.05.2018 "Për miratimin e rregullores për markat", që parashikon procedurën administrative për shqyrtimin e kërkesave drejtuar kësaj dhome.

Numri i kërkesave të depozituara pranë dhomës për Shfuqizim/Zhvlerësim deri në fundin e vitit 2018 është 44, nga të cilat janë shqyrtuar dhe kanë përfunduar me vendim 23 prej tyre,

Pjesa tjetër e kërkesave është ende në proces shqyrtimi, për shkak të kohës së depozitimit pranë DPPI-së, apo për plotësimin e të metave që ato përmbajnë, si dhe për njoftimin e palëve pjesëmarrëse në procedurat përkatëse, etj.

Si pjesë e strukturës së DPPI-së, u shtua gjithashtu dhe Zyra e Pritjes dhe Informacionit, që do të procedojë menjëherë me shqyrtimin e formaliteteve për aplikimet që paraqiten, duke shkurtuar ndjeshëm procedurat e regjistrimit.

Në kuadër të reformimit, DPPI synon përmirësimin e shërbimeve nëpërmjet krijimit të mundësisë për aplikimin online dhe lëshimit të certifikatave elektronike, duke sjellë lehtësi për aplikuesit. Gjithashtu, synohet të krijohet biblioteka me materiale informuese mbi çështjet e PI, për lehtësimin e marrjes së informacionit mbi njohuritë dhe të rejat teknologjike që përmban inovacioni mbi shpikjet e patentuara.

DPPI zhvillon një numër të madh aktivitesh, si konferenca, seminare, trajnime dhe takime me të gjitha grupet e interesit për promovimin dhe ndërgjegjësimin për mbrojtjen e pronësisë industriale. Krijuesit dhe inovatorët, studentët dhe brezi i ri, duhet të ndjehen të përfshirë në kontekstin e këtij sistemi duke besuar dhe investuar në zhvillimin e pronësisë industriale si mjet fitimi ekonomik, por edhe duke qenë të kujdesshëm në respektimin e punës së të tjerëve, duke mos shkelur të drejtat e askujt.

The high number of claims that have been addressed to the Invalidation/Revocation Chamber since its establishment confirms the increasing interest shown to address to this Chamber.

The Invalidation/Revocation Chamber has started performing immediately upon the entry into force on 06.06.2018, DCM no. 315, dated 31.05.2018 "On the adoption of a Regulation on trademarks", which provides for, the administrative procedure for reviewing the claims addressed to this chamber.

The number of claims filed at the Invalidation/Revocation Chamber by the end of 2018 was 44, of which 23 have been reviewed and have been finalised by decision,

The rest of the claims are still under review due to the time of filing with the GDIP, or for completing the irregularities they contain, as well as for notifying the parties involved in the relevant procedures etc.

The Reception and Information Office was established, as part of the GDIP structure, which immediately started proceeding with the review of the formalities for any application submitted, by significantly reducing the registration procedures.

In the framework of such reform, GDIP aims at improving the services through creating the opportunity of on-line applications and issuance of electronic certificates, making it more simple for the applicants. Furthermore, we aim at creating a library with information materials on IP issues, to simplify access to information on the technological know-how and novelties of nowadays innovations on the patented inventions.

GDIP organises a wide range of activities, such as conferences, workshops and meetings with all the interest groups to promote and raise awareness on the industrial property protection. Creators and innovators, students and the new generation, should feel involved in the context of this system, by building confidence and investing in the development of the industrial property as a tool of economic benefit, but also by being careful in respecting the work of others, and not violating the rights of anyone. For this purpose,

Për këtë qëllim, DPPI ka ngritur tre Qendra të Informacionit Teknik dhe Shkencor, ku funksioni i këtyre qendrave është lehtësimi në qasjen ndaj informacionit mbi fushën e pronësisë industriale, sidomos mbi patentat për shpikje, për studentët dhe të gjithë palëve të interesuara.

DPPI gjithashtu ka vijuar bashkëpunime me karakter teknik me institucionet ndërkombëtare si më poshtë:

- Organizatën Botërore të Pronësisë Intelektuale.
- Zyrën e Bashkimit Evropian mbi Pronësinë Intelektuale dhe me Zyrat homologe të SHBA-së, Kinës, Turqisë, Serbisë, Polonisë, Kosovës, Maqedonisë dhe Hungarisë dhe është në proces me vende të tjera.
- Në lidhje me Zyrën Evropiane të Patentave, bashkëpunimi gjatë vitit 2018 ka qënë intensiv dhe janë përfunduar aktivitetet e parashikuara në Planin Bilateral të Bashkëpunimit 2015-2018. Aktualisht DPPI është në procesin e hartimit të planit të ri të bashkëpunimit me ZEP duke u fokusuar në forcimin e sistemit të patentave Evropiane në Republikën e Shqipërisë. DPPI në cilësinë e vendit anëtar gjatë 2018 ka marrë pjesë në të gjitha takimet e manaxheriale dhe teknike të organizuar nga ZEP.
- Ndërkohë me Zyrën Evropiane të Patentave marrëveshja e bashkëpunimit në lidhje me reduktimin e tarifave për hartimin e raportit të hetimit nga ZEP për aplikantët shqiptarë do të lidhet në vitin në 2019.
- **Ka vijuar bashkëpunimi në zbatim të memorandumeve të nënshkruara** me Doganat, QKB, Bashkimin e Dhomave të Tregtisë.
- **Ka vijuar bashkëpunimi në zbatim të memorandumeve të nënshkruara** me universitetet vendase, Universitetin Ismail Qemali në Vlorë, SHLJP "Luarasi" dhe "Metropolitan", Universiteti Fan Noli Korçë, si dhe një aneks marrëveshje me Universitetin Politeknik të Tiranës.

GDIP has established two Technical and Scientific Information Centres; their function is simplifying access to information on industrial property, especially on invention patents, for students and all other stakeholders.

GDIP has also continued technical cooperation with the following international institutions:

- World Intellectual Property Organisation.
- European Union Intellectual Property Office and homologous offices of the United States, China, Turkey, Serbia, Poland, Kosovo, Macedonia and Hungary and is in process with other countries.
- In 2018, the cooperation with the European Patent Office has been intensive and the activities provided for in the Bilateral Cooperation Plan 2015-2018 have been completed. GDIP is currently in the process of drafting a new cooperation plan with EPO, focusing on strengthening the European patent system in the Republic of Albania. In 2018, GDIP as a member country participated in all management and technical meetings organized by the EPO.
- Meanwhile, in 2019 a cooperation agreement will be signed with the European Patent Office on fee reductions for drafting the investigation report for Albanian applicants by EPO.
- **Cooperation continued pursuant to Memorandums signed with** Customs, NBC, and Union of Chambers of Commerce.
- **Cooperation continued pursuant to Memorandums signed with** local universities, the University of Vlorë "Ismael Qemali", private universities "Luarasi" and "Metropolitan", the University of Korça "Fan S. Noli", as well as an additional agreement with the Polytechnic University of Tirana.

PJESA II: PERFORMANCA GJATË VITIT 2018 NGA DPPI

PART II: PERFORMANCE OF GDIP DURING 2018

VENDIMET E KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË DPPI PËR VITIN 2018

Këshilli Mbikëqyrës është organ drejtues i DPPI. Ky është një organ kolegjal, i përbërë nga pesë anëtarë; kryetari dhe katër anëtarë, nga të cilët:

- a) një jurist;
- b) një financier;
- c) një anëtar i kabinetit të Kryeministrit;
- ç) një anëtar i kabinetit të ministrit përgjegjës për ekonominë;
- d) një anëtar nga struktura që mbulon investimet e huaja.

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës emërohen nga ministri përgjegjës për ekonominë.

Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës janë:

- Mbikëqyrja e veprimtarisë së DPPI-së dhe ushtrimi i çdo kompetence tjetër sipas ligjit
- Miratimi i programeve të zhvillimit të DPPI-së
- Miratimi i rregullores së brendshme të organizimit dhe të funksionimit të DPPI-së
- Miratimi i strukturës dhe organikës së DPPI-së me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm pas marrjes së dakordësisë nga ministri përgjegjës për administratën publike dhe ministrit përgjegjës për financat
- Miratimi i programit financiar të DPPI-së si dhe projektbuxhetin, i cili më pas miratohet nga Këshilli i Ministrave
- Miratimi i projektit për nivelin e pagave të punonjësve të DPPI-së, i cili më pas miratohet nga Këshilli i Ministrave

DECISIONS OF GDIP SUPERVISORY COUNCIL FOR 2018

The Supervisory Council is the governing body of GDIP. It is a collegial body, consisting of five members; the chairman and four members, of whom:

- a) a jurist;
- b) an accountant;
- c) a member of the Prime Minister's cabinet;
- d) a member of the cabinet of the Minister responsible for economy;
- e) a member from the structure covering foreign investments;

The members of the Supervisory Council are appointed by the Minister responsible for economy.

The competences of the Supervisory Board are:

- Supervision of the GDIP activity and exercising any other competences pursuant to the law.
- Approval of GDIP developing programs
- Approval of the internal regulation on the organisation and functioning of GDIP.
- Adoption of the structure and organisational chart of GDIP with the proposal of the General Director upon approval of the Minister responsible for the public administration and the Minister responsible for finances.
- Adoption of GDIP financial program and draft-budget, which afterwards will be approved by the Council of Ministers
- Approval of the project on the level of salaries of GDIP employees, which afterwards will be approved by the Council of Ministers

- Miratimi çdo vit i kriterëve dhe masave për shpërblimet stimuluëse të personelit përfektivitetin e shërbimit të kryer në DPPI, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm
- Miratimi i kushteve, afateve dhe procedurave për ofrimin e shërbimeve me mjete
- elektronike nga DPPI-ja, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm.

Në mbështetje të Nenit 189/b, të Ligjit Nr.9947, datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale”, i ndryshuar, me urdhërin Nr.2272/4, datë 24.04.2017, të ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, “Për ngritjen e Këshillit Mbikëqyrës të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, është ngritur Këshilli Mbikëqyrës i DPPI-së, me një mandat tre vjeçar.

Këshilli Mbikëqyrës viti 2018

Në mbështetje të nenit 189/b, të ligjit nr.9947, datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale”, i ndryshuar, me urdhërin nr.2272/4, datë 24.04.2017, të ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, “Për ngritjen e Këshillit Mbikëqyrës të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, është ngritur Këshilli Mbikëqyrës i DPPI-së, me një mandat tre vjeçar.

Këshilli Mbikëqyrës i DPPI-së përbëhet nga:

1. Znj.Vilma Çausholli, financier, kryetar;
2. Znj.Vjollca Vasjari, jurist, anëtar;
3. Znj.Artemis Dralo, këshilltar i Kryeministrit për Ekonominë;
4. Znj. Milena Memsuri, sekretare teknike.

Këshilli Mbikëqyrës i DPPI-së, për vitin 2018 ka marrë vendimet si më poshtë:

- Vendim nr.1, datë 10.07.2018 “Për zgjedhjen e kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës”;
- Vendim nr.2, datë 10.07.2018 “Për detajimin e buxhetit për vitin 2018, për Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale”;

- Annual approval of the criteria and measures for the staff remunerations, on the effectiveness of the services provided to GDIP, as proposed by the General Director
- Approval of the terms, conditions and procedures of service provision through
- electronic means from GDIP, as proposed by the General Director.

Pursuant to Article 189/b, of Law No.9947, dated 07.07.2018 “On industrial Property”, as amended, by order No. 2272/4, dated 24.04.2017, of the Minister of Economic Development, Tourism, Trade and Enterprise, “On establishing the Supervisory Council of the General Directorate of Industrial Property”, the Supervisory Council of GDIP was established with a three year term.

Supervisory Council 2018

Pursuant to Article 189/b, of Law No.9947, dated 07.07.2018 “On industrial Property”, as amended, by order No. 2272/4, dated 24.04.2017, of the Minister of Economic Development, Tourism, Trade and Enterprise, “On establishing the Supervisory Council of the General Directorate of Industrial Property”, the Supervisory Council of GDIP was established with a three year term.

GDIP Supervisory Council consists of:

1. Mrs. Vilma Çausholli, accounting expert, chairman;
2. Mrs.Vjollca Vasjari, jurist, member;
3. Mrs. Artemis Dralo, Economic Advisor to Prime Minister;
4. Mrs. Milena Memsuri, technical secretary.

The Supervisory Council of GDIP for 2018 has made the following decisions:

- Decision no. 1, dated 10.07.2018 “On Election of the Chairman of the Supervisory Council”;
- Decision no. 2, dated 10.07.2018 “On the detailed budget for 2018 for the General Directorate of Industrial Property”;

- Vendim nr.3, datë 10.07.2018 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së DPPI-së”;
- Vendim nr.4, datë 10.07.2018 “Për përcaktimin e katër punonjësve me kontratë të përkohshme, pranë DPPI-së, për vitin 2018”;
- Vendim nr.5, datë 15.10.2018 “Për rishpërndarjen e fondeve brenda buxhetit të miratuar, të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, për vitin 2018”
- Vendim nr.6, datë 14.12.2018 “Për miratimin e kriterëve dhe masat për shpërblimet stimulative të personelit për efektivitetin e shërbimit të kryer në DPPI”
- Vendim nr.7, datë 14.12.2018 “Për miratimin e programit financiar të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale dhe projekt-buxheti 01 janar - 31 dhjetor 2019”
- Vendim nr.8, datë 26.12.2018” Për disa ndryshime në programin financiar të vitit 2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale”.
- Decision no. 3, dated 10.07.2018 “On approval of the structure and organisational chart of GDIP”;
- Decision no. 4, dated 10.07.2018 “On the designation of four employees with a temporary employment contract at GDIP for 2018”;
- Decision no. 5, dated 15.10.2018 “On the redistribution of funds within the approved budget of the General Directorate of Industrial Property for 2018”;
- Decision no. 6, dated 14.12.2018 “On the approval of criteria and measures for staff remunerations, on the effectiveness of the services provided to GDIP”;
- Decision no. 7, dated 14.12.2018 “On the approval of the financial program of the General Directorate of Industrial Property and the draft budget 01 January - 31 December 2019”;
- Decision no. 8, dated 26.12.2018 “On some amendments to the 2018 Financial Program of the General Directorate of Industrial Property”.

REGJISTRIMI I OBJEKTEVE TË PRONËSISË INDUSTRIALE

REGISTRATION OF INDUSTRIAL PROPERTY OBJECTS

Ekzaminimi i objekteve të PI

Gjatë vitit 2018 janë depozituar në DPPI, **2235** aplikime të reja për rregjistrimin e objekteve të PI-së krahasuar me **1993** aplikime në total që ishin në vitin e kaluar nga të cilat:

1294 aplikime për marka, **921** aplikime për patenta, **16** aplikime për diseno industriale, **2** aplikime për tregues gjeografikë dhe emërtime origjine dhe **2** aplikime për modele përdorimi.

Gjatë procesit të ekzaminimit të këtyre objekteve janë lëshuar **1629** certifikata regjistrimi për aplikimet kombëtare në lidhje me objektet e PI, janë ripërtërirë **3692** regjistrime të objekteve të PI, si dhe janë shqyrtuar dhe pasqyruar në regjistër **420** ndryshime në lidhje me to.

Në total DPPI, gjatë ekzaminimit të aplikimeve të objekteve të PI në vitin 2018 ka hartuar dhe lëshuar **11 731** akte administrative në lidhje me objektet e Pronësisë Industriale si dhe ka publikuar **38** Buletine Zyrtare të Objekteve të PI.

Ndërkohë nga Sistemi i Madridit janë depozituar **2877** aplikime për marka ndërkombëtare nga të cilat **2843** janë rregjistruar, ndërsa nga Marëveshja e Hagës për regjistrimin ndërkombëtar të disenjove janë depozituar 137 aplikime ndërkombëtare për diseno industriale dhe janë rregjistruar **119** diseno industriale.

Theksojmë se, viti 2018 ka pasur numrin më të lartë të aplikimeve për marka ndër vite.

DPPI ka kryer në kohë dhe brenda afateve ligjore, shqyrtimin e dokumenteve, njoftimeve, publikimeve, skanimeve, skadimeve, dërgesat me postë dhe në formë elektronike të tyre, duke bërë të mundur që i gjithë procesi cilësor i ekzaminimit të kryhet me efikasitet dhe në kohë të shpejtë.

IP Objects Examination

During 2018, GDIP received **2235** new applications for the registration of IP objects, compared to a total of **1993** applications filed in the previous year, of which:

1294 trademark applications, **921** patent applications, **16** industrial design applications, **2** applications for geographical indicators and appellations of origin, and **2** utility models applications.

During the examination process of these objects, **1629** registration certificates for national applications related to IP objects have been issued, **3692** registrations of IP objects have been renewed, and **420** changes have been reviewed and reflected in the register.

During the examination of applications of IP objects in 2018, GDIP has compiled and issued **11 731** administrative acts related to Industrial Property objects and has published **38** Official Bulletins of IP Objects.

Meanwhile, from the Madrid system, **2877** applications for international trademark have been filed, of which **2843** have been registered, whereas from the Hague Agreement on International Registration of Industrial Designs, **137** international industrial design applications have been filed and **119** industrial designs have been registered.

We emphasize that in 2018 the number of applications for trademarks has been the highest over the years.

The revision of documents, notifications, publications, scans, deadlines, mail or email deliveries has been carried out in time and within the legal deadlines by GDIP, enabling an efficient and quick examination process.

TË DHËNA STATISTIKORE 2016 - 2018

STATISTICAL DATA 2016 - 2018

PATENTA PËR SHPIKJE DHE MODELE PËRDORIMI INVENTION PATENTS AND UTILITY MODELS	2016	2017	2018
Kërkesa për regjistrimin e patentave kombëtare Request for registration of national patents	23	24	15
Kërkesa për regjistrimin e modeleve të përdorimit (kombëtare) Request for registration of utility models (national)	4	1	2
Kërkesa për shtrirje /vlefshmëri të patentave nga EPO Request for extension/validation of patents by EPO	720	789	903
Kërkesa për regjistrimin e patentave nga PCT Request for registration of patents by PCT	2	0	
Kërkesa për regjistrim ndërkombëtar të patentave Shqiptare Request for international registration of Albanian patents	0	1	0
Totali kërkesave për regjistrimin e patentave Total requests for registration of patents	745	813	921
Kërkesa për regjistrimin e certifikatës së mbrojtjes shtesë (SPC) Request for registration of supplementary protection certificate (SPC)	9	5	5
Kërkesa për ripërtëritjen e patentës Request for patent renewal	2772	3110	3338
Kërkesa për ndryshime në regjistrin e patentave Requests for changes in the patents register	104	113	97
Kërkesa për rivendosje në afat të patentës Requests on renewal of the patent	4	7	9
Numri i patentave të regjistruara Number of registered patents	679	770	827
MARKA TREGTARE / TRADE MARKS			
Kërkesa për regjistrimin e markës në fazë kombëtare Request for registration of national trademark	1055	1161	1293
Kërkesa për regjistrimin e markave nga sistemi i Madridit Request for registration of trademarks from the Madrid system	2758	2622	2971
Totali kërkesave për regjistrimin e markave tregtare Total requests for registration of trademarks	3813	3783	4264
Aplikim për regjistrimin ndërkombëtar të markave Shqiptare Application for international registration of Albanian trademarks	6	11	16
Kërkesa për ripërtëritjen markave Request for patent renewal	625	515	517
Kërkesa për ndryshime në regjistrin e markave Request for changes in the patents register	465	314	438
Numri i markave në fazë kombëtare të regjistruara Number of national registered trademarks	1053	803	790
Numri i markave të regjistruara nga sistemi i Madridit Number of trademarks registered from the Madrid System	2403	2731	2845
DISENJO INDUSTRIALE / INDUSTRIAL DESIGNS			
Kërkesa për regjistrimin e disenjove industriale Request for the registration of industrial designs	9	12	16
Totali kërkesave për regjistrimin e disenjove industrial Total requests for registration of industrial designs	10	13	16
Kërkesa për ripërtëritjen disenjove industriale Request for renewal of industrial designs	6	8	4
TREGUES GJEOGRAFIKË / GEOGRAPHICAL INDICATIONS			
Kërkesa për regjistrimin e treguesit gjeografik dhe emërtimeve të origjinës Request for registration of geographical indication and appellations of origin	2	6	2



I. SEKTORI I PATENTAVE

I. PATENT SECTOR

Raport mbi punën e Drejtorisë së Ekzaminimit për vitin 2018

Përkufizimet:

Patentat e shpikjeve:

Patentat jepet për shpikje, në të gjitha fushat e teknologjisë, me kusht që:

- të përbëjë risi,
- përmbajnë hap shpikës (duke pasur parasysh arritjen e mëparshme), shpikja nuk ka qenë e kapshme nga një person i kualifikuar në fushën e arritjes, ku përfshihet ajo,
- të jetë e zbatueshme në industri, përfshirë edhe bujqësinë.

Modele përdorimi:

Trajtimi i modeleve të përdorimit është i njëjtë me trajtimin e patentave, që parashikohet në ligjin 9947 datë 7.7.2008 "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar.

Sektori i Patentave dhe Modeleve të Përdorimit gjatë vitit 2018 ka kryer si detyra kryesore funksionale ekzaminimin e Patentave dhe Modeleve të Përdorimit dhe mbajtjen e tyre në fuqi.

Me hyrjen në fuqi të ligjit "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar është bërë shumë punë për implementimin me ndryshimet në rregulloret për përshtatjen me kuadrin ligjor

Report on the work of the Examination Directorate for 2018

Definitions:

Invention Patents:

Patents are issued for inventions in all areas of technology, provided that:

- they introduce innovation,
- involves an inventive step (considering the previous achievement), the invention was not reachable by a qualified person in the achievement field, where it is involved.
- they are applicable to industry, including agriculture.

Utility Models:

Utility models are treated in the same way as patents, as provided for in Law no. 9947, dated 07.07.2008 "On Industrial Property", as amended.

The main functional task of the Patent and Utility Models Sector for 2018 was to examine patents and utility models and ensure their applicability.

Upon entry into force of the Law "On Industrial Property", as amended, a lot of work was done regarding its implementation on the amendments to the regulations for the compliance with the legal framework.

"Shtatë mëkatet fatale" të shpikësit

1

Shpikja për të zgjidhur problemin është më e ndërlikuar se nevojitet.

3

Shpikja nuk sjell risi.
"Më vjen keq që po ju zhgënjëj por...!"

5

Nuk I do askush

7

Shpikësi ka një ide jo të saktë të vlerës së shpikjes.

2

Shpikja nuk mbahet sekret deri ne datën e aplikimit.
"Mos I trego askujt por..."

4

Shpikësi nuk e ka konsideruar tërësisht problemin

6

Shpikja është më e sigurt nëse mbahet sekret.

© EPA / EPO / OEB

Bazuar në objektivat kryesore të Drejorisë së Ekzaminimit, Sektori i Patentave dhe Modeleve të Peërdorimit ka përbushur këto detyra kryesore:

Based on the main objectives of the Examination Directorate, The Patent and Utility Models sector has completed the following principal tasks:

Veprime Patenta	Viti 2017	Viti 2018	Totali
Veprime në sistem Actions related to patents	1902	1981	79
Ripërtëritje të patentave Activity in the system	2697	3151	454
Refuzime ripërtëritje patente Patent renewal	74	28	-46
Njoftime në aplikime Refusal on patent renewal	353	524	171
Ndryshime në patente Patent Modifications	130	89	-41
SPC SPC	5	5	0
Modele përdorimi Utility Models	3	2	-1
Patenta kombëtare National patents	11	13	2
PCT PCT	0	3	3
Patenta Evropiane European Patents	744	808	64
Skadime patentash Patent expiry	166	163	-3
Rivendosje në afat Restoration within the deadline	7	8	1
Refuzime patente Patent refusals	23	9	-14
PA Ekstrakt No extract	0	1	1
Hetime patente Patent investigations	30	43	13
Korrigjime në aplikime Application Corrections	33	50	17
OD Printing OD Printing	3696	4183	487
SOD Printing SOD printing	548	527	-21
Veprime në total Total Actions	4244	4710	466



I. PËRMIRËSIMI LIGJOR

I. LEGAL IMPROVEMENT

A. Hartimi i Rregullores së re të patentave mbështetur në ndryshimet e reja ligjore të Ligjit Nr. 9947, datë 07.07.2008 "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar.

Në zbatim të ligjit të ri nr. 17/2017 të miratuar, lindi nevoja e ndryshimeve dhe në rregulloren e patentave. Aktualisht gjatë këtij viti është punuar dhe janë përfunduar ndryshimet e reja dhe është përgatitur relacioni shpjegues për këto ndryshime.

Pas marrjes së mendimeve dhe sugjerimeve mbi Rregulloren e Patentave, në korrik të vitit 2018 u miratua Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 460, datë 26.7.2018 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr. 1707, datë 29.12.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullore për lëshimin e patentave për shpikjet dhe modelet e përdorimit", të ndryshuar (FZ Nr. 114/18).

B. Hartimi i Rregullores së re të tarifave mbështetur në ndryshimet e reja ligjore të Ligjit Nr. 9947, datë 07.07.2008 "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar.

Gjatë këtij viti është punuar dhe janë hartuar ndryshimet e reja, të cilat janë pasqyruar në VKM e tarifave për objektet e IP-së. Konkretisht, janë rritur tarifat mbi mbajtjen në fuqi të patentave si dhe mbi ndryshimet në regjistrin e PI-së.

Bazuar mbi këto ndryshime, në maj të vitit 2018 u miratua Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 316, datë 31.5.2018 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr. 883, datë 13.5.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale", të ndryshuar (FZ Nr. 82/18)

1. Hartimi i Udhëzuesit të Patentave

Në kuadër të përmirësimit të punës së ekzaminimit dhe si rezultat i rritjes së cilësisë së punës me patentat kombëtare, lindi nevoja e një

A. Drafting of the new Patent Regulation based on the new legal amendments of Law no. 9947, dated on 07.07.2008 "On Industrial Property", as amended.

Pursuant to Law no. 17/2017, adopted, there was a need for amendments even in the patent regulation. Throughout this year, a lot of work has been done, new changes have been completed and the explanatory report on these changes has been prepared.

Upon receiving opinions and suggestions on the Patent Regulation, in July 2018, the Decision of the Council of Ministers no. 460, dated 26.7.2018 "On some amendments and additions to Decision no. 1707, dated 29.12.2008, of the Council of Ministers, "On the adoption of a Regulation on invention patents issuance and utility models", as amended; (OJ No. 114/18).

B. Drafting of the new Fee Regulation based on the new legal amendments of Law no. 9947 , dated on 07.07.2008 "On Industrial Property", as amended.

Throughout this year, a lot of work has been done and new amendments have been drafted, which are reflected in the DCM "On fees for IP objects". Specifically, fees on applicability of patents and changes to the IP register have increased.

These amendments were approved in May 2018 by Decision of the Council of Ministers no. 316, dated 31.5.2018 "On some amendments and additions to Decision no. 883, dated 13.5.2009, of the Council of Ministers, "On the approval of registration fees for industrial property objects", as amended, (OJ No. 82/18)

1. Drafting a Patent Manual

In order to improve the examination process and as a result of increasing the quality of work with national patents, there was a need for a

udhëzuesi për të ekzaminuar dhe përmirësuar punën e ekzaminimit. Si rezultat, është përpiluar një udhëzues me praktikën konkrete, procedurën, hapat e ndjekur dhe veprimet që duhen kryer për ekzaminimin e patentave. Kjo praktikë është shoqëruar edhe me shembuj konkretë të rasteve të ndryshme të patentave, për ta kuptuar më mirë dhe për të parë praktika të ngjashme si duhet vepruar, pavarësisht se shpikjet janë të kategorive të ndryshme dhe gjykimi i ekzaminuesve është subjektiv.

2. Reforma e deregulimit

Në kuadër të reformës së deregulimit të ndërmarë nga qeveria për përmirësimin e shërbimeve, rritjen e cilësisë së shërbimit dhe thjeshtësimin e procedurave për qytetarët është kryer një punë voluminoze për:

- I. Identifikimin e shërbimeve që DPPI ofron;
- II. Përcaktimin e llojeve të shërbimeve dhe emërtimin e saktë të tyre;
- III. Përgatitjen e formularëve të unifikuar dhe standardizuar nga ADISA;
- IV. Përgatitjen e kartelave të shërbimeve;
- V. Përfshirjen e kartelave dhe formularëve në sistemin e shërbimit e-albania.

Kjo procedurë është kryer nga punonjësit e DPPI duke bashkëpunuar dhe asistuar me ADISA.

manual to review and improve the examination process. Therefore, a manual was drawn up, containing the concrete practice, the procedure, the steps followed and the actions to be taken to examine the patents. This practice was also accompanied by concrete examples of different patent cases in order to better understand them and see similar practices on how to act, despite the fact that the inventions belong to different categories and the examiners' reasoning is subjective.

2. The deregulation reform

In the framework of government's deregulation reform to improve services, enhance the quality of service and facilitate procedures for citizens, an intensive work has been carried out to:

- I. Identify services provided by GDIP;
- II. Determine the types of services and their exact name;
- III. Draft unified forms, standardized by ADISA;
- IV. Draft of the service files;
- V. Integration of files and forms in the e-albania electronic service system

This procedure was carried out by GDIP employees, in cooperation and assisted by ADISA.

1. Përmirësimi i cilësisë së ekzaminimit

Ky është një proces në vijim inisur që me hyrjen në fuqi të ligjit të ri nr. 17/2017 "*Për Pronësinë Industriale*", i ndryshuar. Janë shkurtuar afatet e dhënies të dëshmisë së depozitimit për aplikantët. Tashmë, aplikanti menjëherë me depozitimin e dokumentacionit në DPPI pajiset me një datë depozitimi dhe një dokument të lëshuar nga zyra përkatëse si "Dëshmia e Depozitimit".

Përmirësimi i cilësisë së shërbimit vazhdon me strukturimin e ri dhe krijimin e zyrës së pritjes dhe informimit. Kjo zyrë do të thjeshtojë procedurat për aplikantët dhe do të shpejtojë dhënien e informacionit nga një personel i kualifikuar.

Krijimi i Zyrës së Pritjes, sipas strukture së re të DPPI-së do të ndikojë edhe në shkurtimin e afateve të ekzaminimit të patentave. Gjithashtu, do të thjeshtojë dhe një sërë shërbimesh që më parë kryheshin në zyrën e patentave si hetime, ekstrakte apo inspektime dosjesh. Këto veprime thjeshtojnë dhe shkurtojnë kohën e marrjes së shërbimit nga qytetarët, bizneset apo palët e interesuara.

2. Aktivitete në kuadër të promovimit të Pronësisë Industriale (PI-së)

Në kuadër të informimit dhe promovimit të objekteve të PI-së Sektori i Patentave ka marrë pjesë dhe ka referuar në aktivitete për pronësinë industriale në fushën e përgjegjësisë.

Për përmirësimin e cilësisë, i cili është një ndër prioritetet e zyrës së patentave, ka kontribuar në dhënien e asistencës teknike kundrejt shpikësve të rinj, të cilët kanë aplikuar për një patentë kombëtare duke i dhënë konsultë profesionale pranë ambienteve të institucionit në lidhje me dokumentacionin bazë. Gjithashtu, konsulencë i është dhënë dhe studentëve, të cilët kanë

1. Examination quality improvement

This is an ongoing process that started since the entry into force of the new Law no. 17/2017 "*On Industrial Property*", as amended. The applicants' deadlines for filing Deposit Certificates have been reduced. Now the applicant, upon filing the documentation at GDIP, is also provided with a deposit date accompanied by an official document issued by the relevant office, which is the "Deposit Certificate".

Service quality improvement continues with the implementation of the new structure and the establishment of the Reception and Information Office. This office will facilitate the procedures for the applicants and will accelerate the information provision process by a qualified staff.

The establishment of the Reception Office, under the new GDIP structure, will also affect the shortening of the review terms for patents. It will also simplify a range of services previously performed at the patent office, such as investigations, extracts or file inspections. These undertakings simplify and shorten the term of receiving service towards citizens, businesses or stakeholders.

2. Activities in the Framework of Industrial Property Promotion (IP)

In the framework of information and promotion of IP objects, the Patent Sector has participated in activities and has reported regarding industrial property in the area of responsibility.

For quality improvement, which is one of the priorities of the patent office, it has contributed to the provision of technical assistance to new inventors who applied for a national patent, by providing professional consultancy at the premises of the institution regarding basic documentation. In addition, consultancy has also been provided to students, who demonstrated interest

dëshirë dhe kurajo të zhvillojnë inovacionin dhe teknika të reja që lidhen me fushën e shpikjes.

Si rezultat gjatë këtij viti ka pasur dy aplikime nga studentët dhe tre aplikime nga biznesi.

3. Skanimi dhe rregjistrimi i dosjeve të patentave

Në mungesë të stafit të Sektorit të Patentave dhe Modeleve të Përdorimit, stafi aktual ka skanuar të gjitha dokumentet hyrëse dhe dalëse të patentave për vitin 2018. Si rezultat, janë skanuar 26.450 dokumente.

4. Regjistrimi i Patentave dhe Modeleve të përdorimit

Sektori i patentave ka kryer në kohë dhe brenda afateve ekzaminimin e patentave dhe modeleve të përdorimit. Nga sektori i patentave dhe modeleve të përdorimit kanë dalë njoftime të ndryshme rreth dokumenteve të depozituara, pranime, publikime, skanime, njoftime për riper-teritje patente etj.

I gjithë ky proces është kryer në kohë dhe me përgjegjësi të lartë. Gjatë vitit 2018 janë depozituar gjithsej 4.300 dokumente për t'u shqyrtuar.

and were encouraged to develop innovations and new techniques related to inventions.

As a result, this year we received two applications from students and three from business.

3. Scanning and Registration of Patent Files

In the absence of staff of the Patent and Utility Models Sector, the current staff has scanned all the incoming and outgoing documents for 2018. As a result, 26.450 documents have been scanned.

4. Registration of Patents & Utility Models

The examination of patents and utility models was carried out in time and within the given deadlines by the Patent Sector. The Patent and Utility Models Sector has issued various notices about deposited documents, receipts, publications, scans, notices for patent renewal, and so on.

This whole process was carried out on time and with high level of responsibility. In 2018, a total of 4.300 documents were filed for review.



TË DHËNA STATISTIKORE PËR VITIN 2018

STATISTICAL DATA FOR 2018

PATENTAT E SHPIKJEVE DHE MODELET E PERDORIMIT

Sektori i ekzaminimit të patentave, ka si detyrë funksionale regjistrimin e aplikimeve të objekteve të pronësisë industriale si patentat e shpikjeve, dhe modelet e përdorimit si dhe administrimin e regjistrave të këtyre objekteve. Ky sektor, gjatë këtij viti ka përbulluar një volum të madh pune dhe ka realizuar të gjitha detyrat e ngarkuara në kohë dhe me cilësi.

Sektori i Patentave gjatë vitit 2018 ka pranuar **921** aplikime për patenta krahasuar me **813** aplikime të depozituara në vitin 2017, pra kemi një rritje prej **13.2 %** të numrit të aplikimeve për patenta. Nga këto aplikime, 15 aplikime janë aplikime kombëtare me aplikantë nënshtetas Shqiptarë, dhe **906** aplikime për patenta, janë patenta të lëshuara nga Zyra Evropiane e Patentave të cilat kërkojnë mbrojtje në Shqipëri.

INVENTION PATENTS AND UTILITY MODELS

The patent examination sector has the operational duty of registering applications for industrial property objects such as invention patents and utility models, as well as the administration of these objects registers. This sector, during this year has been faced with a large volume of work and has completed in time and and with high quality all the tasks assigned.

During 2018, the patent sector received **921** patent applications, compared to **813** filed applications in 2017, thus indicating an increase of **13.2 %** of the number of patent applications. **15** of which are national applications from applicants of Albanian nationality, and **906** patent application relate to patents issued by the European Patent Office, which request protection in Albania.


APLIKIME / APPLICATIONS	Viti 2017 Year 2017	Viti 2018 Year 2018	% e rritjes Increase in %
Aplikime për patentë kombëtare National Patent Application	24	15	-37.5%
Patenta nga Zyra Evropiane e Patentave Patent from European Patent Office	789	903	14.5%
Aplikime nga Traktati i Bashkëpunimit në fushën e patentave Applications from Patent Cooperation Treaty	0	3	3 fishuar Tripled
TOTALI / TOTAL	813	921	13.2 %

Utility Model Applications.


Aplikime për Model Përdorimi.

APLIKIME / APPLICATIONS	Viti 2017 Year 2017	Viti 2018 Year 2018
Aplikime për Model Përdorimi Utility Model Applications	1	2

Aplikime për patenta Kombëtare



Patenta Evropiane



Grafiku tregon rritjen e numrit të **Patentave Evropiane** të cilat kërkojnë mbrojtje në vendin tonë. **Numri i patentave Evropiane të cilat kërkojnë mbrojtje në vendin tonë, është dyfishuar në krahasim me vitin 2015.**

The graph shows the increase in the number of **European Patents**, which request protection in our country. **The number of European patents which request protection in our country has doubled compared to 2015.**

Aplikime për patenta



Grafiku i mëposhtëm tregon aplikimet për patenta të depozituara në vite. **Edhe këtu shihet qartë se numri i aplikimeve në vitin 2018 është dyfishuar krahasuar me vitin 2015.**

Gjatë vitit 2018, sektori i patentave ka lëshuar **4710** akte administrative brenda afateve të parashikuara në ligj dhe në rregulloren e patentave.

Gjatë vitit 2018 janë futur **921 aplikime për patenta**, nga të cilat **906 janë Patenta Evropiane, 15 patenta kombëtare**, tre janë patenta PCT dhe dy janë modele përdorimi.

Janë ripërtërirë **3338 patenta** dhe janë bërë ndryshime në regjistrë për **89 patenta**.

Akte administrative të lëshuara nga sektori i patentave

Tabela e mëposhtme tregon kërkesat si dhe aktet e lëshuara nga DPPI në vitin 2018:

The graph below shows the patent applications filed over the years. **Here also, it is clear that the number of applications in 2018 has doubled compared to 2015.**

During 2018, the patent sector has issued **4710** administrative acts within the deadlines provided by the law and the patent regulation.

Gjithashtu, u prezantuan politikat për zhvillimin e inovacionit dhe programet mbështetëse të BE-së.

Industrial Property and innovation were of particular interest to this university, which has significant potential regarding creativity. The subject of creative work protection was of interest and the participants were very active during the discussions.

In this workshop participated the Rector of the University, Dr. Besnik Aliaj, heads of departments and professors of this university.

In this workshop participated also representatives from the General Directorate of Industrial Property (GDIP) and the Agency of Scientific Research and Innovation (ASRI), who presented the industrial property system and the protection of industrial property objects.

They also presented the policies for innovation development and EU support programs.



ANALIZA E PRONËSISË INTELEKTUALE INTELLECTUAL PROPERTY ANALYSIS



Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale filloi me aktivitetet e Javës së Pronësisë Intellektuale 2018

The General Directorate of Industrial Property started with the activities of the 2018 Intellectual Property Week

DITA I

DAY I


JAVA E PRONËSISË INTELEKTUALE:

KONKURSI “KRIJIMI MË I MIRË NË FUSHËN E PIKTURËS, DIZAJNIT, SHPIKJES NË SPEKTRIN E PRONËSISË INTELEKTUALE”, “KRIJIMTARIA E BREZIT TË RI NË SPEKTRIN E PRONËSISË INTELEKTUALE”

INTELLECTUAL PROPERTY WEEK:

THE COMPETITION “BEST COMPOSITION IN THE FIELD OF PAINTING, DESIGN, INVENTIONS IN THE FRAMEWORK OF INTELLECTUAL PROPERTY”, “CREATIVITY OF THE NEW GENERATION IN THE FRAMEWORK OF INTELLECTUAL PROPERTY”





Zhvilluam në bashkëpunim me Drejtorinë e së Drejtës së Autorit dhe me mbështetjen e Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, në mjediset e “REJA”, konkursin me shkollat e mesme të kryeqytetit me tematikë **“Krijimi më i mirë në fushën e pikturës, dizajnit, shpikjes në spektrin e pronësisë intelektuale”**, **“Krijimtaria e Brezit të ri në Spektrin e Pronësisë Intelektuale”** konkretizuar dhe materializuar në formën e punimeve të ideuara nga vetë nxënësit. **Ky ishte një** nga aktivitetet më të larmishme dhe me një sërë punimesh shumë të bukura

In cooperation with the Copyright Directorate and with the support of the Chamber of Commerce and Industry of Tirana, in the facilities of “REJA”, we organised the competition between the high schools of the capital with the theme **“Best Work in the Field of Painting, Design, Inventions in the framework of Intellectual Property”**, **“Creativity of the New Generation in the framework of Intellectual Property”** brought in the form of works designed by the students themselves. This was one of the most diverse activities which presented a series of

të krijuara nga nxënësit e shkollave të mesme të përgjithshme të Tiranës. Në këtë konkurs nuk munguan prurjet si në fushën e artit, ashtu edhe në krijimin e markave, disenjove dhe ideve për shpikje. Ndarja e çmimeve midis dhjetrave nxënës të talentuar ishte mjaft e vështirë, pasi kishin kapur mjaft mirë thelbin e pronësisë intelektuale në kuadër të kësaj dite.

Kënaqësi të punosh me brezat e rinj dhe të ndash me ta emocione të tilla. Promovimi i Pronësisë Intelektuale është aktivitet në kuadër të Strategjisë kombëtare të PI 2016-2020. Çmimet u ndanë për nxënësit fitues si mëposhtë:

- ✓ **Vendin e parë e fitoi nxënësi Noel Grosha**, në gjimnazin Petro Nini Luarasi ku iu dhuruan libra dhe një vlerë simbolike monetare dhënë nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë.
- ✓ **Vendin e dytë e fituan nxënëset Sindi Dallashi dhe Matilda Luca** dhe
- ✓ **Vendin e Tretë e fituan dy nxënëset Kiara Abdiu dhe Brikena Aliçauhaj.**

Për vendin e dytë dhe të tretë u dhuruan libra, ndërkohë për të gjithë nxënësit pjesëmarrës u shpërndanë certifikata.

very beautiful works designed by the students of the high schools in Tirana. This competition had no shortage in the field of art, as well as in the creation of trademarks, designs and invention ideas. Selecting the winners of the awards among dozens of talented students was quite difficult, as they had perfectly captured the essence of intellectual property in the framework of this day.

It is a pleasure to work with new generations and share such emotions with them. Promoting Intellectual Property is an activity within the framework of IP National Strategy 2016-2020. Awards were granted to the winning students as follows:

- ✓ **The first place award was given to Noel Grosha**, student at Petro Nini Luarasi High School. As such he received books and a small sum of money by the Tirana Chamber of Commerce and Industry.
- ✓ **Second place award was given to students Sindi Dallashi and Matilda Luca** and
- ✓ **Third place award was given to two students Kiara Abdiu and Brikena Aliçauhaj.**

The second and third place also received books, while all the participating students were given certificates.

DITA E II


JAVA E PRONËSISË INTELKTUALE:
TAKIM ME SHOQATEN E GRAVE SHGPZ



DAY II

INTELLECTUAL PROPERTY WEEK:
MEETING WITH THE AWBPSC WOMEN'S ASSOCIATION





Aktiviteti ynë i datës 24. 04. 2018 në kuadër të javës së Pronësisë Intelktuale ishte takim me Shoqatën e grave SHGPAZ, e cila është një nga shoqatat më të vjetra në Shqipëri, e krijuar në vitin 1992 dhe është e njohur në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare. Misioni i këtij grupi është emancipimi i grave shqiptare nëpërmjet rritjes së autoritetit të tyre në të gjitha profesionet, mjeshtritë dhe sipërmarrjet. Pa dyshim në fokus mbetet mbështetja dhe inkurajimi në aktivitetin e tyre ekonomik, profesional e artizanal.

Ndërsa strategjia e shoqatës është suporti real i zhvillimit të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme të drejtuara nga gratë në Republikën e Shqipërisë. Slogani i këtij viti ishte:

• **“Forca e ndryshimit: Gratë në Inovacion dhe në Krijimtari”**

Nga diskutimet e kryera ndërmjet drejtuesve të shoqatës dhe përfaqësuesve të DPPI-së doli në pah rëndësia e mbrojtjes së markave dhe e bashkëpunimit për promovimin e PI-së në rrethin e grave sipërmarrëse dhe krijuese.

On 24 04. 2018 in the framework of the Intellectual Property Week a meeting was held with the AWBPSC Women’s Association, which is one of the oldest associations in Albania, established in 1992 and well-known at national and international level. The scope of this association is the emancipation of Albanian women by increasing their authority in all professions, handicraft and entrepreneurship. Undoubtedly, the focus remains the support and encouragement in their economic, professional and handicraft activities.

While the association’s strategy is providing real support for the development of micro, small and medium-sized enterprises run by women in the Republic of Albania. This year’s slogan was:

• **“Powering change: Women in innovation and creativity”**

From discussions held between association leaders and GDIP representatives was highlighted the importance of trademark protection and co-operation for the promotion of IP in the network of entrepreneurial and creative women.

DITA III

JAVA E PRONËSISË INTELLEKTUALE: TAKIM ME GRATË SIPËRMARRËSE

DAY III

INTELLECTUAL PROPERTY WEEK: MEETING WITH WOMEN ENTREPRENEURS



Më datë 25 prill 2018 në vëmendjen tonë dhe pjesë e aktiviteteve që u zhvilluan në javën e pronësisë intelektuale ishte takimi me gratë sipërmarrëse me sloganin:

• ***“Forca e ndryshimit: është Gruaja në Inovacion dhe Krijimtari”***

Kompania “Design by Pana” që merret me riciklimin e drurit dhe ndërton objekte me porosi në varësi të klientëve me mbetjet drusore. Sipërmarrësja është znj. Pezana Rexha, e cila ka ndërmarrë këtë iniciativë të suksesshme prej vitesh dhe operon pothuajse të gjithë tregun shqiptar. DPPI ishte pranë këtij biznesi për të promovuar rëndësinë që mbart sistemi i pronësisë industriale.

On April 25, 2018, as part of the activities that took place during the week of intellectual property was the meeting with female entrepreneurs with the slogan:

• ***“Powering change: Women in innovation and creativity”***

“Design by Pana” company works with wood recycling and builds customer-tailored objects with wood waste. The entrepreneur is Mrs. Pezana Rexha, which has undertaken this successful initiative some years ago and operates in almost the entire Albanian market. GDIP visited this business to promote the importance of the industrial property system.

DITA IV

JAVA E PRONËSISË INTELEKTUALE:
**LEKSION I HAPUR NË UNIVERSITETIN
POLITEKNIK TË TIRANËS**

DAY IV

INTELLECTUAL PROPERTY WEEK:
**OPEN LECTURE IN THE POLYTECHNIC
UNIVERSITY OF TIRANA**



Më datë 26 prill 2018 në ditën Botërore të Pronësisë Intelektuale, u zhvillua një leksion i hapur në Universitetin Politeknik të Tiranës. Tematika e leksionit ishte një ndërthurje e koncepteve dhe specifikave të mbrojtjes së objekteve të Pronësisë Industriale dhe të së Drejtës së Autorit. Pjesëmarrës në këtë leksion ishin studentë dhe pedagogë të studimeve master të inxhinierisë ekonomike të këtij universiteti. Lektorë në këtë event ishin përfaqësues nga DPPI dhe Drejtoria e së Drejtës së Autorit. Në përfundim të leksionit u shpërndanë libra, fletëpalosje dhe materiale të tjera promocionale. Aktivitetet e ardhshme me universitetet e vendit, janë gjithnjë në vëmendjen tonë për të nxitur inovacionin dhe për të nxitur krijimtarië të brezave të rinj.

“Pronësia Intelektuale është benzina e shekullit të 21”

(Cit. Mark Getty)

On April 26, 2018, on the World Intellectual Property Day, an open lecture was held at the Polytechnic University of Tirana. The subject of the lecture was a combination of concepts and specifications for the protection of Industrial Property and Copyright objects. Participants in this lecture were students and professors of the master degree level in economic engineering in this university. The lecturers at this event were representatives of the GDIP and the Copyright Directorate. At the end of the lecture, books, booklets and other promotional materials were distributed. Future activities with the country's university will continue to be in our focus with the aim to encourage innovation and promote creativity with the young generation.

“Intellectual Property is the oil of the 21st century”

(Cited. Mark Getty)

DITA V

JAVA E PRONËSISË INTELEKTUALE: TAKIM ME GRATË KRIJUESE NË FUSHËN E ARTIZANATIT



Më datë 26 prill 2018 vijuan takimet me gratë krijuese dhe sipërmarrëse, sepse slogani i ditës botërore të pronësisë intelektuale 2018 ishte:

“Forca ndryshimit: Gruaja në Inovacion dhe Krijimtari”

Drejtoria e Pronësisë Industriale u fokusua gjatë gjithë javës së PI-së të sjellë në vëmendje rolin e grave në inovacion.

DAY V

INTELLECTUAL PROPERTY WEEK: MEETING WITH CREATIVE WOMEN IN THE HANDICRAFT FIELD



On April 26, 2018, meetings were held with creative and entrepreneurial women, because the slogan for the 2018 World Intellectual Property Day was:

“Powering change: Women in innovation and creativity”

The Industrial Property Directorate was focused throughout the IP week to bring to everyone's attention the women's role in innovation.

Kompania “Tradita Popullore Edlira” është e gjitha iniciativë dhe krijimtari e një gruaje të suksesshme. Veshjet popullore dhe produktet e tjera tradicionale që ajo prodhon të mahnisin. DPPI ishte pranë këtij biznesi për të promovuar rëndësinë që mbart sistemi i Pronësisë Industriale.

“Produktet krijohen në fabrikë, markat krijohen në mendje”

(Cit. Walter Landor)

“Tradita Popullore Edlira” company was established only by the initiative and creativity of a successful woman. The traditional clothes and other traditional products which she produces are impressive. GDIP visited this business to promote the importance of the industrial property system.

“Products are created in the factory. Brands are created in the mind”

(Cited. Walter Landor)

DITA VI

KONFERENCA KOMBËTARE E PRONËSISË INTELLEKTUALE

“Forca e Ndryshimit: Gratë në Inovacion dhe Krijimtari dhe Sot mbushim 25 vjeç”.

DAY VI

NATIONAL CONFERENCE ON INTELLECTUAL PROPERTY

“Powering change: Women in innovation and creativity and Today we are 25”.





Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, më datë 27 Prill 2018, në vazhdim të zhvillimit të “Javës së pronësisë intelektuale 2018” e zhvilluar në kuadër të Ditës Botërore të Pronësisë Intelektuale dhe të 25 vjetorit të themelimit të Zyrës për Patentat e Shpikjeve organizoi një Konferencë Kombëtare me sloganin: *“Forca e ndryshimit: Gratë në Inovacion dhe Krijimtari dhe Sot mbushim 25 vjeç”*.

Në këtë konferencë morën pjesë përfaqësues të nivelit të lartë nga institucionet publike, universitetet, partnerët ndërkombëtarë, artistë të shquar, shpikës, biznese, ish drejtues të DPPI, dhomat e tregtisë dhe përfaqësues të autorizuar.

Në panelin kryesor të konferencës ishte z. Elton Haxhi, zv. Ministër i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë së Republikës së Shqipërisë, i cili prezantoi politikat dhe strategjinë kombëtare për Pronësinë Intelektuale 2016-2020.

Z Elvin Lako, Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, prezantoi arritjet e DPPI dhe përmirësimet e bazës ligjore në funksion të regjistrimit dhe mbrojtjes.

On April 27, 2018, the General Directorate of Industrial Property, following the “2018 Intellectual Property Week”, in the framework of the World Intellectual Property Day and the 25th anniversary of the establishment of the Invention Patent Office, organized a National Conference with the slogan: *“Powering change: Women in innovation and creativity and Today we are 25”*.

The conference was attended by high level representatives from public institutions, universities, international partners, distinguished artists, inventors, businesses, former GDIP directors, chambers of commerce and authorised representatives.

The conference’s main panel was composed of Mr. Elton Haxhi, deputy Minister of the Ministry of Finance and Economy of the Republic of Albania, who presented the National Strategy and Policies on Intellectual Property 2016-2020.

Mr. Elvin Lako, General Director of the General Directorate of Industrial Property, who presented the achievements of the GDIP and the improvements of the legal framework in

tjes më efikase të pronësisë industriale në vendin tonë, duke ofruar shërbime cilësore për regjistrimin e objekteve të PI, shqyrtimin e konflikteve, promovimin e PI dhe shërbimet e reja online për të lehtësuar aplikimet në DPPI. Ai u shpreh se në vitet e fundit, qëllimi ynë kryesor ka qenë rritja e cilësisë së shërbimit në standarde bashkëkohore për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale dhe mbrojtjen e tyre në Republikën e Shqipërisë. Arritja e këtij qëllimi kërkoj reformimin e sistemit të pronësisë industriale, reformë, e cila nisi që prej vitit 2015. Kjo reformë konsistoi në hartimin e strategjisë, përmirësimin e bazës ligjore dhe shërbimeve që DPPI ofron si dhe forcimin e kapaciteteve administrative.

Në mars të vitit 2017, hynë në fuqi ndryshimet në ligjin Nr. 9947, “*Për Pronësinë Industriale*”. Ndryshimet ligjore u hartuan në bashkëpunim të ngushtë me partnerët ndërkombëtarë si: Zyra Evropiane e Patentave, Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale, Zyra e Pronësisë Intelektuale e Bashkimit Evropian, Delegacioni i KE në Shqipëri, si dhe Z. Telmo Vilela, Drejtor i Kooperimit Ndërkombëtar, në Zyrën Evropiane të Patentave, i cili prezantoi rëndësinë e patentimit të shpikjeve nëpërmjet Konventës Evropiane të Patentave.

Pas fjalimeve të mbajtura në panelin e parë, për të pranishmit në konferencë u shfaq një dokumentar i përgatitur për historikun e DPPI dhe arritjet e saj ndër vite.

Në panelin e dytë ishin të pranishëm z. Mark C. Craëford, President i Dhomës Amerikane të Tregtisë në Shqipëri. Prezantimi i tij ishte mbi rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale dhe ndalimin e piraterisë mbi veprat artistike. Ai theksoi se sa i rëndësishme është roli i PI-së për nxitjen e krijimtarisë dhe inovacionit.

Znj. Albana Laknori, sekretare e përgjithshme pranë Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Tiranë u shpreh për rëndësinë që përbën promovimi i PI-së për biznesin dhe punën që DPPI po bën në këtë drejtim në bashkëpunim me dhomat e tregtisë.

Në këtë panel ishte e ftuar edhe shpikësja shqiptare znj. Blerina Xhabija, e cila tregoi shpikjet

order to register and protect more efficiently industrial property in our country by providing quality services for the registration of IP objects, conflict resolution, IP promotion and new online services to facilitate applications to GDIP. He stated that during the last years, our main goal has been to increase the quality of the services to contemporary standards for the registration of industrial property objects and their protection in the Republic of Albania. Achieving this goal required reforming the industrial property system - a reform which began since 2015. This reform consisted in drafting the strategy, improving the legal framework and the services provided by the GDIP and building administrative capacities.

In March 2017, amendments to Law no. 9947, “On Industrial Property” became effective. Legal amendments were drafted in close cooperation with international partners such as: European Patent Office, World Intellectual Property Organization, European Union Intellectual Property Office, the EC Delegation in Albania, and Mr. Telmo Vilela, Director of International Cooperation at the European Patent Office, who presented the importance of patenting inventions through the European Patent Convention.

After the speeches delivered in the first panel, a documentary prepared on the GDIP historical background and its achievements over the years was presented to the participants at the conference.

The second panel was composed of Mr. Mark C. Crawford, President of the American Chamber of Commerce in Albania. His presentation focused on the importance of protecting intellectual property rights and stopping piracy of artistic works. He stressed how important IP's role is to promote creativity and innovation.

Mrs. Albana Laknori, general secretary at the Tirana Chamber of Commerce and Industry, stated the importance of promoting IP to businesses and the work GDIP has been doing in this regard, in cooperation with the chambers of commerce.

Part of this panel was also the Albanian inventor, Mrs. Blerina Xhabija, who presented her inven-

e saj dhe rrugëtimin për mbrojtjen e tyre me patentë.

Në mbyllje të konferencës mbajti fjalën e saj përshëndetëse edhe shkrimtarja e mirënjohur shqiptare, znj. Diana Çuli, e cila theksoi rëndësinë e mbrojtjes së të drejtës së autorit.

Pjesëmarrja në këtë konferencë të vitit 2018 ishte shumë e gjerë, me rreth 200 pjesëmarrës nga të gjitha grupet e interesit të përfshira në sistemin e pronësisë industriale, por edhe studentë sipërmarrës, krijues të të gjitha fushave. Kjo tregon që interesi për të njohur sistemin e pronësisë intelektuale është gjithnjë në rritje dhe promovimi që DPPI zhvillon po jep frutet e saj të dukshme.

Ndër të veçantat e konferencës përmendim:

Celebrimi i 25 vjetorit të krijimit të DPPI.

Pjesëmarrja e të ftuarve nga Zyra Evropiane e Patentave dhe zyrat homologe të, Hungarisë, Maqedonisë së Veriut, dhe Kosovës.

Gjatë konferencës u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit për bashkëpunimin me zyrën homologe të Maqedonisë së Veriut, Enti Shtetëror për Pronësi Industriale.

Ky memorandum u nënshkrua nga Drejtorët e Përgjithshëm të të dy zyrave përkatëse z. Elvin Lako Drejtor i Përgjithshëm i DPPI dhe z. Safet Emruli, Drejtor i Përgjithshëm i Entit Shtetëror për Pronësi Industriale të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Organizimi i kësaj konferencë është bërë tashmë traditë për DPPI. Ky është event i kryesor në kuadër të aktiviteteve promovuese të Pronësisë Intelektuale në Republikën e Shqipërisë.

Gjithashtu, kjo konferencë është një rast i mirë për të vënë theksin edhe një herë në rolin që duhet të luajnë të gjitha institucionet publike, të cilat janë të përfshira në sistemin e pronësisë intelektuale në vendin tonë.

Me përfundimin e kësaj konference u finalizua me sukses “Java e pronësisë intelektuale 2018” e cila ishte një fushatë e gjerë aktivitete

tions and how she managed to get patent protection for them.

At the end of the conference, the closing remarks were held by the well-known Albanian writer, Mrs. Diana Çuli, who stressed the importance of copyright protection.

The attendance at this 2018 conference was very large, with about 200 participants from all interest groups involved in the industrial property system, as well as entrepreneurial students and inventors from various fields. This goes to show that the interest in familiarising with the intellectual property system is steadily increasing and the promotion carried out by the GDIP is ripening its fruits.

Some of the highlights from the conference are:

Celebration of the 25th anniversary of the GDIP establishment.

Participation of guests from the European Patent Office and counterpart offices from Hungary, North Macedonia, and Kosovo.

During the conference, a Memorandum of Understanding was signed for cooperation with the counterpart office of North Macedonia, the State Office of Industrial Property.

This memorandum was entered into by the General Directors of both respective offices, Mr. Elvin Lako Executive Director of the GDIP and Mr. Safet Emruli, General Director of the State Office of Industrial Property of the Republic of North Macedonia.

This conference has now become a tradition for GDIP. This is the main event in the framework of activities promoting Intellectual Property in the Republic of Albania.

In addition, this conference presents a great opportunity to underline once more the role to be played by all public institutions, included in the Intellectual property system in our country.

The end of this conference marked the successfully completion of “2018 Intellectual Property Week”, which was a wide campaign of promo-

promovuese që zhvilloi DPPI në datat 23-27 Prill 2018. Ndër këto aktivitete përmendim: Konkursin me shkollat e mesme për krijimin më të mirë në fushën e artit, logos, disenjos dhe idese innovative për shpikje me sloganin “Krijimtaria e brezit të ri në spektrin e Pronësisë Intelektuale”; Takime gjatë gjithë javës me gratë sipërmarrëse dhe krijuese; Leksione të hapura në universitetin Metropolitan të Tiranës dhe në universitetin Politeknik të Tiranës; Intervista në mediat audiovizive; Shfaqje në mediat audiovizive e spotit publicitar “25 vjet DPPI në shërbimin tuaj”.

Takim me Sekretaren e Përgjithshme të Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë (BDHTI)

tional activities carried out by GDIP on April 23-27, 2018. Some of the activities are as follows: Competition between High Schools for the Best Work in the Field of Art, Logo, Design and Innovative Innovation Idea with the slogan “Creativity of the New Generation in the framework of Intellectual Property”; Meetings during the week with entrepreneurial and creative women; Open lectures at the Metropolitan University of Tirana and Polytechnic University of Tirana; Interviews in audiovisual media; Broadcasting in the audiovisual media the advertisement “GDIP: 25 years at your service”.

Meeting with the Secretary General of the Union of Chambers of Commerce and Industry (UCCI)



Më datë 02.05.2018, në kuadër të zbatimit të aktiviteteve të parashikuara në Strategjinë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2016-2020 zhvilluam një takim me Sekretaren e Përgjithshme të Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë për të krijuar mundësinë e ngritjes së zyrave dhe stafit që do të funksionojnë si përfaqësues të autorizuar të PI-së, pranë dhomave të tregtisë në rrethe, për ti ardhur në ndihmë biznesit dhe duke ndërgjegjësuar atë, në lidhje me aplikimet për regjistrimin e objekteve të Pronësisë Industriale, duke evituar kështu problematikën që mund të kenë bizneset në rrethe për shkak të largësisë me DPPI.

On 02.05.2018, in the framework of the implementation of the activities provided for in the National Strategy on Intellectual Property 2016-2020, we held a meeting with the Secretary General of the Union of Chambers of Commerce and Industry to create the possibility of establishing offices and staff that will act in the capacity of IP representatives at the chambers of commerce in districts, to help and raise awareness of businesses regarding the applications for registration of Industrial Property objects, thereby avoiding the problems that businesses in districts may encounter because of their distance from GDIP.

Për këtë qëllim do të vijojnë bisedimet ndërmjet vetë drejtuesve të institucioneve për të gjetur zgjidhjet praktike për realizimin e kësaj nisme, si dhe do të harmonizohet kalendari i aktiviteteve në rrethe ndërmjet DPPI dhe BDHTI, për të shkuar pranë biznesit në rrethe duke zhvilluar takime dhe seminare ndërgjegjësuese mbi rëndësinë e mbrojtjes së pronësisë industriale.

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale dhe Drejtoria e të Drejtës së Autorit në një Leksion të hapur pranë Universitetit “LOGOS” në Tiranë

For this purpose, discussions will continue between the heads of institutions to find practical solutions for the implementation of this initiative, and the calendar of activities in the districts between the GDIP and the UCCI will be aligned to go to businesses in districts by holding meetings and awareness-raising seminars on the importance of protecting industrial property.

The General Directorate of Industrial Property and the Copyright Directorate in an Open Lecture at the University “LOGOS” in Tirana



Më datë 15.05.2018 u zhvillua një leksion i hapur në Universitetin “LOGOS” në Tiranë. Tematika e leksionit ishte një ndërthurje e koncepteve dhe specifikave të mbrojtjes së objekteve të pronësisë industriale dhe të së Drejtës së Autorit. Pjesëmarrës në këtë lëksion ishin studentë dhe pedagogë të studimeve master dhe bachelor të

On 15.05.2018, an open lecture was held at “LOGOS” University in Tirana. The subject of the lecture was a combination of concepts and specifications for the protection of Industrial Property and Copyright objects. This lecture was attended by students and professors of the master and bachelor degree level of the

fakultetit ekonomik, të fakultetit të shkencave të aplikuara, si dhe anëtarë të qendrës së kërkimit shkencor dhe zhvillimit po nënë këtë universitet. Interesi dhe vëmendja e pjesëmarrësve më këtë leksion të hapur u fokusua kryesisht mbi patentimin e shpikjeve dhe përfitimet ekonomike që sjell pronësia mbi patentat, markat tregtare dhe të drejtat e autorit.

Lektorët ishin përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale dhe përfaqësues nga Drejtoria e së Drejtës së Autorit.

Përveç fokusit të leksionit u shpërndanë edhe libra, fletëpalosje dhe materiale të tjera promionale.

Pas leksionit u zhvillua dhe një takim me drejtuesit dhe pedagogët e universitetit për t'u përfshirë në aktivitete të ardhshme të përbashkëta që kanë në fokus promovimin e PI-së.

Promovimi dhe ndërgjegjësimi i këtij target grupi siç janë studentët dhe pedagogët në universitete është mjaft i rëndësishëm për punën tonë.

faculty of economics, faculty of applied sciences, as well as members of the Research and Development Centre at the same university. Participants' interest and attention in this open lecture focused primarily on patenting inventions and the economic benefits of patent, trademark and copyright property.

The lecturers were representatives of the General Directorate of Industrial Property and representatives from the Copyright Directorate.

In addition to the lecture, books, booklets and other promotional materials were distributed.

Following the lecture, a meeting was held with university directors and professors to engage in future joint activities focusing on IP promotion.

Promoting and raising awareness of this target group, i.e. university students and professors, is very important for our work.

Takim ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI) dhe Universitetit të “New York” Tirana



Meeting between the General Directorate of Industrial Property (GDIP) and the University of “New York” Tirana



Më datë 18.06.2018 në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale u zhvillua një takim ndërmjet kësaj drejtorie dhe Universitetit të New York-ut në Tiranë.

Gjatë këtij takimi ishin të pranishëm stafi i DPPI-së dhe përfaqësuesja e Universitetit të “New York” znj. Elida Dode, në cilësinë e lektore për çështjet e së drejtës ligjore mbi pronësinë intelektuale, së bashku me studentë të vitit të katërt pranë Fakultetit të Drejtësisë, Arteve dhe Shkencave Humane, dega Juridik, pranë këtij universiteti.

Në këtë vizitë u diskutua roli i DPPI-së në lidhje me zhvillimin dhe promovimin e pronësisë industriale në vend dhe rëndësia që ka bashkëpunimi me universitetet e vendit në rritjen e ndërgjegjësimit për këtë fushë. Studentët vizituan dhe u njohën nga afër me drejtorinë dhe

On 18.06.2018, there was a meeting held between the General Directorate of Industrial Property and the University of New York Tirana, at the premises of this directorate.

During this meeting were present the GDIP staff and the representative of the University of “New York” Tirana, Mrs. Elida Dode, in the capacity of a lecturer on intellectual property rights case-laws, together with students of the fourth year of the Faculty of Arts, Law and Social Sciences, in Judicial Branch, at this university.

In this meeting was discussed the role of GDIP regarding the development and promotion of industrial property in the country and the importance of cooperation with national universities in raising awareness in this field. The students visited and had the chance to see up-

sektorët e DPPI-së, si dhe treguan vëmendje të veçantë në rastet e markave tregtare dhe patentave për shpikje, duke u mirëinformuar mbi praktikën e plotë që ndjekin subjektet/aplikantët që nga hapi i parë i dorëzimit të dokumentacionit të nevojshëm për regjistrimin e objekteve të PI-së, deri tek praktika finale e pajisjes me certifikatë nga institucioni jonë.

Drejtorja e Promovimit, Koordinimit dhe Trajnimeve, si iniciatore dhe koordinatorë e këtij takimi, u kujdes që vizita e studentëve dhe përfaqësuesve të universitetit të New York-ut të ishte sa më frytdhënëse dhe efiçente.

Përfaqësuesit e DPPI-së, treguan një kujdes të veçantë në shpjegimin dhe informimin mbi praktikën e regjistrimit të markave tregtare dhe patentave për shpikje, duke sjellë në fokus raste konkrete dhe me interes për studentët.

Interes i veçantë u tregua kryesisht mbi patentimin e shpikjeve dhe përfitimet ekonomike që sjell pronësia mbi patentën. Siç dhe është bërë e njohur tashmë, DPPI për studentët aplikon një tarifë simbolike prej 100 lekë të reja, për çdo shpikje që ata mund të sjellin pranë institucionit tonë. Ky është një stimul mjaft i mirë për të përthithur shpikjet dhe nxitjen e krijimtarisë te brezi i ri. Promovimi dhe ndërgjegjësimi i këtij target grupi është mjaft i rëndësishëm për të ardhmen e pronësisë industriale dhe sigurisht në punën tonë të përditshme.

Mbledhja e Grupit Ndërinstitucional të Punës së Monitorimit të Strategjisë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2016-2020

close GDIP directorates and sectors, and paid particular attention to trademark and invention patents, getting well informed about the full practice pursued by the subjects/applicants from the first step of filing the necessary documentation for the registration of IP objects, to the final procedure of awarding a certificate by our institution.

The Directorate of Promotion, Coordination and Training, as the initiator and coordinator of this meeting, took care that the visit of the students and the representatives of New York University to be as productive and efficient as possible.

GDIP representatives, showed a particular attention in explaining and informing on the practices of trademark and invention patents registration, focusing on concrete cases of interest to students.

Particular interest was paid mainly in the patenting inventions and the economic benefits of patent ownership. As we already know, GDIP applies for students a modest fee of 100 ALL for any invention they can bring to our institution. This is a good incentive to attract inventions and encourage creativity to the younger generation. The promotion and awareness of this target group is very important for the future of industrial property and obviously of our daily work.

Meeting of the Inter-institutional Working Group on the Monitoring of the National Intellectual Property Strategy 2016-2020



Më datë 25.06.2018, u zhvillua mbledhja e Grupit Ndërinstitucional të Punës së monitorimit të Strategjisë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2016-2020, mbledhje e cila drejtohet nga zv.Ministria, znj. Albana Shkurta.

Përfaqësuesit e institucioneve të ndryshme raportuan për progresin e bërë dhe arritjen e objektivave të përcaktuara në planin e veprimit të strategjisë kombëtare. Në këtë mbledhje pjesëmarrja dhe angazhimi i institucioneve ishte i dukshëm dhe mjaft inkurajues për zhvillimet e mëtejshme të bashkëpunimit ku përfshihen DPPI, Ministria e Kulturës me përfaqësues nga Drejtoria për të Drejtën e Autorit, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, Autoriteti i Mediave Audiovizive, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare si dhe Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve.


Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI), Promovon Sistemin e Pronësisë Industriale në eventin “Start-Up City”.



The meeting of the Inter-institutional Working Group on the Monitoring of the National Intellectual Property Strategy 2016-2020 took place on 25.06.2018, chaired by the Deputy Minister Mr. Albana Shkurta.

Representatives of the various institutions reported on the progress made and the achievement of the objectives set out in the National Strategic Action Plan. In this meeting, the participation and engagement of the institutions was evident and very encouraging for further development of the cooperation, including GDIP, Ministry of Culture, represented by the Directorate of Copyright, General Directorate of Police, General Directorate of Customs, General Taxation Directorate, State Inspectorate of Market Supervision, Audiovisual Media Authority, Electronic and Postal Communications Authority, and Ministry of Education, Sports and Youth.

The General Directorate of Industrial Property (GDIP) Promotes the Industrial Property System at the “Start-Up City” Event.



Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI) në datë 28.06.2018 mori pjesë në eventin “Start-Up City”, i cili ka në fokus nxitjen dhe zhvillimin e ideve të reja të biznesit, produkteve dhe inovacionit, duke rritur kështu bizneset startup-ve në vend.

Ky event është konceptuar në formën e një konkursi ku do të paraqiten idete inovative për një aktivitet të suksesshëm tregtar. Pronësia Industriale është një aspekt i rëndësishëm i aktivitetit tregtar të çdo sipërmarrjeje biznesi për këtë arsye DPPI në këtë event ishte e pranishme për të përcjellë njohuritë e nevojshme për mbrojtjen e markave, patentave apo disenjove industriale nëpërmjet regjistrimit në institucionin tonë. Znj. Rezarta Rajta prezantoi para të rinjve të Fakultetit të Ekonomisë në “Universitetin e Tiranës” dhe “Universitetit Metropolitan Tirana” dhe pjesëmarrësve të tjerë në këtë event kriteret që duhet të plotësojnë objektet e IP-së dhe procedurat e regjistrimit të tyre.

Gjithashtu, nga përfaqësuesit e Drejtorisë së Koordinimit, Promovimit dhe Trajnimeve u shpërndanë materiale informuese mbi IP-në, libra, fletëpalosje raporte vjetore dhe u zhvilluan biseda nga afër me studentët për të diskutuar konkretisht çfarë aspektesh të ideve të tyre mund të paraqisnin për aplikime pranë DPPI-së.

“Për të arritur sukses në komercializimin e patentës, çdo shpikës duhet të mendojë si një biznesmen”

(Cit. Kalyan C. Kankanala)

On 28.06.2018, the General Directorate of Industrial Property (GDIP) participated in the “Start-Up City” event, which focuses on promoting and developing new business ideas, products and innovation, thus boosting start-up businesses in the country.

This event is conceived as a competition to present innovative ideas for a successful trading activity. Industrial Property is an important aspect of the business activity of any business venture. For this reason, GDIP took part in this event to share the knowledge necessary for the protection of trademarks, patents or industrial designs through registration at our institution. Mrs. Rezarta Rajta presented the criteria the IP objects must meet and their registration procedures to the youth of the Faculty of Economics at the “University of Tirana” and “Metropolitan University of Tirana” and other participants at this event.

In addition, representatives of the Coordination, Promotion and Training Directorate handed out information materials on IP, books, leaflets, annual reports and held close conversations with students to discuss specifically what aspects of their ideas might be applicable to GDIP applications.

“To achieve patent commercialisation success, every inventor must think like a businessman”

(Cited. Kalyan C. Kankanala)

TRAJNIME TË INSTITUCIONEVE TË PËRFSHIRA NË SISTEMIN E PI

TRAININGS OF THE INSTITUTIONS INCLUDED IN THE IP SYSTEM

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale zhvillon Trajnimin për Biznesin mbi përfitimet që sjell Sistemi i Pronësisë Industriale në eventin “Akademia Verore për SME 2018”

The General Directorate of Industrial Property conducts Business Training on the Benefits of the Industrial Property System at the “SME Summer Academy 2018” event



Ky program jep njohuritë bazë tek pjesëmarrësit të cilët janë sipërmarrës në biznese, krijues dhe studentë të cilët kërkojnë një vend në tregjet ndërkombëtare. Programi fokusohet në praktikat ndërkombëtare të biznesit, dokumentacionin dhe procedurat e eksportit, tregtinë ndërkombëtare, barrierat dhe ndërkombëtarizimi i sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME). Një nga tematikat e parashikuara për tu trajtuar në këtë event ishte dhe Pronësia Industriale. DPPI u përfaqësua nga znj. Rezarta Rajta, e cila mbajti një prezantim të detajuar mbi objektet e IP dhe të drejtat e fituara mbi to nëpërmjet regjistrimit.

U theksua fakti që ngritja e një strategjie nga subjektet tregtare për evidentimin, zhvillimin

This program provides basic knowledge to participants who are entrepreneurs in businesses, creators and students that would like to reach international markets. The program focuses on international business practices, documentation and export procedures, international trade, barriers and the internationalization of small and medium-sized enterprises (SMEs). One of the topics planned to be discussed in this event was Industrial Property. GDIP was represented by Mrs. Rezarta Rajta, who made a detailed presentation on the IP objects and the rights acquired through registration.

It was emphasized that the establishment of a strategy by commercial entities for the identifi-

dhe mbrojtjen e IP, është një domosdoshmëri e imponuar tashmë nga zhvillimet bashkëkohore të tregut.

Të pranishmit treguan një interes të veçantë për çështjet e IP-së duke drejtuar pyetje dhe problematikatë ndryshme.

Në këtë trajnim u përcoll mesazhi që pranë zyrave të DPPI-së bizneset, studentët, krijuesit apo kushdo që mund të jetë i interesuar është i mirëpritur dhe do të gjejë informacionin, asistencën dhe shërbimin e duhur.

Partnerët e Akademisë Verore për SME janë Ambasada e Hollandës në Shqipëri, Programi Italo-Shqiptar për Zhvillimin e SME-ve në Shqipëri (PRODAPS) dhe Ambasada e Republikës Popullore të Kinës në Shqipëri.

“Çdo markë që krijohet ka një vlerë të shtuar në biznes, më shumë se sa asetet e tij fizike”

(Cit. Kalyan C. Kankanala)

Takim ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale dhe Përfaqësuesve të Autorizuar

Në datën 02.07.2018 pranë ambienteve të DPPI-së, u zhvillua një takim ndërmjet Drejtorit të Përgjithshëm të DPPI-së z. Elvin Lako, Drejtoreshës së Ekzaminimit, znj. Rudina Bollano si dhe Përgjegjësit të Sektorit Juridik z. Përparim Mezini, me Përfaqësuesit e Autorizuar të markave tregtare dhe patentave për shpikje.

Ky takim u organizua për të diskutuar në kuadër të vendimeve që kanë hyrë në fuqi së fundmi (si: Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 315, datë 31.5.2018 Për miratimin e rregullores për markat, Vendim nr. 316, datë 31.5.2018, Vendim i Këshillit të Ministrave, për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 883, datë 13.5.2009, të këshillit të ministrave, “Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale”, të ndryshuar, nr. 317, datë 31.5.2018, Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale” të ndryshuar) si dhe

cation, development and protection of IPs is a necessity already imposed by recent market developments.

Participants showed a special interest in IP issues by asking questions and addressing various issues.

The message given in this training is that GDIP offices, businesses, students, creators or anyone who might be interested will be welcome and will find the right information, assistance and service.

Partners of the SME Summer Academy are the Embassy of the Netherlands in Albania, the Italian-Albanian SME Development Program in Albania (PRODAPS) and the Embassy of the People’s Republic of China in Albania.

“Every Trade Mark you Build adds to the financial value of your business, much more than your tangible assets”

(Cited. Kalyan C. Kankanala)

Meeting between the General Directorate of Industrial Property and the authorised representatives

On 02.07.2018, a meeting was held at the premises of the GDIP with the participation of the GDIP General Director Mr. Elvin Lako, the Director for Examinations, Mrs. Rudina Bollano and the Head of Legal Sector, Mr. Përparim Mezini and the Authorized Representatives of Trademarks and Invention Patents.

This meeting was organized to discuss the decisions that have recently entered into force (such as: Council of Ministers Decision no. 315, dated 31.5.2018 “On the adoption of a Regulation on Trademarks”; Decision no. 316, dated 31.5.2018 of the Council of Ministers “On some amendments and additions to Decision no 883, dated 13.5.2009, of the Council of Ministers, “On the approval of registration fees for industrial property objects”, as amended, no. 317, dated 31.5.2018, “On the approval of registration fees for industrial property objects”,

diskutime të ndryshme mbi problematikat e ndeshura në zbatimin e tyre.

Zhvillimi i takimeve të këtij lloji nga DPPI janë gjithashtu angazhime të ndërmarra në kuadër të “Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale 2016-2020”.

Të tilla bashkëpunime dypalëshe janë mjaft frytdhënëse, duke mundësuar rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj publikut, mbajtësve të të drejtave të pronësisë industriale dhe të gjithë aktorëve të përfshirë në sistemin e PI-së.

Takim Ndërinstitucional ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI) dhe Universitetit Politeknik të Tiranës (UPT)

Më datë 04.07.2018, pranë ambienteve të DPPI-së, u zhvillua një takim dypalësh ndërmjet Drejtorit të Përgjithshëm të DPPI-së z. Elvin Lako dhe Rektorit të UPT Prof. Dr. Andrea Maliqari, zv. Rektore për anën shkencore, Prof. Asoc. Elfrida Shehu dhe koordinatorit të marrëveshjes së mirëkuptimit ndërmjet institucioneve tona, Prof. Ilo Bodi.

Gjatë këtij takimi u diskutuan çështje të ndryshme, veçanërisht mbi ngritjen e një biblioteke për patentat mbi shpikjet dhe mirëfunksionimin e qendrës ekzistuese të informacionit teknik dhe shkencor, pranë UPT.

Gjithashtu, u zhvilluan bisedime në lidhje me trajnime të ndryshme, leksione të hapura mbi rëndësinë dhe rritjen e ndërgjegjësimit tek brezat e rinj në universitet, për objektet e pronësisë industriale, si dhe në implementimin e frytshëm të marrëveshjes së mirëkuptimit, e cila ndër vite ka pasur një ecuri të suksesshme.

Takim Ndërinstitucional ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI) dhe Drejtorisë së të Drejtës së Autorit (DDA)

Më datë 05.07.2018, pranë ambienteve të Ministrisë së Kulturës u zhvillua një takim dypalësh, ndërmjet përfaqësuesve të DPPI-së dhe DDA-së.

Në këtë takim u diskutua në lidhje me kalendarin

as amended”, as well as various discussions on the issues encountered in their implementation.

The organization of such meetings by GDIP is also a commitment undertaken as part of the “National Strategy on Intellectual Property 2016-2020”.

Such bilateral cooperation is highly productive, enabling increased service quality to the public, industrial property rights holders and all stakeholders engaged in the IP system.

Inter-institutional meeting between General Directorate of Industrial Property (GDIP) the Polytechnic University of Tirana (UPT)

On 04.07.2018, a bilateral meeting was held at the premises of GDIP with the participation of the GDIP General Director Mr. Elvin Lako and UPT Rector Prof. Dr. Andrea Maliqari, deputy rector for scientific part, Prof. Asoc. Elfrida Shehu and Coordinator of the Understanding Agreement between our Institutions, Prof. Ilo Bodi.

During this meeting, various issues were discussed, in particular the establishment of a library on invention patents and the well-functioning of the existing technical and scientific information centre at UPT.

In addition, discussions were held on various training sessions, open lectures on the importance and awareness-raising of new generations at universities, on industrial property objects, and the effective implementation of the understanding agreement, which has had a successful performance over the years.

Inter-institutional meeting between General Directorate of Industrial Property (GDIP) and The Directorate of Copyright meeting (DC)

On 05.07.2018, a bilateral meeting was held at the premises of the Ministry of Culture, between GDIP and DC representatives.

In this meeting was discussed regarding the

e aktiviteteve të përbashkëta (konkurse, leksione të hapura në universitetet shtetërore dhe jo-publike, trajnime, etj, ndërmjet institucioneve, për angazhimet e ndërmarra në Strategjinë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2016-2020.

Takimet e përbashkëta midis DPPI dhe DDA në Ministrinë e Kulturës janë kthyer tashmë në nivele të ngushta bashkëpunimi me qëllim arritjen e objektivave të strategjisë, sa i takon rritjes së ndërgjegjësimit dhe edukimit të brezit të ri me parimet bazë të të drejtave të pronësisë intelektuale.

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI) në Aktivitet Promovues pranë Panairit të Artizanëve dhe Zejtarëve

calendar of joint activities (competitions, open lectures at state and private universities, trainings, etc, between institutions, on commitments undertaken in the National Intellectual Property Strategy 2016-2020.

The joint meetings between GDIP and DC in the Ministry of Culture have now been turned into close cooperation levels in order to achieve the objectives of the strategy regarding the awareness raising and education of the younger generation with the basic principles of intellectual property rights.

General Directorate of Industrial Property (GDIP) to the Promoting Activities at the Craftsmen and Handicrafts Fair



Në datën 06.07.2018 pranë Pazarit të Ri në kryeqytet, DPPI ishte e pranishme në aktivitet promovues për Pronësinë Industriale, pranë panairit të Artizanëve dhe Zejtarëve, ku në të cilin ishin ekspozuar punime të larmishme artistiko-artizanale.

On 06.07.2018 at the New Bazaar in the capital city, GDIP was present in the promotional activity for Industrial Property, in the Craftsmen and Handicrafts Fair, where various art and craft works were exhibited.

DPPI zhvilloi nga afër takime me të gjithë sipërmarrësit dhe krijuesit e pranishëm në këtë aktivitet ku u prezantuan funksionet kryesore të DPPI-së në mbrojtjen e objekteve të pronësisë industriale nëpërmjet regjistrimit. Interesi që këto biznese shfaqën për pronësinë industriale kryesisht me markat tregtare, ishte i madh.

Gjithashtu, u shpërndanë materiale informuese mbi të drejtat që fitohen duke mbrojtur objektet e PI-së pranë zyrave të DPPI-së.

- Establishing and making available an effective information system to previous achievement (inventions) in different fields of science;
- Organising joint activities such as various seminars and trainings for raising awareness of students, academic staff and professionals engaged in scientific research on the role of protection of inventions rights in the development of science and technology in the country;

In addition, pursuant to this agreement, the “Centre of Technical and Scientific Information” was established in this University, as one of the main objectives undertaken in the “National Intellectual Property Strategy 2016-2020”. The establishment of this centre serves to raise awareness of the students, scientific academic staff, inventors and professionals committed to scientific research, as well as for the rights appertaining to inventors and professionals engaged in scientific research, through the registration at GDIP.

Nënshkruhet Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale dhe Universitetit “New York” Tiranë

The General Directorate of Industrial Property signs the Cooperation Agreement with the University of New York Tirana



Më datë 02.11.2018 u nënshkrua pranë ambienteve të Universitetit të “New York” në Tiranë, Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale të Republikës së Shqipërisë dhe këtij universiteti.

Për Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale, kjo marrëveshje u nënshkrua nga Drejtori i Përgjithshëm i saj, z. Elvin Lako, ndërsa për Universitetin e “New York” Tiranë, nga Rektori i këtij universiteti, Prof. Dr. Fatos Tarifa.

Kjo Marrëveshje është një ndër angazhimet që Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale ka ndërmarrë në “Strategjinë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale”, për vitin 2016-2020, e cila ka për qëllim kryesisht:

- Rritjen e senzibilizimit të studentëve, stafit akademik dhe profesionistëve të përfshirë në punë kërkimore dhe shkencore, për të drejtat që ata gëzojnë mbi punët e tyre;
- Promovimin e pronësisë industriale në institucionet arsimore të vendit;
- Krijimin dhe vënien në dispozicion të një sistemi eficient informacioni, për shpikjet në fusha të ndryshme të shkencës;

On 02.11.2018, was signed a Cooperation Agreement between the General Directorate of Industrial Property of the Republic of Albania and the University of New York Tirana at the premises of this University.

For the General Directorate of Industrial Property, this agreement was signed by its General Director, Mr. Elvin Lako, whereas for the University of New York Tirana, by the Rector of this university, Prof. Dr. Fatos Tarifa.

This Agreement is one of the commitments that the General Directorate of Industrial Property has undertaken in the “National Intellectual Property Strategy” for the years 2016-2020, which mainly aims at:

- Raising awareness of students, academic staff and professionals engaged in scientific research, on the rights entitled to their works;
- Promotion of industrial property in the country’s educational institutions;
- Establishing and making available an efficient information system to inventions in different fields of science;

- Zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta si seminare, konferenca dhe trajnime të ndryshme që kanë për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të studentëve, stafit akademik dhe kërkimor shkencor për rolin që ka mbrojtja e të drejtave mbi shpikjet në zhvillimin e shkencës dhe teknologjisë, etj.

Memorandumi i Bashkëpunimit ndërmjet Ministrit të Financave dhe Ekonomisë së Republikës së Shqipërisë dhe Ministri të Financave dhe Ekonomisë së Republikës së Kosovës

Në kuadër të përgatitjes së takimit të pestë ndërqeveritar, Shqipëri-Kosovë (G2G5), që u mbajt më datë 26.11.2018, në Pejë, Kosovë, u nënshkrua Marrëveshja e Mirëkuptimit ndërmjet dy ministrave, Ministri i Financave dhe Ekonomisë të Republikës së Shqipërisë dhe homologut të tij, Ministri i Financave dhe Ekonomisë së Republikës së Kosovës.

Kjo është një marrëveshje teknike dypalëshe, ndërmjet zyrave homologe, në fushën e pronësisë industriale.

Me nënshkrimin e këtij memorandumi, zyrat e mbrojtjes së të drejtave të pronësisë industriale të të dyja vendeve, synojnë nxitjen e bashkëpunimit dhe dhënien e ndihmës reciproke, me qëllim forcimin e rolit të të dy institucioneve në mbrojtjen efektive të të drejtave të pronësisë industriale sipas standardeve ndërkombëtare, si dhe në nxitjen e zhvillimit ekonomik, teknologjik, punës krijuese dhe shpikjeve në të dy vendet.

“Vetëm mund të bëjmë kaq pak; së bashku mund të arrijmë më shumë”

(Cit. Helen Keller)

-Organising joint activities such as various seminars, conferences and trainings for raising awareness of students, academic staff and professionals engaged in scientific research on the role of protection of inventions rights in the development of science and technology, etc.

The Memorandum of Cooperation between the Minister of Finance and Economy of the Republic of Albania and the Minister of Finance and Economy of the Republic of Kosovo

In the framework of the preparation of the fifth intergovernmental meeting, Albania-Kosovo (G2G5), held on 26.11.2018, in Peja, Kosovo, was signed the Memorandum of Understanding between the two ministers, the Minister of Finance and Economy of the Republic of Albania and his homologue, the Minister of Finance and Economy of the Republic of Kosovo.

This is a bilateral technical agreement, between homologous offices in the field of industrial property.

Upon signing this Memorandum, the Industrial Property Rights Protection Offices of both countries aim to promote cooperation and mutual assistance in order to strengthen the role of both institutions in the effective protection of industrial property rights according to international standards, as well as to promote economic, technological, creative work and invention developments in both countries.

“Alone we can do so little; together we can do so much”

(Cited. Helen Keller)

DPPI në vitin 2014 u caktua si institucioni koordinues për Kapitullin 7 “Pronësia Intelektuale”, për të gjithë fushën e pronësisë intelektuale dhe ka kryer rolin e koordinatorit dhe mbledhjes së informacionit dhe kontributeve për të gjitha institucionet ligjzbatuese në fushën e pronësisë intelektuale.

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë nga njëra anë dhe Komunitetit Evropian dhe Shteteve Anëtare të tij nga ana tjetër, u nënshkrua në qershor të vitit 2006 dhe hyri në fuqi në prill të vitit 2009. Prioritetet afat shkurtër dhe afat mesme të përcaktuara në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) në fushën e “Pronësisë Intelektuale” janë realizuar.

Falë punës intensive të kryer nga DPPI dhe në sajë të një bashkëpunimi të ngushtë të saj me MFE dhe me institucionet e tjera shtetërore që operojnë në këtë fushë, kemi progres në realizimin e objektivave të parashikuara në “Strategjinë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2016-2020” dhe në PKIE.

Përveç vlerësimit pozitiv në progres raportet e BE, po të njëjtin vlerësim për kapitullin 7 është dhënë dhe në takimet e nënkomitetit.

Pra, ka një progres të dukshëm në fushën e pronësisë intelektuale dhe veçanërisht në fushën e pronësisë industriale ku janë realizuar të gjitha detyrimet e parashikuara në PKIE dhe “Strategjinë Kombëtare të PI (2016-2020)”.

Drejtorja e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, në rolin koordinatorit të kapitullit 7, “E Drejta e Pronësisë Intelektuale”, të PKIE ka koordinuar institucionet e përfshira dhe ka mundur realizimin e raportimeve në kohë dhe sipas kërkesave të BE-së.

In 2014, GDIP was appointed as the coordinating institution for Chapter 7 “Intellectual Property”, for the entire intellectual property field and has acted as a coordinator for all law enforcement institutions in the field of intellectual property.

Stabilisation and Association Agreement between the Republic of Albania on one side and the European Community and its Member States on the other side was signed in June 2006 and entered into force in April 2009. Short-term and medium-term priorities determined in the National Plan for European Integration (NPEI) in the field of industrial property have been achieved.

Due to the intensive work performed by the GDIP and to its close collaboration with MFE and with other state institutions operating in this field, we have progress in achieving the objectives provided in the “National Strategy on Intellectual Property 2016- 2020” and at the NPEI.

In addition to the positive assessment in EU progress reports, the same assessment for chapter 7 is also provided in the subcommittee meetings.

Therefore, there is significant progress in the field of intellectual property and especially in the field of industrial property where all the obligations provided in the NPEI and all the “National IP Strategy (2016-2020)” have been implemented.

The General Directorate of the Industrial Office, in the capacity of the coordinator of Chapter 7, “Intellectual Property Right”, of the NPEI coordinated the institutions engaged and enabled the timely implementation of the reports, in accordance with the EU requirements.

DPPI përfaqëson Republikën e Shqipërisë në tre organizma ndërkombëtare (EUIPO, EPO dhe WIPO).

Theksojmë se në lidhje me vlerësimin e KE për Pronësinë Industriale Shqipëria ka pësuar rritje të nivelit nga 1 në nivelin 3 vitin e fundit, ku citohet se Shqipëria ka bërë progres në këtë fushë. DPPI, sic edhe e theksuam më lart, ka përmbyshur të gjitha detyrat e lëna nga Komisioni Europian sa i takon pjesës së pronësisë industriale.

Në vitin 2017 është amenduar ligji për pronësinë industriale duke krijuar në këtë mënyrë një bazë ligjore për mbrojtjen e objekteve të pronësisë industriale. Sa i takon të drejtave të pronësisë industriale, në vitin 2017.

DPPI luajti një rol të rëndësishëm në kategorizimin në nivelin 3, falë punës intensive të kryer dhe në sajë të një bashkëpunimi të ngushtë dhe me institucionet e tjera shtetërore që operojnë në këtë fushë.

KE ka vlerësuar punën e kryer nga DPPI dhe nuk ka lënë rekomandime për DPPI, por për institucionet e tjera që janë pjesë e zbatimit të këtyre të drejtave të RSH si: E drejta e Autorit, Gjyqësori, ISHMT, etj.

DPPI ka arritur rezultate të larta në punën e saj në këto katër vite duke i realizuar 100% objektivat e parashikuara si në strategji ashtu edhe në planin e saj të punës.

DPPI është një institucion, i cili gjeneron dhe raporton statistikën në lidhje me tendencën e aplikimeve dhe volumin të punës së saj sa i takon objekteve të pronësisë industriale.

DPPI e ka të qartë vizionin e saj si dhe një mjaft mirë detyrat e saj funksionale dhe të gjitha objektivat që duhen përmbyshur dhe ku synon të arrijë. DPPI ecën në frymën e bashkëpunimit dhe mirë-koordinimit dhe me organizmat e huaja që operojnë në këtë fushë dhe përditësohet me legjislacionin dhe ndryshimet e fundit që ndodhin në arenën ndërkombëtare për pronësinë industriale.

Sfida e saj kryesore mbetet edukimi i brezave dhe gjeneratave të reja me konceptet bazike

GDIP represents the Republic of Albania in three international bodies (EUIPO, EPO, WIPO)

We emphasise that related to the EC's assessment on Industrial Property, in the last year, Albania has experienced an increase from level 1 to level 3, specifying that Albania has made progress in this area. GDIP, as noted above, has completed all the tasks assigned by the European Commission regarding to the industrial property.

In 2017 was amended the law on Industrial Property, thus creating a legal basis for the protection of industrial property objects. According to the rights of industrial property, in 2017.

GDIP played an important role in increasing the level to 3, due to the intensive work performed and to its close collaboration also with other state institutions operating in this field.

The EC has evaluated the work performed by GDIP and did not give recommendations to GDIP, but to other institutions that are part of the implementation of these rights of the Republic of Albania, such as: Copyright, Judiciary, SIMS, etc.

GDIP has achieved high results in its work in these four years, achieving 100% objectives provided both in the strategy and in its work plan.

GDIP is an institution that generates and reports statistics related to the tendency of applications and the amount of its work regarding to industrial property objects.

GDIP has a clear view and knows very well its functional duties and all the objectives to be met and those intended to achieve. GDIP works in the spirit of cooperation and good coordination with foreign organizations operating in this field and is updated with legislation and recent changes occurring in the international arena of industrial property.

Its main challenge remains the education of new generations with the basic concepts of protection and respect for industrial property rights. Without a developed and well-educated

të mbrojtjes dhe të respektimit të të drejtave të pronësisë industriale. Pa një shoqëri të emancipuar dhe të mirë-edukuar nuk mund të kërkojmë zbatim të këtyre të drejtave në Republikën e Shqipërisë. Eksperiencat botërore kanë treguar se edukimi i brezave dhe i shoqërisë në tërësi janë një praktikë efektive për zbatimin sa më me efikasitet të këtyre të drejtave.

Për nga vetë natyra e veprimtarisë që ky institucion kryen, duhet theksuar fakti se mbrojtja dhe respektimi i të drejtave të pronësisë industriale ndikon drejtpërsëdrejti në rritjen e GDP-së së vendit, hapjen e vendeve të reja të punës duke lënë mbrapa shumë industri të tjera ndoshta dhe me të rëndësishme. Këtë fakt e tregojnë studimet e shumta që janë kryer nga Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale në shumë vende të zhvilluara dhe jo vetëm, përse i takon industrive që bazohen te të drejtat e pronësisë industriale.

society we cannot claim the implementation of these rights in the Republic of Albania. The worldwide experiences have demonstrated that the education of generations and of the society as a whole is an effective practice for the most efficient implementation of these rights.

By the nature of this institution's activity, it must be noted that the protection and respect of industrial property rights directly affects the growth of the country's GDP, new employment opportunities, leaving behind many other industries of perhaps greater importance. This is evidenced by many studies that have been carried out by the World Intellectual Property Organization in many developed countries, and not only as regards to the industrial property rights.

DPPI në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare të PI ofron dhe shërbimet e mëposhtme:

- Integrimi në modulet TMclass, TMview dhe DesignView

TMclass, TMview dhe DesignView janë sisteme kërkimi të menaxhuara nga Zyra Bashkimit Evropian për Pronësinë Intelektuale për mallrat dhe shërbimet sipas klasifikimit të Nicës, markat tregtare dhe disenjot industriale.

Aktualisht Shqipëria është pjesë e moduleve:

1. TMClass, për Klasifikimin Ndërkombëtar të Mallrave dhe Shërbimeve (Klasifikimi i Nicës).
2. TMview i cili shërben për kërkimin e markave të aplikuara apo regjistruara në të gjitha vendet që kanë integruar këtë sistem. 40 milion marka tregtare në total, në këtë mënyrë kompanitë e huaja mund të marrin informacion për markat dhe disenjot industriale të mbrojtura në Shqipëri. Ky regjistër përditësohet çdo ditë me markat e publikuara.
3. DSview baza e të dhënave on-line për disenjot industriale.

Këto sisteme janë të aksesueshme edhe në gjuhën shqipe dhe përditësohen çdo ditë me të dhënat nga zyrat pjesëmarrëse.

Shërbimet e lartpërmendura i bëjnë të njohura në gjithë Evropën objektet e pronësisë industriale të mbrojtura në Republikën e Shqipërisë, duke zgjeruar territorin ku shpërndahet informacioni mbi markat tregtare dhe disenjot industriale arrihet edhe forcimi i mbrojtjes dhe shtimi i reputacionit të tyre. Përdorimi i këtyre të dhënave lehtëson kompanitë e huaja që kërkojnë të mbrohen në Shqipëri të marrin informacion në kohë reale mbi statusin e aplikimeve të tyre. Kjo gjë rrjedhimisht ndikon në shtimin e aplikimeve nga subjektet e huaja në Republikën e Shqipërisë.

Furthermore, GDIP in cooperation with international IP organizations offers the following services:

- Integration in the TMclass, TMview and Design View modules

TMclass, TMview dhe DesignView are search systems managed by the European Union Intellectual Property Office for goods and services by the Nice Classification, trademarks and industrial designs.

Currently, Albania is part of the modules:

1. TMClass, for the International Classification of Goods and Services (Classification of Nice).
2. TMview which serves to search for trademarks applied or registered in all countries that have integrated this system. 40 million trademarks in total, so foreign companies can get information about protected trademarks and industrial designs in Albania. This register is updated daily with the published trademarks.
3. DSview the online database for industrial designs.

These systems are also accessible in Albanian language and are updated daily with data from participating offices.

The above mentioned services make the protected industrial property in the Republic of Albania known throughout Europe, by expanding the territory where the information on the trademarks and industrial designs is spread, we achieve enforcing their protection and growing their reputation. Use of this data facilitates foreign companies who seek to be protected in Albania to obtain real-time information on their application status. Consequently, this affects the increase of the applications from foreign entities in the Republic of Albania.

- Espacenet në gjuhën Shqipe

Aksesimi në gjuhën shqipe në Espacenet, i cili është një sistem kërkimi i ZEP, që ofron pa pagesë informacionin rreth shpikjeve dhe zhvillimeve teknologjike që nga shekulli i 19-të e deri sot. Nëpërmjet përdorimit të këtij sistemi kërkimi shpikësit shqiptar, bizneset apo qendrat e kërkimit, por edhe fillestarët mund të marrin informacion nëse një patentë është lëshuar dhe nëse është ende në fuqi. Espacenet shërben për të kërkuar dhe gjetur publikimet e patentave, përkthyer dokumentat nga makina e përkthimit, për të ndjekur përparimin e teknologjive të reja, për të gjetur zgjidhje të problemeve teknike, apo për të parë se çfarë janë duke zhvilluar konkurrentët. Espacenet u krijua në vitin 1998 nga ZEP.

Me krijimin e këtij sistemi kërkimi është revolucionarizuar aksesimi i publikut në informacionin mbi patentat ndërkombëtare, duke i liruar të dhënat e patentave nga burgjet prej letre dhe duke ndryshuar përgjithmonë mënyrën se si merret informacioni mbi patentat, si shpërndahet, organizohet dhe kontrollohet. Ai përmban të dhëna për më shumë se 80 milion dokumente të patentave në mbarë botën.

- Përmirësim dhe zhvillim i infrastrukturës së serverave dhe sistemeve TIK të DPPI si dhe krijimi i një dhome serveri për back up.

DPPI aktualisht ka në përdorim dhe administron një bazë të dhënash shtetërore, një sistem për administrimin e arkivës elektronike, dhe module funksionale për shkëmbimin e të dhënave. Këto sisteme me qëllim edhe të plotësimit të detyrimeve që lindin nga legjislacioni në fuqi për Bazat e të Dhënave kërkon siguri të funksionalitetit dhe integritetit të të dhënave, të lartë. Për këtë qëllim, vazhdimisht këto sisteme duhet të përmirësohen dhe zhvillohen.

- DPPI i ka të hostuara serverat në datacenterin qeveritar pranë AKSHI-t. Niveli i sigurisë së bazës së të dhënave të DPPI-së është i lartë dhe në zbatim të legjislacionit në fuqi të bazave të të dhënave shtetërore kërkohet që të dhënat të ruhen në një vend tjetër të

- Espacenet in Albanian Language

Access in the Albanian language of Espacenet, which is a EPO search system that provides information on the inventions and technological developments since the 19th century to the present day. By using this search system, Albanian inventors, businesses or research centres, but also beginners, can get information on whether a patent has been issued and if it is still in force. Espacenet is useful to search and find patent publications, to translate documents from the translation engine, to follow the advancement of the new technologies, to find solutions to technical problems, or to see what the competitors are doing. Espacenet was established in 1998 by EPO.

The creation of this search system has revolutionised the public's access to the information on international patents, releasing the data on patents from their bureaucracy restrictions, and changing forever the way in which the information on patents is accessed, shared, organised and monitored. It contains data for more than 80 million patent documents in the world.

- The improvement and development of the infrastructure of ICT systems and servers of GDIP, as well as the establishment of a back up server room.

GDIP, currently uses and administers a state database, an electronic archive management system, and functional data exchange modules. These systems with the purpose of fulfilling the commitments arising from the applicable legislation on the Databases require high security of data functionality and integrity. For this purpose, these systems need to be constantly improved and developed.

- GDIP hosted servers in the government data centre to NAIS (National Agency of Information Society). GDIP has a high level of security and it is required the data to be stored in a place physically other than the first back-up environment, pursuant to the

ndryshëm fizikisht nga mjedisi i back-up të parë. Ky mjedis kërkon disa standarte të përcaktura nga rregullorja e AKSHI-t për ndërtimin e dhomës së serverave gjithashtu edhe pajisjeve fizike për tranfrerimin dhe ruajtjen e të dhënave.

Ndryshimet e fundit në *Ligjin 9947, datë 07/07/2008, "Për Pronësinë Industriale"*, i ndryshuar, parashikoi dispozitat ligjore për mundësinë e aplikimit on-line. Në vijim të modernizimeve të shërbimeve të DPPI, për të qënë koherent më zhvillimin e teknologjisë në kohët e sotme, krijimi i sistemit për aplikimin on-line është shumë i domosdosshëm. Ky sistem do të zhvillohet që të pranojë kërkesat on-line për aplikime të reja, patenta të shpikjeve, modelet e përdorimit, markat, disenjot industriale dhe treguesit gjeografikë, për të gjitha ndryshimet dhe dokumentat e depozituar gjatë procesit të ekzaminimit.

legislation in force of the state data base. This environment requires some standards established by the NAIS regulation on server room building as well as on physical devices for data transfer and storage.

The latest amendments on *Law 9947, dated 07/07/2008, "On Industrial property"*, as amended, provided for legal provisions on the possibility of an online application. Following the evolution of GDIP services, it is really necessary to create an online system to maintain the consistency with the development of technology nowadays. This system will be programmed in order to accept on-line applications for new applications, invention patents, utility models, brands, industrial designs and geographical indications for all changes and documents filed during the examination process.



Mbrojtja e të drejtave mbi objektet e pronësisë industriale është një nga aspektet më të rëndësishme të rregulluara nga legjislacioni mbi pronësinë industriale.

Sektori Juridik, ka si objekt kryesor të veprimtarisë së tij, të asistojë në sigurimin e praktikave të punës së sektorëve të tjerë të drejtorisë, të jetë në përputhje me procedurat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi "Për Pronësinë Industriale", aktet nënligjore dalë në zbatim të tij dhe marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e pronësisë industriale; të përgatisë praktikën për miratimin ose ndryshimet në aktet ligjore, nënligjore ose aktet e brendshme të drejtorisë, të cilat rregullojnë veprimtarinë funksionale të Drejtorisë; të ndjekë të gjitha çështjet në Gjykatë ku DPPI është i paditur apo person i tretë, të marrë pjesë në Bordin e Apelit, i cili aktualisht përgatit dhe vendimet e Bordit të Apelit, të ndjekë procedurat e prokurimeve me vlera të vogla, marrëveshje kuadër, etj.

Përmirësimi i vazhdueshëm i bazës ligjore me qëllim përafrimin me legjislacionin dhe standardet e vendeve të BE-së, është në fokusin e veprimtarisë së DPPI-së.

Mbrojtja e të drejtave mbi objektet e pronësisë industriale është një nga aspektet më të

Protection of the rights on industrial property objects is one of the most important aspects regulated by the legislation on industrial property.

The main object of The Legal Sector's activity is to assist in ensuring the work practices of other departments of the Directorate, to comply with the procedures provided by the applicable legislation "On Industrial Property", its applicable by-laws and international agreements in the field of industrial property; to prepare practices for the adoption or amendments of the legal acts, by-laws or internal acts of the directorate, which regulate the functional activity of the Directorate; to pursue all matters in the Court where GDIP is a defendant or a third party; to participate in the Appeals Board, which currently prepares the Appellate Board's decisions; to carry out small value procurement procedures, framework agreements, etc.

The continuous improvement of the legal basis in order to align with the legislation and standards of the EU countries, is in the focus of the GDIP activity.

Protection of the rights on industrial property objects is one of the most important aspects

rëndësishme të rregulluara nga legjislacioni mbi pronësinë industriale.

1. Ndjekja e procedurave për miratimin e akteve nënligjore me qëllim përmirësimin e legjislacionit në fushën e Pronësisë Industriale.

2. Ndjekja e procedurave për miratimin e 4 marrëveshjeve, në të cilat do të aderojmë.

Gjatë vitit 2018, objektiv kryesor i Sektorit Juridik ka qenë ndjekja e të gjitha procedurave deri në miratimin e katër marrëveshjeve të aderuaruara dhe akteve nënligjore të ngarkuara në zbatim të ligjit.

Gjatë kësaj kohe, janë ndjekur procedurat për dhënie mendimi për aktet ligjore dhe nënligjore si dhe janë mbajtur korrespondencat me Kryeministrinë dhe Kuvendin e Republikës së Shqipërisë deri në miratimin e këtyre akteve.

Janë hartuar 11 akte nënligjore, dalë në zbatim të ligjit Nr. 9947, datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale” i ndryshuar, ku aktualisht janë miratuar vetëm 8 prej tyre, si më poshtë:

- VKM nr. 460, datë 26.7.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 1707, datë 29.12.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për lëshimin e patentave për shpikjet dhe modelet e përdorimit”, të ndryshuar;
- VKM nr.315, datë 31.05.2018 “Për miratimin e rregullores për markat”;
- VKM nr. 317, datë 31.5.2018 Për miratimin e Rregullores “Për Përfaqësuesit e Autorizuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale”;
- VKM nr.316, datë 31.05.2018 “Për miratimin e tarifave për regjistrimin e Objekteve të Pronësisë Industriale”;
- VKM nr. 501, datë 29.8.2018 “Për miratimin e Rregullores për Ekspertët e Objekteve të Pronësisë Industriale”;
- VKM nr. 270, datë 16.5.2018 “Për miratimin e Rregullores “Për Disenjt Industrial”;

regulated by the legislation on industrial property.

1. Following the procedures for the approval of sub-legal acts in order to improve the legislation in the field of Industrial Property.

2. Following the procedures for the approval of 4 agreements we will adhere to.

In 2018, the main objective of the Legal Sector was to carry out all procedures until the adoption of four accession agreements and by-laws pursuant to the law.

During this time, consultation procedures on the legal acts and by-laws were carried out, and correspondence was held with the Prime Minister's Office and the Parliament of the Republic of Albania until the adoption of these acts.

11 by-laws have been drafted, pursuant to Law no. 9947, dated 07.07.2008 “On Industrial Property”, as amended, and only 8 of them have been adopted so far, as follows:

- DCM No. 460, dated 26.7.2018 “On some amendments and additions to Decision no. 1707, dated 29.12.2008, of the Council of Ministers, “On the adoption of a Regulation on invention patents issuance and utility models”, as amended;
- DCM No.315 dated 31.05.2018 “On the adoption of a Regulation on trademarks”;
- DCM No. 317, dated 31.5.2018 On the adoption of a Regulation “On Authorized Representatives in the General Directorate of Industrial Property”;
- DCM No.316 dated 31.05.2018 “On the approval of fees for the registration of Industrial Property Objects”;
- DCM No. 501, dated 29.8.2018 “On the adoption of a Regulation on Industrial Property Objects Experts”;
- DCM No. 270, dated 16.5.2018 “On the adoption of a Regulation on Industrial Designs”;

- VKM nr. 752, datë 19.12.2018 “Për miratimin e Rregullores së Organizimit, Funkcionimit dhe Përcaktimit të masës së Shpërblimit të Anëtarëve të Bordit të Apelit të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale”;
- VKM Nr. 252, datë 9.5.2018 “Për përcaktimin e masës dhe të kriterëve për shpërblimin e kryetarit, anëtarëve dhe sekretarit teknik të Këshillit Mbikqyrës të DPPI”.

Ndërkohë mbetemi në pritje të miratimit të tre akteve nënligjore, konkretisht:

- VKM “Për miratimin e rregullores për treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës”
- VKM “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e qendrës së trajnimeve në fushën e pronësisë industriale”
- VKM “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të pronësisë Industriale SAPI”.

Gjithashtu, gjatë këtij viti janë miratuar katër projekt-marrëveshje, me anë të të cilave Republika e Shqipërisë aderon në marrëveshjet ndërkombëtare, si:

- Ligj nr. 33/2018, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Lokarnos “Për përcaktimin e një klasifikimi ndërkombëtar për disenjot industriale”.
- Ligj nr. 34/2018, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Vjenës “Për klasifikimin ndërkombëtar të elementeve figurative të markave tregtare”, miratuar më 7.6.2018.
- Ligj nr. 66/2018, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktin e Gjenevës të marrëveshjes së Lisbonës për emërtimet e origjinës dhe treguesit gjeografikë”, miratuar më 24.9.2018.
- Ligj nr. 90/2018, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Lisbonës për mbrojtjen e emërtimeve të origjinës dhe regjistrimin e tyre ndërkombëtar”, miratuar më 03.12.2018.


- DCM No. 752, dated 19.12.2018 “On the adoption of a Regulation on Organization, Functioning and Establishing the Amount of Remuneration of Members of the Appeal Board of the General Directorate of Industrial Property”;
- DCM no. 252 dated 9.5.2018 “On establishing the amount and criteria for the remuneration of the Chairman, Members and Technical Secretary of GDIP’s Supervisory Council”.

Meanwhile, we remain await the approval of three by-laws, specifically:

- DCM “On the adoption of the regulation on geographical indications and appellations of origin”
- DCM “On the adoption of the regulation on the organization and functioning of the training center in the field of industrial property “
- DCM “On the Establishment of the Industrial Property State Database SAPI”.

In addition, four draft agreements have been approved this year, through which the Republic of Albania adheres to international agreements such as:

- Law no. 33/2018 “On the accession of the Republic of Albania to the Locarno Agreement” On establishing an international classification for industrial designs”.
- Law no. 34/2018, “On the accession of the Republic of Albania to the Vienna Agreement “On the International Classification of Figurative Elements of Trademarks”, adopted on 7.6.2018.
- Law no. 66/2018, “On the accession of the Republic of Albania to the Geneva Act of the Lisbon Agreement on appellations of origin and geographical indications”, adopted on 24.9.2018.
- Law no. 90/2018, “On the accession of the Republic of Albania to the Lisbon Agreement for the protection of appellations of origin and their international registration”, adopted on 03.12.2018.



Përfaqësimi i DPPI në çështjet gjyqësore me objekt të drejtat e pronësisë industriale.

Gjatë vitit 2018, me autorizimin e Drejtorit të Përgjithshëm janë ndjekur 27 çështje në gjykatë. DPPI-ja përfaqësohet në gjykatë në rastet kur ankimohen vendimet e Bordit të Apelit, në të cilat DPPI merr pjesë në gjykim si palë e paditur dhe bën mbrojtjen e vendimeve të saj me anë të prapësimeve, shpjegimeve dhe provave që paraqet në gjykatë. Gjithashtu, DPPI merr pjesë në proceset gjyqësore si person i tretë edhe në çështje me objekt zhvlerësimin, shfuqizimin e markave, konkurrencën e pandershme, etj.

Gjatë vitit 2018, PPI ka ndjekur 27 çështje në gjykatë:

- 8 (tetë) çështje në gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë
- 17 (shtatëmbëdhjetë) çështje në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë,
- 1 (një) çështje në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë,
- 1 (një) çështje në Gjykatën e Apelit, Tiranë.

The representation of GDIP in court cases on industrial property rights.

During 2018, with the authorization of the Executive Director there have been followed 27 court cases. The representation of GDIP in court occurs in cases when various entities file their appeals in the Board of Appeal, where the GDIP is party in the trial acting as the defendant party for itself by presenting its claims, explanations and evidences to the court. Moreover, the GDIP shall participate as a third party even in cases related to depreciation and abolishment of trademark, dishonest competition, etc.

During 2018, GDIP has followed 27 court cases

- 8 (eight) cases in the Court of the Tirana Judicial District,
- 17 (seventeen) cases in the Administrative Court of First Instance,
- 1 (one) case in the Administrative Appeal Court of Tirana,
- 1 (one) case in the Appeal Court of Tirana.

Në gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka marrë pjesë për 1(një) çështje si palë e paditur me objekt Shfuqizim Vendim Bordit, 2(dy) çështje e paditur me objekt Shfuqizim marke dhe 5 (pesë) çështje si person i tretë, me objekt konkurrencë e pandershme.

Në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë ka marrë pjesë si palë e paditur, ku 16 (gjashtë mbëdhjetë) çështje me objekt shfuqizim vendim bordit e Apelit dhe 1(një) çështje me objekt pavlefshmëri absolute e aktit administrativ të DPPI-së.

Në gjykatën Administrative të Apelit DPPI ka ndjekur 1(një) çështje me objekt shfuqizimin e vendimit të Bordit të Apelit, si palë e paditur.

Në gjykatën e Apelit është ndjekur 1(një) çështje me objekt konstatimkonkurrencë e pandershme, ku DPPI ka qenë palë e paditur.

Sektori i Juridik i DPPI ka ndjekur të gjitha çështjet në të gjitha shkallët e gjyqësorit. Vihet re se, në çështjet në të cilat është ankimuar vendimi i Bordit të Apelit apo çdo akt tjetër administrativ i DPPI, gjykata në 80 % të rasteve ka lënë në fuqi aktet e DPPI, si të bazuara në ligj. Puna e Sektorit Juridik në lidhje me çështjet gjyqësore çdo vit jep rezultate, duke qenë se edhe niveli i mbrojtjes në fushën e pronësisë industriale është gjithmonë e më profesional.

DETYRA TË TJERA

- Dhënia e asistencës juridike për Drejtoritë dhe Sektorët e DPPI-së për interpretimin dhe zbatimin e saktë të ligjit dhe marrëveshjeve ndërkombëtare mbi të çilat bazohet veprimtaria e tyre.
- Dhënia e asistencës juridike Drejtorit të Përgjithshëm në zbatim e ligjit dhe marrëveshjeve në mënyre korrekte dhe rigoroze.
- Përpilimi i shkresave, informacioneve të ndryshme gjatë procesit të këmbimit të korespondencës me subjekte private apo institucione shtetërore si Gjykata, Prokuroria, Policia e Shtetit për çështje me karakter juridik.
- Përgatitja e planit të punës për vitin 2018.

GDIP has participated in 1 (one) case as a defendant party on the abolishment of the Board of Appeal decision, 2 (two) cases on abolishment of trademark and 5 (five) cases as the third party, on dishonest competition in the Court of the Tirana Judicial District.

GDIP has participated as a defendant party in 16 (sixteen) cases on the abolishment of the board Appeal decision and 1(one) case on absolute invalidity of GDIP administrative act in the Administrative Court of First Instance.

GDIP has participated in 1(one) case as a defendant party on the abolishment of the Board of Appeal decision, in the Administrative Court of Appeal.

GDIP has participated as a dependent party in 1(one) case on identification of dishonest competition, in the court of Appeal.

The Legal Sector has followed all cases in all judiciary levels. It is noticed that cases in which the decision of Board of Appeal is appealed or any other administrative act of the GDIP, the Court in 80 % of the cases has considered GDIP acts based on the law. The work of the Legal Sector regarding the court cases each year shows result, since the protection level in the field of industrial property is more professional.

OTHER TASKS

- Providing legal assistance to GDIP Directorates and Sectors on the accurate interpretation and implementation of the law and international agreements on which their activity is based.
- Providing Legal Assistance to the General Director in compliance with the law and agreements in an accurate and strict manner.
- Drafting of documents, different informations during the correspondence exchange with private entities or state institutions such as the Court, Prosecution Office, State Police for legal issues.

- e) Pjesëmarrja në seminare dhe takimet trajnuese të zhvilluara brenda dhe jashtë vendit me qëllim rritjen e kapacitetit ligjor në fushën e Pronësisë Industriale të Sektorit Juridik.
- f) Sektori Juridik ka marrë pjesë në organizimin e testimit me shkrim të aplikantëve për përfaqësues të autorizuar, ka mbajtur dhe pranuar dosjen e aplikantëve dhe ka përgatitur dokumentacionin e nevojshëm për kryerjen e testimit dhe deri në marrjen e licences, duke qenë se përfaqësohet me një anëtar në këtë komision.
- g) Ka mbajtur korrespondencë në lidhje me përafrimin e legjislacionit të fushës së PI-së me legjislacionin evropian.

PROKURIMET PËR VITIN 2018

- a) Përgatitja dhe realizimi¹⁵ (pesëmbëdhjetë) procedurave të prokurimit me vlera të vogla dhe përfundimi i tyre me sukses, brenda afatit sipas parashikimeve ligjore.
- b) Përgatitja e dokumentacionit të procedurës së prokurimit “Blerje automjeti për DPPI”, dhe përfundimi i realizimit të kësaj procedure brenda parashikimeve ligjore.

Përgatitja e procedurave të prokurimeve, ndjekja dhe përfundimi i tyre ka hasur në problematika të ndryshme, me miratimin me vonesë të buxhetit të vitit 2018, por gjithësesi procedurat e parashikuara janë realizuar në kohë.

DHOMA PËR SHFUQIZIM/ZHVLERËSIM 2018

Dhoma për Shfuqizim/Zhvlerësim është krijuar në bazë të të nenit 193/a, të ligjit nr. 9947, datë 07.07.2008 “Për pronësinë Industriale” i ndryshuar, për shqyrtimin e kërkesave që i drejtohen DPPI-së mbështetur në nenet 126, 138, 155, 173, 174, 183 të ligjit të sipërcituar “Për pronësinë industriale”.

Kjo dhomë ka filluar të funksionojë menjëherë pas hyrjes në fuqi në datën 06.06.2018, të VKM nr. 315, datë 31.5.2018 “Për miratimin e rregullores për markat”, që parashikon procedurën administrative për shqyrtimin e kërkesave drejtuar kësaj dhome.

- d) Preparation of working plan for 2018.
- e) Participation in seminars and training meetings held inside or outside the country in order to increase the legal capacity in the field of Industrial Property of the Legal Sector.
- f) The Legal Sector has participated in organizing written tests for applicants applying for authorized representatives, maintained and received the applicants file and prepared the necessary documentation for the test up to the moment the license is obtained, since it is represented by a member in this commission.
- g) Has maintained correspondence regarding the approximation of the IP legislation with European legislation.

PROCUREMENTS DURING 2018

- a) Drafting and implementation of 15 (fifteen) small value procurement procedures and their successful completion, within the term according to legal provisions.
- b) Drafting of the procurement procedure documentation “Vehicle purchase for DPPI”, and completion of the implementation of this procedure within the legal provisions.

Due to the delayed adoption of the 2018 budget, the preparation of procurement procedures, their follow-up and completion encountered various problems, but the planned procedures were completed on time.

INVALIDATION / REVOCATION CHAMBER 2018

Invalidation / Revocation Chamber was established pursuant to article 193/a, of law no.9947, dated 07.07.2008 “On industrial property”, as amended, for reviewing the claims addressed to GDIP according to the articles 126, 138, 155, 173, 174, 183 of the above-mentioned law “On industrial property”.

This chamber has started performing immediately upon the entry into force on 06.06.2018, DCM no. 315, dated 31.5.2018 “On the adoption of a Regulation on trademarks”, which provides for,

Numri i kërkesave të depozituara pranë dhomës për Shfuqizim/Zhvlerësim deri në fundin e vitit 2018 është 44, nga të cilat janë shqyrtuar dhe kanë përfunduar me vendim 23 prej tyre,

Pjesa tjetër e kërkesave është ende në proces shqyrtimi, për shkak të kohës së depozitimit pranë DPPI-së, apo për plotësimin e të metave që ato përmbajnë, si dhe për njoftimin e palëve pjesëmarrëse në procedurat përkatëse, etj.

the administrative procedure for reviewing the claims addressed to this chamber.

The number of claims filed at the Invalidation/Revocation Chamber by the end of 2018 was 44, of which 23 have been reviewed and have been finalised by decision,

The rest of the claims are still under review due to the time of filing with the GDIP, or for completing the irregularities they contain, as well as for notifying the parties involved in the relevant procedures etc.

- 1) Ndjekja me përparësi për miratimin e 3 akteve nënligjore ligjore të dala në zbatim të ligjit 9947, date 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale” (DPPI), të mbetura që nga viti 2018.
- 2) Përgatitja e ndryshimeve të ligjit 9947 “Për Pronësinë Industriale” ku synohet përafrimi i tij me direktivën Evropiane të Sekretit Tregtar.

DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Sektori i Buxhetit, Financës dhe Burimeve Njerëzore

- 1) Following with priority the approval of 3 sub-legal acts deriving pursuant to Law 9947, dated 07.07.2008 “On Industrial Property” (GDIP), remaining since 2018.
- 2) Drafting amendments to Law 9947 “On Industrial Property”, where it is aimed at its alignment with European Trade Secret Directive.

DIRECTORATE OF FINANCE AND SUPPORT SERVICES

Budget, Finance and Human Resources Sector



I. STATISTIKA

Të ardhurat financiare janë tregues i rëndësishëm i performancës së një institucioni.

I. STATISTICS

Financial incomes are an important indicator of the performance of an institution.

Falë reformave të ndërmarra nga DPPI si në përmirësimin e shërbimeve ashtu edhe në promovimin e rolit të Pronësisë Industriale, është rritur numri total i aplikimeve që depozitohen për shqyrtim administrativ në DPPI. Në këtë mënyrë është shtuar ndjeshëm edhe volumi punës që është dashur të përballojë DPPI, rrjedhimisht kjo ka sjellë dhe shtimin e shpenzimeve dhe të ardhurave të arkëtuara nga DPPI.

Numri i aplikimeve për objektet e pronësisë industriale është rritur ndjeshëm për këtë periudhë, tabela e mëposhtme:

Due to the reforms undertaken by GDIP both in improving services and in promoting the role of Industrial Property, the total number of applications filed for an administrative review to GDIP has been increased. In this way, the volume of works that GDIP has had to be dealt with has also increased significantly, consequently this has brought the increase of expenditures and revenues collected by the GDIP.

The number of applications for industrial property objects has been significantly increased for this period, as indicated in the following table:

Lloji i aplikimit Type of Application	2014	2015	2016	2017	2018
Aplikime për marka tregtare dhe të shërbimit Applications on trade and service marks	904	937	1055	1161	1294
Aplikime për tregues gjeografikë Applications on geographical indicators	2	2	2	6	2
Aplikim për disenjo industriale Application on industrial designs	14	5	9	12	16
Aplikime për patenta kombëtare Applications on national patents	12	17	23	24	15
Aplikime për modele përdorimi Applications on utility models	0	1	4	1	2
Aplikime për patenta të huaja në fazë kombëtare Applications on foreign patents at national phase	411	522	722	789	906
Dokumenta të depozituara ne DPPI Documents filed to the GDIP	2331	3288	4268	3686	10259
Dokumenta të leshuara nga DPPI Documents issued by GDIP	5844	7906	11234	9707	11500
Totali i aplikimeve Total of applications	9518	12678	17317	15386	23867

I. PERSPEKTIVA AFATMESME 2019-2020

Qëllimet strategjike të DPPI për periudhën 2019-2020 bazohen në objektivat e ndërmara në Strategjinë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2016-2020 dhe konkretisht synohet të arrihet:

Një sistem më i fortë i Pronësisë Industriale në Republikën e Shqipërisë, i cili siguron një mbrojtje efektive të objekteve të PI, inkurajon krijimtarinë dhe inovacionin në funksion të stimulimit të rritjes ekonomike dhe zhvillimit kulturor dhe shkencor në Republikën e Shqipërisë.

I. MEDIUM-TERM PERSPECTIVE 2019-2020

GDIP strategic goals for the period 2019-2020 are based on objectives undertaken in the the National Intellectual Property Strategy 2016-2020, which specifically aim to achieve:

A strong Industrial Property system in the Republic of Albania, which enables an effective protection of the IP objects, encourages creativity and innovation to stimulate economic growth and cultural and scientific development in the Republic of Albania.

Fokusi i DPPI-së do të jetë përmirësimi i funksionimit të sistemit të Pronësisë Industriale me qëllim, nxitjen dhe mbështetjen e inovacionit nëpërmjet nxitjes së punës kërkimore, në veçanti nga kompanitë shqiptare, universitetet vendase dhe individët, për të asistuar ekonominë shqiptare dhe qytetarët në rrugën drejt zhvillimit ekonomik dhe drejt standardeve më të larta.

Synohet rritja e ndërgjegjësisë, si dhe forcimin e sistemit të regjistrimit, administrimit dhe mbrojtjes së të drejtave që rrjedhin nga pronësia intelektuale, si të drejta që ushtrojnë një ndikim të fuqishëm në zhvillimin dhe mirëfunksionimin e ekonomisë.

Në përputhje me kërkesat dhe detyrimet që rrjedhin nga procesi i integritetit të Shqipërisë, sistemi i Pronësisë Industriale në Shqipëri duhet të garantojë efektivisht një nivel mbrojtje të të drejtave të Pronësisë Intelektuale të njëjtë me atë që ekziston në Bashkimin Evropian

A - Të ardhurat nga aktiviteti kryesor.

Nga aktiviteti kryesor që prej vitit 2013, të ardhurat kanë pësuar rritje të ndjeshme. **Në vitin 2018 këto të ardhura janë rritur me rreth 83% krahasuar me të ardhurat në vitin 2013, dhe 24% krahasuar me vitin 2017.**

B - Të ardhura të tjera të DPPI janë edhe:

- *Të ardhurat nga mbrojtja e markave nga Marrëveshja e Madridit dhe Protokollin e saj për regjistrimin ndërkombëtar të markave.*
- *Të ardhura nga marrëveshja e shtrirjes së patentave evropiane me Zyrën Evropiane të Patentave.*

GDIP will focus on improving the work of the Industrial Property system in order to encourage and support innovation through providing incentives for research works, especially in the Albanian companies, local universities and individuals, to assist the Albanian economy and its citizens in their course to economic development and towards higher standards.

We also aim at raising awareness and strengthening the rights registration, management and protection of the system, deriving from intellectual property, as rights which have a strong impact in the development and well-functioning of the economy.

In compliance with the requirements and obligations deriving from the integration process of Albania, the Industrial Property system in Albania should effectively guarantee a high level of protection of Intellectual Property rights, at the same level as the one applied in the European Union

A - Incomes from the main activity.

The incomes from the main activity have grown significantly since 2013. **In 2018, these incomes increased by about 83% compared to 2013 incomes and 24% compared to 2017.**


B - Other GDIP incomes are also:

- *The incomes from trademark protection under the Madrid Agreement and its Protocol on the international trademark registration.*
- *Incomes from the European patent extension agreement with the European Patent Office.*

Tabela më poshtë tregon të ardhurat nga viti 2013-2018.

The table below shows the total incomes from 2013-2018.

Vit buxhetor Budget Year	Të ardhura nga Sistemi i Madrid-it për regjistrimin ndërkombëtar të markave Income from the Madrid system for international trademark registration (Swiss Francs)	Të ardhura nga Marrëveshja e Shtrirjes së Patentave Evropiane Incomes from the European Patent Extension Agreement (Euro)	Të ardhura nga Aktiviteti kryesor Income from the Main Activity (Lekë) / (ALL)
Viti 2013 Year 2013	473,361.05 CHF	22,623.55 €	63,644,291.00 ALL
Viti 2014 Year 2014	493,515.15 CHF	19,555.95 €	73,924,623.50 ALL
Viti 2015 Year 2015	529,538.03 CHF	8,052 €	81,108,236.49 ALL
Viti 2016 Year 2016	557,633.72 CHF	6,190 €	87,845,808.29 ALL
Viti 2017 Year 2017	627,326 CHF	7,958.54 €	94,244,771.00 ALL
Viti 2018 Year 2018	631,784.10 CHF	73,807.43 €	116,703,000.00 ALL







Tabela e mëposhtme tregon shpenzimet faktike për vitin 2018, krahasuar me planin, si dhe realizimi në %.

The table below shows factual expenditures for 2018, as compared to the plan, as well as realization in %.

Nr. No.		Janar-Dhjetor January-December 2018	Janar-Dhjetor January-December 2018	% realizimi % accomplishment
		Plan (Në mijë lekë) (In thousand ALL)	Fakt / Fact (Në mijë lekë) (In thousand ALL)	
I	Shpenzime Korente Current Expenses	74,525	46,601	62.5%
1.1	Personeli / Staff	44,000	23,158	52.6%
1.2	Operative dhe Korrente Operational and Current	19,225	12,143	63.2%
1.3	Transferta korrente jashte Current transfers from/to abroad	11,300	11,300	100%
II	Shpenzime Kapitale Capital Costs	61,793	4,427	7%
2.1	Financim i brendshëm Internal financing	61,793	4,427	7%
2.2	Financim i huaj Foreign financing	0	0	0
III	SHUMA AMOUNT	136,318	51,028	37.4%
	Tepricë derdhje në Buxhetin e Shtetit Surplus payment to the State Budget	113,828		
IV	Pjesa e pa shpërndarë e shpenzimeve Unallocated part of expenditures	0	27,924	
	TOTALI / TOTAL	250,146	78,952	

Në vitin 2018 janë publikuar në total 14 buletinë për patentat e shpikjeve dhe modelet e përdorimit, dhe 24 buletinë për markat tregtare dhe disenjove industriale, pra në total janë realizuar 38 publikime të Buletinëve të Pronësisë Industriale. Publikimi më i shpeshtë i Buletinit të Markave ndikoi ndjeshëm në shkurtimin e afatit të regjistrimit të tyre.

In 2018, a total of 14 bulletins were published for invention patents and utility models, and 24 Bulletins for trademarks and industrial designs, so 38 publications of the industrial property bulletins, in total. The most frequent publication of the Trademark's Bulletin significantly affected the shortening of their registration deadline.





BURIMET NJERËZORE

HUMAN RESOURCES

Menaxhimi i burimeve njerëzore është i orientuar në zhvillimin e aftësive të punonjësve, mbështetjen në punë, drejt stileve demokratike të drejtimit duke synuar përfshirjen e personelit dhe rritjen e angazhimit drejt zhvillimit të qendrueshëm institucional dhe performancës së suksesshme në treg. Burimet Njerëzore në DPPI luajnë rol lehtësues dhe mbështetës duke iu ardhur në ndihmë realizimit të objektivave të ndërmarra gjatë vitit 2018.

Human resource management is oriented to capacity building of employees, work support, democratic leadership styles, aiming at staff involvement and increasing commitment to sustainable institutional development and successful performance in the market. DGIP Human Resources play a facilitating and supportive role by assisting in the achievement of the objectives undertaken during 2018.



Në zbatim të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar si dhe **Vendimit nr.3, datë 10.07.2018 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së DPPI-së”** i Këshillit Mbikqyrës, DPPI në datën 10.09.2018 hyri në fazën e ristrukturimit institucional.

Gjatë vitit 2018 në DPPI është kryer reforma e thellë institucionale, e cila konsistoi në miratimin e strukturës së re me 39 punonjës, një shtesë personeli prej 15 punonjësish të rinj, që filluan të rekrutohen gjatë muajit tetor të vitit 2018 dhe në vazhdim. Plotësimi hap pas hapi i të gjithë vendeve vakante në strukturë, ka sjellë dhe do të ketë një impakt pozitiv për të kryer një shërbim cilësor, profesional dhe të njëjtë me zyrat tona homologe jashtë vendit.

Pursuant to Law no. 152/2013 “On civil servant”, as amended, as well as **Decision no.3, dated 10.07.2018 “On adoption of the structure and organisational chart of GDIP”** of Supervisory Council. GDIP on 10.09.2018 entered into the phase of institutional restructuring.

In 2018, GDIP underwent a thorough institutional reform which resulted in the adoption of a structure with 39 employees, adding 15 new employees to the staff, who went through the recruitment process from October 2018 onwards. The step-by-step filling of all vacancies within the structure has brought about and will have a positive impact on providing a qualitative, professional and similar service to our homologous offices abroad.

Shtimi i numrit të punonjësve erdhi edhe si domosdoshmëri për përmbushjen e objektivave të ndërmara në Strategjinë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2016-2020 nga DPPI. Numri i lartë i aplikimeve për objektet e pronësisë industriale ka sjellë rritjet e të ardhurave të DPPI-së. Gjithashtu, është rritur dhe cilësia e shërbimeve në këtë fushë, kjo falë punës intensive të kryer nga promovimi dhe koordinimi që stafi i DPPI-së ka ndërmarrë në aktivitetet pranë bizneseve, nëpër qendrat e informimit teknik dhe shkencore, nëpërmjet seminareve dhe leksioneve në Universitetet publike dhe jo-publike si dhe për grupet e interesit. Kjo drejtori ka performuar denjësisht këto vite duke krijuar kështu një sistem të qendrueshëm të pronësisë industriale në Republikën e Shqipërisë.

Si rrjedhojë ekësaj pune intensive, është shtuar edhe volumi punës që është dashur të përballohet nga punonjësit aktualë të DPPI-së. Gjithashtu vonesat në rekrutimin e stafit kanë sjellë vështirësi në funksionimin normal të punës së drejtorisë, vonesa në shqyrtim dhe ekzaminimin e aplikimeve.

Të gjitha këto sfida dhe puna e kryer nga DPPI, kërkojnë buxhetin e propozuar i cili është tërësisht i argumentuar dhe i justifikuar, për arritjen e të gjitha objektivave që na imponon kuadri ligjor dhe detyrimet ndërkombëtare.

• Për të vijuar më tej në zbatim të nenit 191/a, të ligjit 9947, të ardhurat që realizon DPPI-ja janë:

- a) të ardhurat që krijohen nga aktiviteti i saj;
- b) të ardhurat nga tarifat e Sistemit të Madridit për regjistrimin e markave ndërkombëtare, e Marrëveshjes së Hagës për aplikimet ndërkombëtare për diseno industriale, si dhe të gjitha marrëveshjet e tjera që Republika e Shqipërisë ka lidhur ose do të lidhë në fushën e pronësisë industriale;
- c) të ardhura të tjera që mund të krijohen sipas legjislacionit në fuqi.

Gjithashtu, paragrafi 2 i pikës 2 të nenit 191/b të ligjit ligjit Nr.9947, datë 7.7.2008 "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar, citohet që "të

Increasing the number of employees came as a result of the need to meet the objectives set out in the *National Strategy on Intellectual Property 2016-2020* by GDIP. The high number of applications on industrial property objects has led to an increase in the revenues of GDIP. The quality of services in this area has also increased, thanks to the intensive work carried out through the promotion and coordination ensured by GDIP staff with activities in various businesses, in technical and scientific information centres, through seminars and lectures in public and private universities as well as for interest groups. This director has performed adequately these years, thus creating a sustainable system of industrial property in the Republic of Albania.

As a result of this intensive work, the volume of work that GDIP employees has to be dealt with has also been increased. Moreover, delays in the recruitment of staff have led to difficulties in the normal functioning of directorate, delays in reviewing and examining of the applications.

All these challenges and the work carried out by GDIP require the proposed budget which is completely well-grounded and well-founded in achieving all the objectives that the legal framework and international obligations imposes on us.

• In order to further continue, pursuant to Article 191/a, of law 9947, the revenues received by GDIP are:

- a) the revenues generated by its activity;
- b) the revenues from the international trademark registration fees of Madrid System, the Hague Agreement on International Registration of Industrial Designs, as well as all other agreements that the Republic of Albania has concluded or will conclude regarding the field of industrial property;
- c) other revenues generating according to the legislation into force.

It is also specified in the paragraph 2, point 2, of Article 191/b of Law No.9947, dated 7.7.2008, as amended, that the revenues received by the

ardhurat që DPPI realizon sipas këtij ligji, por të pashpërndara në fund të vitit derdhen në buxhetin e shtetit me përjashtim të:

- a) fonde të parashikuara për investime;
- b) pagesave të menjëhershme për llogari të institucioneve ndëkombëtare të fushës sipas të cilave Shqipëria ka detyrime financiare.

Vetëm fondet e parashikuara për shpenzime dhe të pashpërndara në fund të vitit transferohen në Buxhetin e Shtetit.

- Në tre vitet e fundit buxheti i DPPI ka ardhur duke u ulur në zërat shpenzime operative dhe investime duke penguar në këtë mënyrë përmbushjen e realizimeve të kësaj drejtorie.
- Në projekt buxhet janë hequr zëra që janë esenciale që lidhen me promovimin dhe trajnimet në këtë fushë, si tepër të domosdoshme. Heqja e fondeve të promovimit do ta kthejë DPPI në hapa mbrapa sa i takon reformave të parashikuara.

Kjo do të thotë se DPPI është e lidhur ngushtësisht me investimet në këtë fushë dhe se reduktimi i këtyre zërave në buxhet krijon pengesë në realizimin e detyrave.

- Gjithashtu, në vijim të hyrjes në fuqi VKM nr. 673, datë 22.11.2017, "Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit", shprehim më poshtë disa problematika të zbatueshmërisë së saj për Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI).
- Investimet e parashikuara në buxhetin e DPPI-së janë kryesisht në fushën e IT. Duke iu referuar VKM nr. 673, datë 22.11.2017, "Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit", janë në përgjegjësinë e kësaj të fundit dhe për rrjedhojë nuk realizohen dhe transferohen vit pas viti. Janë hequr investimet e parashikuara në Strategjinë Kombëtare të Pronësisë Intellektuale 2016-2020, si dhe ato që janë detyrim ligjor, për të cilat komisioni evropian i ka kërkuar qeverisë shqiptare gjetjen e fondeve për realizimin e tyre.

GDIP under this law, but unallocated by the end of year are to be transferred to the state budget except of:

- a) funds provided for investments;
- b) immediate payments on behalf of the international institutions concerned according to which Albania has financial liabilities.

Only funds provided for expenditures and unallocated by the end of year are to be transferred to the State Budget.

- In the last three years, the GDIP budget has experienced a decrease in items related to operational expenditures and investments, thus impeding the fulfilment of the objectives of this directorate.
- Essential items relating to promotion and training in this area have been removed in the draft budget. Removing promotion funds will cause GDIP to fall behind in terms of planned reforms.

This means that GDIP is closely related to the investments in this field and that the reduction of these items in the budget creates an obstacle in the performance of tasks.

- In addition, upon the entry into force of DCM no. 673, dated 22.11.2017, "On the reorganization of the National Agency for Information Society" some of the difficulties of its implementation to the General Directorate of Industrial Property (GDIP) are presented below.
- The investments provided for in the GDIP budget are mainly in the field of IT. Referring to DCM no. 673, dated 22.11.2017, "On the reorganization of the National Agency for Information Society", are under the responsibility of the latter and therefore are not implemented and transferred year after year. The investments provided for in the National Strategy on Intellectual Property 2016-2020 have been removed, as well as those that are a legal obligation for which the European Commission has asked the Albanian Government to provide funds for their implementation.

→ **Regjistri i objekteve të Pronësisë Industriale**, përmban edhe të dhëna të depozituara si rrjedhim i zbatimit të marrëveshjeve ndërkombëtare të lidhura nga Republika e Shqipërisë me organizata të huaja në fushën e Pronësisë Industriale dhe konkretisht:

- Marrëveshja e Madridit e datës 14 prill 1891 “Për regjistrimin ndërkombëtar të markave” - hyrë në fuqi në Shqipëri më 4 Tetor 1995
- Ligj Nr.8992, datë 30.1.2003 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Protokollin e marrëveshjes së Madridit për regjistrimin ndërkombëtar të markave” – marrëveshja ka hyrë në fuqi në Shqipëri më 30 Korrik 2003
- Ligj Nr.10179, datë 29.10.2009 Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Europiane të Patentave” – marrëveshja ka hyrë në fuqi në Shqipëri më 1 Maj 2010
- Ligj Nr.10180, datë 29.10.2009 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen për të drejtën e patentave të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale” (OBPI) – marrëveshja ka hyrë në fuqi në Shqipëri më 17 Maj 2010

Zbatimi dhe administrimi i këtyre marrëveshjeve është kompetencë e DPPI-së, dhe nuk mund ti kalojë një institucioni tjetër me një akt nënligjor.

Gjithashtu DPPI, si një institucion i cili ndjek dhe zbaton marrëveshjet dhe standartet ndërkombëtare në fushën e pronësisë industriale, sistemin e ka të ndërlidhur me organizata të huaja në fushën e PI-së për shkëmbim informacioni me to.

1. Sa më sipër, *pika 21 e VKM nr. 673, datë 22.11.2017, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”,* ku shprehet që AKSHI njeh dhe zbaton të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet e huaja, është në kundërshtim me *ligjin 9947, datë 07.07.2008, “Për Pronësinë Industriale”, i ndryshuar dhe marrëveshjet ndërkombëtare të sipërpërmendurabie ndesh me kompetencat e DPPI-së.*

→ **The Register of Industrial Property Objects** also contains data deposited as a result of the implementation of international agreements concluded by the Republic of Albania with foreign organizations in the field of Industrial Property and specifically:

- Madrid Agreement, dated April 14th 1891 “On the international registration of Trademarks”, which became applicable in Albania as from October 4th 1995
- Law no. 8992, dated 30.1.2003 “On the accession of the Republic of Albania to the Madrid Agreement Protocol on the international registration of trademarks”, the agreement became applicable in Albania as from July 30th 2003
- Law no. 10179, dated 29.10.2009 “On the Accession of the Republic of Albania to the European Patent Convention” - the agreement became applicable in Albania as from May 1st 2010
- Law no. 10180, dated 29.10.2009 “On the Accession of the Republic of Albania in the Patent Law Treaty of World Intellectual Property Organization” (WIPO), the agreement became applicable in Albania as from May 17th 2010.

The implementation and administration of these agreements is within the competence of GDIP, and cannot be transferred to another institution by a sub-legal act.

In addition, the GDIP, as an institution which implements international agreements and standards in the field of industrial property, has the system connected with foreign organizations in the field of IP for information exchange with them.

1. As far as the above, paragraph 21 of DCM no. 673, dated 22.11.2017, “*On the reorganization of the National Agency for Information Society*”, which states that AKSHI recognizes and assumes the rights and obligations deriving from the foreign agreements is in violation of the law 9947, dated 07.07.2008, “*On industrial Property*”, as amended and the abovementioned international agreements are in conflict with GDIP competences.

2. Fondet e parashikuara për investimet TIK dhepagat e punonjësve TIK për DPPI, nuk janë fonde buxhetore por nga të ardhurat e DPPI-së. Këto fonde në bazë të Ligjit 9947, administrohen nga DPPI dhe nuk janë pjesë e buxhetit të shtetit, si të tilla nuk mund të kalojnë në admistrim të AKSHI-t.

Në zbatim të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", fondet duhet të jenë aktive para se te prokurohen, ndaj edhe AKSHI nuk mund të prokurojë fonde që nuk i ka, pasi këtë administrimi i tyre më ligj është kompetencë e DPPI-së.

Bazuar ne ligjin e mësipërme si dhe në zbatim të neve 191/a dhe 191/b të *Ligjit 9947, datë 07.07.2008, "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar* ku DPPI administron të ardhurat e saj, AKSHI nuk mund të prokurojë fondet e DPPI-së, si dhe DPPI nuk mund të paguajë tarifa për të paguar një shërbim rrjedhojë e një procedure që nuk është kryer nga ajo.

Sa më sipër, pika 2, gërma (i) e pikës 5, pika 23 dhe pika 24, të VKM nr. 673, datë 22.11.2017, "Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit", janë të pazbatueshme për DPPI-në.

3. DPPI që prej vitit 2006, përdor Sistemin e Administrimit të Pronësisë Industriale (SAPI), i cili është zhvilluar dhe është dhënë pa pagesë nga Organizata Botërore e Pronësisë Itelektuale (OBPI). Ndër vite ky sistem së bashku me modulet pjesë përbërëse të tij janë përmirësuar dhe mirëmbajtur nga OBPI, pa pagesë.

Kodi burim dhe e drejta e autorit janë në pronësi të OBPI.

Sa më sipër, AKSHI nuk mund të administrojë kodin burim të SAPI, për arsye se OBPI është pronari dhe administratori i kodit burim, ndaj gërma (f) e pikës 6 VKM nr. 673, datë 22.11.2017, "Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit", është i pazbatueshëm, në rastin e sistemit të DPPI.

4. Në pikën 4 të nenit 191/a, të Ligjit 9947, datë 07.07.2008, "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar, për projektet, aktivitetet apo investimet që zbatohen në kuadër të marrëveshjeve

2. The funds provided for ICT investments and ICT employees' salaries of GDIP, are not from budgetary funds but from GDIP revenues. These funds pursuant to Law 9947 are under the administration of GDIP and are not part of the state budget, as such cannot be transferred under the administration of AKSHI.

Pursuant to Law No. 9643, dated 20.11.2006, "On Public Procurement", the funds must be active before being procured, therefore AKSHI cannot procure funds which it does not possess, since their administration, according to the law falls into the competences of GDIP.

Based on the aforementioned law and pursuant to Articles 191/a and 191/b of Law No. 9947 of 07.07.2008, "On Industrial Property," as amended, where GDIP administers its revenue, AKSHI can not procure GDIP funds and GDIP can not pay fees to pay a service resulting from a procedure not carried out by it.

As far as above, paragraph 2, paragraph 5 (i), paragraph 23 and 24 of DCM no. 673, dated 22.11.2017, "On the reorganisation of the National Agency for Information Society", shall not apply to GDIP.

3. Since 2006, the GDIP uses the Industrial Property Administration System (IPAS), which was developed and provided free of charge by the World Intellectual Property Organization (WIPO). Over the years this system together with modules, as integral part of it, have been improved and maintained by the WIPO, free of charge.

Source code and the copyright are in the ownership of WIPO.

As far as above, NAIS can not administer the IPAS source code, for the reason that WIPO is the owner and the administrator of the source code, therefore paragraph 6(f) of DCM no. 673, dated 22.11.2017, "On the reorganisation of the National Agency for Information Society", shall not apply to GDIP system.

4. In paragraph 4 of the article 191/ a, of Law 9947, dated 07.07.2008, "On Industrial Property", as amended, for projects, activities or investments that are implemented within the framework of agreements concluded by GDIP with international institutions of the field ,which

të lidhura nga DPPI-ja me institucione ndër-kombëtare të fushës, të cilat investohen tërësisht me fondet e tyre apo pjesërisht edhe me fondet e DPPI-së, zbatohen procedurat që ndjekin këto institucione ose procedurat që përcaktohen në marrëveshjet përkatëse të lidhura me këto institucione.

Sa më sipër, gërma (th) e pikës 6 të VKM nr. 673, datë 22.11.2017, "Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit", është i pazbatueshëm në projekte që mbështeten nga financime apo donacione të huaja në fushën e Pronësisë Industriale.

5. Pika 3 të nenit 191/b, të ligjit 9947, datë 07.07.2008, "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar, përcakton se DPPI si institucion publik jobuxhetor me vetëfinancimka të gjitha të drejtat dhe detyrimet të administrojë asetet e llogaritë e saj bankare.

Asetet e DPPI përbëhen edhe nga sistemet hardware dhe software të TIK, që DPPI ka aktualisht, apo do të zhvillojë në të ardhmen.

Sa më sipër, gërmat (i) , (g) dhe (xh) e pikës 6, pika 9, pika 18 dhe pika 19, e VKM nr. 673, datë 22.11.2017, "Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit", bien ndesh me Ligjin 9947, datë 07.07.2008, "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar.

6. Në zbatim të pikës 4 të nenit 189/c, të ligjit 9947, datë 07.07.2008, "Për Pronësinë Industriale", struktura dhe organika e DPPI, miratohet nga Këshilli Mbikqyrës i DPPI. Pra NAIS nuk mund të propozojë apo miratojë strukturën e TIK në funksion të DPPI.

Si institucion jo buxhetor, numri i punonjësve të DPPI është jashtë skemës së punonjësve buxhetorë, ndaj nuk mundet kalimi pranë NAIS, as i strukturave të TIK të DPPI-së, dhe as i fondit pagave për këto struktura.

Sa më sipër, gërma (dh) e pikës 5, pika 10, pika 11 dhe pika 23, janë të pazbatueshme në rastin e DPPI-së.

7. Gërma (y) e pikës 6 dhe pika 9 e VKM nr. 673, datë 22.11.2017, "Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit", janë të paqarta dhe kundërshtojnë njëratjetrën. Nuk mundet teknikisht që një sistem të administrohet

are wholly invested with their own funds or partially with the funds of GDIP, the procedures followed by these institutions or the procedures laid down in the relevant agreements relating to these institutions shall apply.

As far as above, paragraph 6(U) of DCM no. 673, dated 22.11.2017 "On the reorganization of the National Agency for Information Society" shall not apply to projects supported by foreign funding and donations in the field of Industrial Property.

5. Point 3 of Article 191/b of Law no. 9947, dated 07.07.2008, "On Industrial Property", as amended, stipulates that GDIP as a non-governmental self-financing institution has all the rights and obligations to manage its assets and bank accounts.

GDIP assets also include TIK hardware and software systems that GDIP currently has or will develop in the future.

As far as above, paragraph 6(i)(g)(y), paragraph 9, 18 and 19 of DCM no. 673, dated 22.11.2017, "On the reorganization of the National Agency for Information Society" are not in compliance with Law 9947, dated 07.07.2008 "On Industrial Property", as amended.

6. The structure and the organisational chart of GDIP is approved by the Supervisory Council of GDIP pursuant to paragraph 4 of article 189/c, of law 9947, dated 07.07.2008, "On Industrial Property" Therefore, NAIS can not propose or approve the TIK structure for GDIP.

As a non-budgetary institution, the number of GDIP employees is not covered by the budgetary employees scheme, therefore NAIS cannot cover neither GDIP ICT structure nor the salaries fund for such structures.

As far as above, paragraph 5 (e), 10, 11 and 23 shall not apply to the GDIP.

7. The paragraph 6(y) and paragraph 9 of DCM no. 673, dated 22.11.2017, "On the reorganization of the National Agency for Information Society", are ambiguous and not in compliance with each-other. It is not technically possible for

pjesërisht nga një institucion dhe regjistrat e të dhënave dhe baza e të dhënave administrohet nga një institucion tjetër.

Ndaj gjykojmë që gërma (y) e pikës 6 është e pazbatueshme teknikisht dhe bie ndesh me Ligjin 9947, datë 07.07.2008, *“Për pronësinë Industriale”, i ndryshuar.*

8. DPPI ka parashikuar për të realizuar brenda 300 ditëve të para të qeverisjes, zhvillimin e aplikimit on-line për objektet të PI, në total 43 shërbime.

Hyrja në fuqi të VKM nr. 673, datë 22.11.2017, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, do të sjellin pengesa serioze për realizimin e këtij objekti dhe investimeve të tjera të parashikuara në fushën e TIK për përmirësimin e shërbimeve të DPPI, duke penguar mirëfunksionin e punës në DPPI.

9. Dhe së fundmi, por jo më pak e rëndësishme theksojmë se DPPI, studjoi strukturat organizative të zyrave homologe në vendet e BE, ku edhe Shqipëria aspirojnë për t'u anëtarësuar.

Të gjitha këto zyra jo vetëm që kanë struktura të TIK në përbërjen e tyre por edhe i kanë të konsoliduar dhe pjesë të funksionit kryesor të tyre, stafi në këto struktura është jo më pak se 15-20% i të gjithë stafit në shumicën e rasteve.

Pronësia Industriale është specifike dhe kërkon njohuri edhe nga stafi i TIK, me qëllim zbatimin e standarteve ndërkombëtare të vendosura nga Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale, si një organizatë e Kombeve të Bashkuara me 191 vende antare, ku pjesë është edhe Shqipëria. Procedurat e regjistrimit, administrimit dhe promovimit të Pronësisë Industriale, në zbatim të standarteve ndërkombëtare, është e lidhur shumë ngushtë me TIK dhe kërkon domosdoshmërisht të jetë pjesë e të njëjtës strukturë.

Asnjë nga Zyrat e Pronësisë Industriale në vendet europiane, nuk e kanë njësinë e TIK, jashtë institucionit, dhe mendojmë që zbatimi i këtij vendimi do të sjellë hapa pas në vazhdimin e reformave të ndërmara nga DPPI për forcimin e sistemit të PI në vend.

a system to be partially administered by an institution while data records and database are administered by another institution.

Therefore, we consider that paragraph 6(y) is technically inapplicable and does not comply with the Law 9947, dated 07.07.2008, *“On industrial Property”, as amended.*

8. Within first 300 days of governance, GDIP has planned to establish an on-line application for IP objects, a total of 43 services.

Entry into force of DCM No. 673, dated 22.11.2017, “On the reorganization of the National Agency for Information Society”, will bring serious obstacles to the fulfilment of this objective and other investments provided in TIK sector to improve GDIP services, impeding well-functioning of GDIP performance.

9. Taking everything into consideration, emphasize that GDIP has studied the organizational structures of homologous offices in EU countries, where Albania aspires to be part of.

TIK structures not only are part of the composition of these offices, but are also consolidated and part of their main function. Staff in these structures is not less than 15-20% of all staff in most cases.

Industrial Property is specific and requires knowledge from TIK staff to implement international standards set by the World Intellectual Property Organization as a United Nations organization with 191 member states, including Albania. Industrial Property's registration, administration and promotion procedures, in accordance with international standards, are closely related to TIK and necessarily need to be part of the same structure.

None of the industrial property offices in European countries have the TIK unit outside the institution, and we believe that implementing this decision will lead to further steps in the reforms undertaken by the GDIP to strengthen the country's IP system.

PËRFAQËSUESIT E AUTORIZUAR TË PATENTAVE DHE MARKAVE

AUTHORIZED REPRESENTATIVES OF PATENTS AND TRADEMARKS

PËRFAQËSIMI NË DPPI

Përfaqësuesit e Autorizuar të objekteve të pronësisë industriale (agjentët e licencuar) janë profesionistët që përfaqësojnë dhe veprjnë në emër të pronarëve të objekteve të pronësisë industriale. Në bazë nenit 195 të ligjit nr. 9947 datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale” i ndryshuar, agjentët e licencuar kryejnë regjistrimet pranë DPPI-së.

Personat që kanë vendqëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, ose që kryejnë veprimtari brenda territorit të saj, mund të përfaqësohen në DPPI dhe nëpërmjet përfaqësuesve të tjerë të cilët nuk janë të regjistruar në këtë drejtoripor janë të punësuar teknjë subjekt dhe për rrjedhojë, pajisen me autorizimin e përfaqësimit nga administratori/pronarii subjektit që kërkon mbrojtje pranë institucionit tonë.

Roli i një agjenti përfshin përgatitjen, paraqitjen dhe ndjekjen e procedurave të kundërshtimit dhe paditë penale për aplikimet për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale. Agjentët e licencuar japin mendime për regjistrimin e objekteve të PI-së, në përputhje me kriteret e vendosura nga ligji për të hetuar nëse mund të ekzistojë konfuzion ose konflikte të ndryshme, si psh në rastin e markave tregtare ose emrave tregtarë të tjerëve.

DPPI shqyrton aplikimin e paraqitur nga agjenti dhe njofton atë për kryerjen e plotësimeve apo sqarimeve të nevojshme. Nëse gjatë publikimit paraqitet një kundërshtim ndaj një aplikimi të tillë agjenti harton një përgjigje të përshtatshme ose ndjek procedimet e kundërshtimit për të mbrojtur interesat e aplikantit dhe paraqet dëshmi dhe argumente të përshtatshme për të bindur Dhomën e Shqyrtimit të Kundërshtimeve dhe Bordin e Apelit, për të mbrojtur aplikimin e tij. Gjithashtu, një agjent mund të fillojë procedurat e kundërshtimit ndaj aplikimeve të tjera në emër të aplikantit të tij.

REPRESENTATION IN GDIP

Authorised representatives of industrial property objects (licensed agents) are professionals representing and acting on behalf of owners of industrial property objects. According to Article 195 of law no. 9947 dated 07.07.2008 “On Industrial Property”, as amended, licensed agents carry out registrations at GDIP.

Permanent residents of the Republic of Albania or persons carrying out activities within their territory may be represented in GDIP by other representatives who are not registered in this directorate but are employed in an entity and therefore, are provided with the authorization of representation from the administrator/owner to the entity that requests protection at our institution.

The role of an agent includes preparation, submission and follow-up of objection procedures and criminal charges for registration applications of industrial property. Licensed agents provide opinions on the registration of IP objects in accordance with the criteria set out by law to investigate whether there may be confusion or conflict, such as in the case of trademarks or trade names of others.

The GDIP shall review the application filed from the agent and shall notify the latter for the completion of any necessary clarifications or additions. If during the publication an objection of such application is submitted, the agent shall draft an appropriate answer or shall follow-up the proceedings of objection to protect the applicant's interests and shall submit appropriate evidence and arguments to convince the Objection Review Chamber and the Board of Appeal to protect his application. Also, the agent may initiate the objection procedures against other applications on behalf of his applicant.

Agjenti i licencuar duhet të ketë njohuri të plotë të ligjit për pronësinë industriale, si dhe rregulloret në zbatim të tij. Ai duhet të ketë aftësi të mira komunikimi, verbale dhe të shkruarave aplikantët, profesionistët e tjerë ligjorë, agjentët reklamues, nëpunësit e DPPI dhe me bashkëpunëtorët e huaj. Agjenti gjithashtu përgatit mendime mbi rezultatin e kërimit, përgjigjet ndaj njoftimeve të ekzaminuesit dhe argumenteve me shkrim, për përdorim në një procedurë kundërshtimi.

Një agjent këshillon dhe u shërben pronarëve të objekteve të pronësisë industriale në mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e tyre në mënyrë që ato të mbeten të vlefshme dhe të përdoren siç duhet. Një agjent gjithashtu, ndihmon pronarët për kontratat e licencimit dhe të franchizing në mënyrë që të përfitohet sa më shumë prej tyre si dhe të krijohet ruajtja nga cënushmëria në tregjet vendase dhe të huaja.

Agjenti, gjithashtu ndihmon përfaqësuesit e subjektit, duke regjistruar çdo ndryshim të pronësisë mbi objektet e regjistruara, duke paraqitur kërkesat për ripërtëritjet e regjistrimeve të objekteve të PI-së në DPPI, si dhe për përgatitjen e aplikimeve për mbrojtjen ndërkombëtare të tyre.

Në regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar të DPPI-së për vitin 2018, janë të regjistruar 9 Përfaqësues të Autorizuar, ndër të cilët 3 janë licensuar si Përfaqësues të Autorizuar për Patentat dhe 6 prej tyre janë licensuar si Përfaqësues të Autorizuar për Disenjt Industrial, Markat Tregtare dhe Treguesit Gjeografikë.

DPPI ka kompetencë të saj organizimin e testimit me shkrim të aplikantëve për përfaqësues të autorizuar në bazë të VKM Nr. 317, datë 31.5.2018 për miratimin e rregullores *“Për Përfaqësuesit e Autorizuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale”*.

Për këtë qëllim ngrihet komisioni përkatës duke pranuar dosjet e aplikantëve dhe përgatitet dokumentacioni nevojshëm për kryerjen e testimit pas kryerjes së këtyre procedurave personat pajisen me licencën nga DPPI-ja duke u emëruar si Përfaqësues të Autorizuar.

The licensed agent must have full knowledge on the law on industrial property, as well as all the other regulations for its implementation. He/She should have good communication skills, both written and verbal in contact with applicants, other legal professionals, advertising agents, GDIP officials and foreign collaborators. The agent also draft opinions on search results, responses to notifications of examiners and written arguments for use in case of any refusal procedure.

An agent shall advise and serve to the owners of industrial property objects for their maintenance and protection so that they remain valid and properly used. An agent shall also assist owners on licensing and franchising contracts so as to benefit as much as possible and enable protection from any vulnerabilities in domestic and foreign markets.

An agent also assists representatives of the entity by recording any change of ownership over the registered objects, by submitting requests for renewal of the registration of IP objects at GDIP, and by preparing applications for their international protection.

In the register of authorized representatives of GDIP for 2018, are registered 9 Authorized Representatives, of which 3 have been licensed as Authorized Representatives for Patents and 6 of them have been licensed as Authorized Representative for Industrial Designs, Trade-marks and Geographic Indications

The competences of GDIP include the organisation of written tests for applicants applying for authorized representatives on the basis of DCM no. 317, dated 31.5.2018 on the adoption of the Regulation *“On Authorized Representatives in the General Directorate of Industrial Property”*.

For this purpose, the relevant committee is established, by accepting the applicants' files and preparing the necessary documentation for conducting the tests upon completion of these procedures. Persons are provided with the license by GDIP and are appointed as Authorized Representatives.

Në websitin e DPPI: www.dppm.gov.al, do të gjeni listën e Përfaqësuesve të Autorizuar të markave tregtare, disenjove industriale, treguesve gjeografikë dhe të patentave për shpikje.

Përfaqësuesite autorizuar për markat tregtare, disenjot industrial dhe treguesit gjeografik më aktiv për vitin 2018;

On the GDIP website: www.dppm.gov.al, you will find the list of Authorized Representatives of trademarks, industrial designs, geographical indicators and invention patents.

Authorized representatives for the most active trademarks, industrial designs and geographic indications for 2018;

Nr. / No.	Emri i Përfaqësuesit të Autorizuar Name of the Authorized Representative	Numri i Markave / Number of Trademarks
1	Vilson Duka	120
2	Krenar Loloci	104
3	Melina Nika	88

Përfaqësuesit e autorizuar për patentat dhe modelet e përdorimit më aktiv për vitin 2018;

Authorized representatives for the most active trademarks, industrial designs and geographic indications for 2018;

Nr. / No.	Emri i Përfaqësuesit të Autorizuar Name of the Authorized Representative	Numri i Patentave / Number of Patents
1.	Krenar LOLOÇI	473
2.	Ela SHOMO	116

PJESA III: TË DHËNA STATISTIKORE NGA REGJISTRAT E DPPI

PART III: STATISTICAL DATA FROM THE GDIP REGISTERS

Të dhënat statistikore për të gjithë objektet e pronësisë industriale aktive në DPPI

Statistical data for all objects of the active industrial property in the GDIP


REGJISTRIMET AKTIVE NË DPPI ACTIVE REGISTRATIONS IN THE GDIP

Numri i total i patentave për shpikje në fuqi Total number of invention patents applicable	5,031
Numri i patentave shqiptare në fuqi Number of Albanian patents in force	56
Numri i markave kombëtare të regjistruara Number of registered national trademarks	10,276
Numri i markave nga sistemi i Madridit të regjistruara Number of registered trademarks from the Madrid system	49,312
Numri i disenjove industriale kombëtare të regjistruara Number of registered national industrial designs	52
Numri i disenjove industriale të regjistruara nga Sistemi i Hagës Number of registered industrial designs from the system of Hague	2,491
Numri i treguesve gjeografikë të regjistruar Number of registered geographic indications	12
Nr. total i objekteve të pronësisë industriale të regjistruara në DPPI Total number of industrial property objects registered in the GDIP	67,230

Nga cilat shtete ka më shumë aplikime për marka në Shqipëri

Countries which have more trademark applications in Albania


Nr. / No.	Shteti / Country	Nr. i aplikimeve për marka nga shtetet e tjera ndër vite No. of applications for trademarks from other countries over the years
1.	SHBA / USA	3,727
2.	Zvicër / Switzerland	743
3.	Japoni / Japan	681
4.	Turqi / Turkey	458
5.	Gjermani / Germany	456



Nga cilat shtete ka më shumë aplikime për marka në Shqipëri në vitin 2018


Countries which have the highest number of trademark applications in Albania in 2018

Nr. / No.	Shteti / Country	Nr. aplikimeve për marka nga shtete të tjera në vitin 2018 No. of applications for trademarks from other countries in 2018
1.	SHBA / USA	114
2.	Itali / Italy	30
3.	Britani e Madhe / Great Britain	27
4.	Zvicër / Switzerland	18
5.	Serbi / Serbia	16



- Marka shqiptare të regjistruara në vende të tjera nëpërmjet sistemit të Madridit për regjistrimin ndërkombëtar të markave:

- Albanian trademarks registered in other countries through the Madrid system for the international registration of trademarks:

Nr. No.	Emërtimi i markës Trademark name	Pamja e markës Trademarke Image	Status	Origin	Holder	Nice Cl.
1	B52		Active	AL	ARSENI shpk	32
2	Energy King		Active	AL	BIBITA GROUP	32
3	BIRRA PEJA PILSNER		Active	AL	Birra Peja Albania sh.p.k.	32, 35, 39
4	DAST FABRIK FÜR PRODUKTION VON KLEBSTOFFEN UND MORTEL		Active	AL	"DAST" sha	19, 35
5	Dua caffè		Active	AL	Food Promotion Shpk.	30
6	B/		Active	AL	Albanian Distribution & Development sh.p.k	32
7	Just B/		Active	AL	Albanian Distribution & Development sh.p.k	32
8	B/		Active	AL	Albanian Distribution & Development sh.p.k	32
9	DTX ËTR		Active	AL	BIBITA GROUP SHPK	32
10	REGINA, O RIGINAL, AMERICAN BLEND		Active	AL	Servet DAUTI	34

MIRËNJOHJE:

✿ **KY RAPORT U HARTUA ME ENERGJINË DHE PËRKUSHTIMIN E PUNONJËSVE TË DPPI-SË.**

KONTAKTET E DPPI-SË:

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E PRONËSISË INDUSTRIALE**

Adresa: Bulevardi “Zhan D’Ark”, Prona nr.33,
Shtëpia e Ushtarakëve, Tirana, Albania

Website: www.dppm.gov.al



**Facebook: Drejtoria e Përgjithshme
e Pronësisë Industriale**



Instagram: DPPI Albania



Twitter: DPPM

E-mail: mailinf@alpto.gov.al; info@dppm.gov.al

Tel: +355(0)42271678

Orari i pritjes: E hënë - e enjte 08:00 - 16:30
E premte 08:00 - 14:00

ACKNOWLEDGEMENTS:

✿ **THIS RAPORT WAS DRAFTED WITH THE ENERGY AND DEVOTION OF GDIP EMPLOYEES.**

CONTACT DETAILS OF GDIP

MINISTRY OF FINANCE AND ECONOMY

**GENERAL DIRECTORATE OF INDUSTRIAL
PROPERTY**

Address: Bulevardi “Zhan D’Ark”, Prona nr.33,
Shtëpia e Ushtarakëve, Tirana, Albania

Website: www.dppm.gov.al



**Facebook: General Directorate of
Industrial Property**



Instagram: DPPI Albania



Twitter: GDPT

E-mail: mailinf@alpto.gov.al; info@dppm.gov.al

Tel: +355(0)42271678

Reception hours: Monday-Thursday 08:00-16:30
Friday 08:00 - 14:00

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËSISË INDUSTRIALE
GENERAL DIRECTORATE OF INDUSTRIAL PROPERTY

Adresa//Addres:

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale

General Directorate of Industrial Property

Bulevardi "Zhan D'Ark", Prona nr.33, Shtëpia e Ushtarakëve, Tiranë, Shqipëri

www.dppm.gov.al

info@dppm.gov.al